ARDIAN RAMADANI

GJURMË REALITETESH

Shkup, 2011

Titulli i origjinalit:
Gjurmë realitetesh
(***Artikuj publicistikë dhe polemikë***)

Autor:
Mr. Ardian RAMADANI

Redaktor:
Iljasa SALIHU

Redaktore gjuhësore:
Gëzime RAMADANI

Recensentë:
Doc. Dr. Vlera EJUPI
Mr. Faton MEHMETAJ

Redaktor teknik:
Agron MUSTAFA

Ballina:
Milaim MUSTAFA

Biblioteka:
Publicistikë

Botues:
Autori

Shtypi:
Print *ISM* - Shkup
Tel: (02) 2 622 360;
e-mail: furkan@furkan.com.mk

ARDIAN RAMADANI

Gjurmë realitetesh

Artikuj publicistikë dhe polemika

Shkup 2011

CIP – Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека “Св Климент Охридски”, Скопје

321.7(4)
316.723-021.463

RAMADANI, Ardian
Gjurmë realitetesh : (artikuj publicistikë dhe polemikë) / Ardian Ramadani. - Kumanovë : , 2011. - 208 стр. : илустр. ; 23 см

ISBN 978-608-65156-1-4

а) Демократија - Европа б) Мултикултурализам
COBISS.MK-ID 87752714

© Të drejtat e rezervuara të autorit

Përkushtim

Në shenjë respekti dhe dashurie, djalit tim, Florijonit, nipit tim, Arijonit... gjithë atyre familjeve shqiptare që i kanë më të dashurit e pafajshëm nëpër burgje si dhe atyre që nuk janë më në mesin tonë, e për të cilët duhet ne si intelektual, të shkruajmë dhe t`i përkujtojmë vazhdimisht

PARATHËNIE

Edhe përkundër prezencës së madhe të mjekëve specialistë në një shoqëri të caktuar, madje edhe përballë mjeteve teknologjike që dukshëm e kanë lehtësuar gjetjen e diagnozave që përkojnë me sëmundje tejet të ndërlikuara, prapë po të njëjtat simptoma të sëmundjeve, çdo ditë dhe në çdo kohë, vazhdojnë ta sfidojnë dhe mposhtin organizmin e krijesave, mposhtje që si qëllim parësor ka futjen e viruseve sulmues në organizmin e njeriut, duke i aktivizuar pastaj vetë metabolizmi viruset e tij mbrojtëse që gjenden në anën mbrojtëse të organizmit të njeriut. Krejt ky zhvillim i komplikuar, që në vete e ngërthen edhe urtësinë e këtij funksionimi të përkryer, ta kujton përditshmërinë tonë, ku luftëra të ngjashme, qoftë me armë apo me diçka tjetër, kryhen ndërmjet njerëzve në organizmin gjigant të këtij planeti, ku palët apo pjesëmarrësit në këtë betejë paraqiten disa "viruse" të njëjta për nga emërtimi, por të shumtë dhe të ndryshëm për nga veprimi, ndonëse të ngjashme me mendësinë e viruseve origjinale. Viruset sulmuese do ta shpallin fitoren e tyre, atëherë kur krijesa e quajtur njeri do të shkon për vizitë tek mjeku, vetëm atëherë kur e sheh se qielli si i çakërdisur është duke iu sjellë sipër kokës, veprim i jashtëm, që tregon se brendësia "territoriale" është krejtësisht e pushtuar. Viruset mbrojtëse do të jenë të mposhtura, të robëruara, mbase edhe ushqim për mikrobet tjera, mikrobe që për nga ndjekja ideolog-

gjike ende vazhdojnë të mbesin të papërcaktuara. Konstatimi i parë i mjekut që do ta bëjë në prani të pacientit, do të jetë: "*i nderuar pacient, dukshëm e keni humbur imunitetin, ndaj patjetër duhet të merrni infuzion ushqyes, përbërja e të cilit është përplot vitamina shtesë që për momentin i mungojnë trupit tuaj*". Me të dëgjuar këtë konstatim të mjekut "Perandoria e Viruseve", pa humbur kohë, në mënyrën e vet fillon të konsultohet me veten, për t'u mobilizuar kështu kundër kësaj terapie, qëllimi i së cilës është rimarrja e fronit dhe bartja e tij në duart e viruseve të mëparshëm. Ndonjëherë mjekët pa qëllim harrojnë që pacientët në ndërkohë t'i këshillojnë, edhe sesi më mirë dhe më fuqishëm njeriu mund ta ruaj dhe forcojë imunitetin, duke aluduar kështu në masat parandaluese. Është fakt se njeriu imunitetin nuk mund ta ruaj dhe forcojë, përderisa ai gjendet i kënaqur në sfondin e pasivitetit dhe të amullisë fizike. Për fatin tonë të keq, veprimtaria e udhëheqësve tanë dhe produktet e tyre me afat të skaduar dhe me një cilësi shumë të dobët, duket se sot janë bërë rrëfyesit dhe indikatorët më sublim të ngjeshjes së sfondit shqiptarë me plogështi të stërzgjatur. Ky popull ditët e ndritura i priti gjatë kohë, i cili për nga pritja asnjëherë, asgjë frytdhënëse s'kishte fituar, përpos dëshpërimit dhe zhgënjimit të shoqëruar me shpresa për ditë më të mira, mbase sikur donin që zymtinë e ditës së sotme për pak çaste ta harrojnë, duke u mbështetur kështu në fantazmat e së ardhmes që i prodhonte koka e bijve të këtij kombi bujar dhe skajshmërisht i shkërmoqur prej gënjeshtrave dhe premtimeve të boshatisura. Kurse i gjori popull, edhe pas asaj fantazme të bujshme për ditë me të mira, fantazmë e

cila qe lindur nën kushte tejet të rënda, të ardhmen e gjeti edhe më të zymtë se më parë, në vend të ditëve më të mira, i gjeti netët e ngjeshura përplot errësirë dhe pesimizëm, ndonëse për dallim prej herëve tjera, kokat e këtij populli të përvuajtur, tanimë e kishin ndërpre procesin e lindjeve të fantazmave, përmes të cilave pandehnin ardhmëri të gjallë.

Kësisoj, përmes këtij rrugëtimi dhe epilogu të dhembshëm ndaj shqiptarëve, edhe në librin e tretë të tijin, ndërsa në librin e dytë eseistik, "**Gjurmë realitetesh**", autori i ri, por shumë i pjekur, z. Ardian Ramadani, do të vërtitet që të sjellë gjëra dhe fakte të padëshiruara dhe me kosto të lartë për brezin tonë të ardhshëm, që përkojnë me epërsinë e egër të pushtetit maqedonas, grek, atij serb dhe me servilizmin e paparë të "pushtetarëve" shqiptarë.

Se çfarë mund të kuptojmë dhe si mund ta deshifrojmë personazhin e mjekut dhe të pacientit, betejat ndërmjet viruseve sulmues dhe mbrojtës, ruajtjen e imunitetit përmes aktiviteteve fizike dhe ligështimin e tyre, në brendësinë e këtyre kopertinave të këtij libri, lexuesi i nderuar do të ketë rastin dhe kënaqësinë që të notojë nëpër këto valë të këtij deti, që ndoshtë në një shikim sipërfaqësor nuk i shihet fare qarkorja e bregut të këtij deti.

Esetë dhe polemikat në fjalë nuk janë gjë tjetër, pos reflektim i asaj që rrodhi nëpër këto treva, mbase mund të jenë edhe emocionale, por ç'të bësh kur edhe më vajtuese është realiteti, i cili përmes atyre që e duan atë, vazhdon të nderohet ende me oksigjen të pastër, porse edhe sikur të gjithëve na bën me dije se një ditë,

po këtë oksigjen mund ta përdor për ndezjen dhe përshkallëzimin e zjarrit, mbase të gjithë e dimë se shkëndijat e para dhe përshkallëzimi i zjarrit nuk shkaktohen fillimisht prej shkrepëses, porse prej oksigjenit, pa të cilin zjarri as që mund të mendohej ndonjëherë. Deri atëherë mbetet të pritet.

Iljasa SALIHU
Kumanovë, Më 07 Mars, 2011

Recension për librin "Gjurmë Realitetesh"- Artikuj publicistikë dhe polemika, nga Mr. Ardian Ramadani

Është për tu përshëndetur fakti që në kohën e dhimbjes më të madhe të shqiptarëve, natyrisht të atyre të cilët duhen të mburren se jetojnë në ish principatën legjendare-Dardaninë, një shkrimtar i ri dhe mjaft produktiv, Mr. Ardian Ramadani, do me mish dhe me shpirt të na përkujtojë se koha për këta shqiptarë, për fat të keq nuk ec përpara. Koha ka ngecur ndokund nëpër disa kthina të çoroditura të të ashtuquajturve shqiptarë të cilët janë duke u udhëhequr këtë hapësirë. Është kjo një udhëheqje sa e padijshme aq edhe kërcënuese për atë pak pjesë të vogël dhe jo të kontaminuar të shqiptarëve, siç do ta kishte quajtur vetë autori i këtij libri i titulluar "**Gjurmë Realitetesh**" i cili është përmbledhje artikujsh publicistikë dhe polemika, të shkruara nga Mr. Ardian Ramadani.

Z. Ardian Ramadani, është pa dyshim një entuziast plot njohuri për rrethanat në të cilat gjendet ai, familja e tij si dhe të gjitha familjet shqiptare. Prandaj me freskinë e të menduarit, me origjinalitetin e të shprehurit-në stilin gjuha e përdorur në përputhje me realitetin mu ashtu si e përjeton ai vetë- si dhe me njohuri të gjëra nga jeta shoqërore por edhe ajo profesionale, ai i dhuron lexuesit shqiptar librin " Gjurmë Realitetesh". Kështu në këtë kohë të krizës, varfërisë, molisjes dhe tjetërsimit shpirtëror dhe mental, ky autor na bën që të vetëdijesohemi edhe më shumë për vuajtjet tona si

komb, duke mos harruar edhe shkaktarët e kësaj pozite në të cilën gjendemi.

"**Gjurmë Realitetesh**", si titull përmbledh në mënyrë tejet të logjikshme qasjet e autorit të cilat janë të përmbledhura në 21 artikuj, me tema mjaft serioze të cilat ngërthejnë në vete shumë të dhëna, shumë të vërteta në mënyrë tejet të guximshme të përpunuara, fakt ky i cili na dëshmon se ky autor nuk heziton tu rreket temave të cilat paraqesin dhe manifestojnë realitetin tonë të mjerueshëm. Në terrin e plotësishëm të cilin e ka krijuar nomenklatura momentale qeveritare, "Gjurmë Realitetesh", reflektojnë mesazh të drejtpërdrejtë tek lexuesi, duke përshkruar kështu kulturocidin ndaj krijimtarisë, pra censurimi i librit të bukur të shkruar në gjuhën shqipe, e sidomos libri i cili ngrit vetëdijen kombëtare, njollat e zeza të cilat paraqiten herë pas herë pa pikë nevoje në shoqërinë shqiptare, siç janë për shembull kidnapimet e shqiptarëve nga vetë shqiptarët, burgosjet e pafajshme të shqiptarëve për të kamufluar ndonjë skandal qeveritar, moszgjidhja e çështjes shqiptare, dhënie të shembujve se si do të kishte mundur të rregullojë ky vend raportet me popullin shqiptar duke propozuar sistemin politik të Belgjikës, si një model shpëtimtar, përshkrimi shumë i gjallë i dhimbjes së nënave dhe motrave shqiptare të cilat kanë dhënë bijtë dhe vëllezërit e tyre viktima të pafajshme, si dhe një vistër argumentesh, faktesh të shtjelluara në mënyrë të përkryer, të cilat nuk do të lënë as edhe lexuesin më të painformuar indiferent.

Gjuha në të cilën është e shkruar kjo përmbledhje, pra ky libër, është e pastër, me sintaksë të krehur

mirë, me një leksikë të pasur, elemente këto të cilat edhe më shumë e shtojnë peshën e këtij libri.

Duke i dëshiruar fat dhe suksese në karrierën e tij të mëtejshme, çdo lexues i cili e ka librin mikun më të mirë, do të pret me padurim librin e ardhshëm të Mr. Ardian Ramadanit, për të shtuar edhe më tutje jo vetëm numrin e librit shqiptar, por edhe cilësinë e tij si vlerë primare.

Doc. Dr. Vlera EJUPI
Shkup, 25 Mars, 2011

Recension për librin "Gjurmë Realitetesh"- Artikuj publicistikë dhe polemika, nga Mr. Ardian Ramadani

Libri i autorit Ardian Ramadanit "Artikuj publicistikë dhe polemika- Gjurmë realitetesh" paraqet orvatjet e vazhdueshme të një klase të re studiuesish dhe politikanësh, të cilët po bëjnë projekte, po japin mendime e ide rreth rregullimit të ri shoqëror, rreth proceseve politike në të cilat janë të përfshirë shqiptarët e Maqedonisë të cilët janë shtetformues, por edhe e përbëjnë pothuajse pjesën shumicë të popullatës atje, pastaj shqiptarët e Kosovës Lindore dhe ata të Malit të Zi, të cilët domosdoshmërisht janë pjesë e integrimeve ndërshqiptare, por edhe e rregullimeve të ardhshme ndërshtetërore.

Integrimi ndërshqiptar është njëra ndër komponentat e rëndësishme të stabilitetit të rajonit por edhe më gjerë. Trajtimi i këtyre koncepteve që ndërlidhen me shtetndërtimin, format dhe mundësitë e realizimit të këtyre projekteve janë versione edhe më të hershme, disa prej tyre që nga Rilindja Kombëtare e që janë përcjellë deri në ditët e sotme. Këto teori, versione e ide janë duke u ripunuar dhe zgjeruar në forma të ndryshme, të pranueshme dhe që janë në përputhshmëri me zhvillimet ndërkombëtare të dekadave të fundit.

Rënia e komunizmit ia hapi rrugën krijimit të shteteve të reja në hapësirat e ish-Jugosllavisë, duke

përfshirë në këtë kontest edhe krijimin e shteteve të reja të dala nga shpërbërja e ish-BRSS-së, pastaj bashkimi i dy Gjermanive etj.

Trajtimi i sistemit politik të Belgjikës, me të gjitha predispozitat, mangësitë dhe përparësitë, duke përfshirë këtu edhe shkallën e zhvillimit të organizimit politik të saj, aspektet e zhvillimit kushtetues, historikun zhvillimor të shtetit (mbretërisë belge), federalizmin e Belgjikës, kompetencat e mbretit, komunitetet në Belgjikë etj., që shpesh është propozuar që komunitetet në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi etj., të kenë statusin e komuniteteve sikurse në Belgjikë, për të kaluar pastaj tek struktura e shtetit belg, ndarja territoriale, religjioni, mënyra e votimit nëpër zona elektorale, për të përfunduar me statusin e Brukselit-kryeqytet, komunitetin francez në Belgjikë, partitë politike e trajtime të tjera, që janë studiuar dhe analizuar mjaft mirë dhe që mund të shërbejnë për metoda komparative dhe trajtime të tjera të rregullimeve shtetërore brenda shtetit të Maqedonisë por edhe të komunitetit shqiptar që jeton në Mal të Zi, Serbi etj.

Libri i Ardian Ramadanit "Artikuj publicistikë dhe polemika-Gjurmë realitetesh", është një interpretim i ideve dhe qasjes kritike ndaj disa fenomeneve negative në Maqedoni, veçanërisht ndaj shkeljes së të drejtave morale dhe njerëzore të shqiptarëve nga shteti. Trajtimet e Ramadanit, të përmbledhura në këtë libër, janë një hulumtim dhe reflektim mbi ngjarjet dhe fenomenet e shoqërisë, që e preokupojnë një klasë të shoqërisë

shqiptare, në mesin e tyre edhe Ardian Ramadanin, të cilët përpiqen t'i tejkalojnë këto dukuri dhe fenomene, duke dhënë propozime konkrete për të dalë nga kaosi që e ka pllakosur shoqërinë shqiptare në Maqedoni.

Është vërtetuar shkencërisht se kombet nuk dhurohen, por krijohen nga shtete e nacionalistë. Individët shpesh duhet të zgjedhin mes një morie nacionalizmash konkurruese. Ndërtimi i shumë përmendoreve maqedonase që po bëhet në qendër të Shkupit e gjetiu, në njërën anë, dhe mohimi i gjuhës dhe shkelja e të drejtave njerëzore e kombëtare të shqiptarëve atje, burgosja e vijës nacionaliste dhe e çlirimtarëve, botimi i enciklopedisë maqedonase që falsifikon historinë dhe fyen shqiptarët, mohimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe i dygjuhësisë, e ka ngritur lartë artificialisht nacionalizmin maqedonas edhe pse maqedonasit kanë krizë të thellë identiteti. Përmes këtyre veprimeve është tkurrur elementi nacional shqiptar, duke e bërë gjendjen e shqiptarëve – si komb shtetformues në Maqedoni, të padurueshme. Kjo ndodhë kur të mohohen të drejtat kushtetuese dhe sanksionohen të drejtat dhe liritë e njeriut nga pushtetmbajtësit, siç po ndodhë çdo ditë me shqiptarët në Maqedoni.

Në artikullin "Karakteristikat e një lloj lideri", nëpërmjet të cilit paraqiten karakteristikat e liderit, roli i liderit në shoqëri, lidershipi si koncept udhëheqës, pushteti dhe lideri, lideri modern, lideri i përhershëm, lideri i mirëfilltë etj., janë trajtime se si duhet të jetë udhëheqësi shqiptar në Maqedoni, por edhe më gjerë.

Kultura dhe organizimi i shoqërisë janë universale dhe të përhershme. Ndërkaq, shtetet dhe nacionalizmi nuk janë të tilla. Nuk janë të tilla sepse strukturat nacionaliste në ushtrinë dhe policinë maqedonase organizuan vrasjen e Harun Aliut, njërit ndër komandantët më të zotë dhe më dinjitozë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni (UÇK-om), i cili bashkë me qindra bashkëluftëtarë të tjerë luftuan që shqiptarët t'i gëzonin jo vetëm të drejtat që ju takojnë sot por edhe ato që iu premtuan gjatë luftës për krijimin e Maqedonisë si shtet, si para 1974-ës, ashtu edhe pas 1988-ës.

Shqiptarët vazhdimisht iu nënshtruan represioneve më të ndryshme. Kjo situatë mundësoi një tolerancë të brishtë dhe të paqëndrueshme të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, praktikisht në Maqedoni. Ushtria Çlirimtare Kombëtare i dha fund një pushteti të vjetër, i cili u zëvendësua me struktura të përafërta me ato të vjetrat, të cilat po e vazhdojnë luftën e tyre kundërshqiptare me veprimtari antidemografike, me masa kundër përdorimit të gjuhës shqipe, me masa kundër historisë dhe kulturës shqiptare, me mohim të posedimit të territorit etj., që përmblidhen në artikullin "Dilema e shtetit të Maqedonisë: rusizëm apo europianizëm".

Shkrimet që i ofrohen lexuesit në këtë libër të autorit Ramadani, janë një përmbledhje e shkëlqyeshme që pasqyrojnë situatën politike dhe kulturore të shqiptarëve në Maqedoni, por edhe më gjerë. Në këtë libër trajtohen ngjarje dhe paraqiten ide, ku janë analizuar mirë konceptet e shqiptarëve në Maqedoni,

paraqitet shkoqur ecuria për të ardhmen dhe sukseset e pritshme të popullit shqiptar që jeton në Maqedoni.

Mr. Faton Mehmetaj
Deçan, Më 10 mars 2011

Pasqyra e lëndës:

PARATHËNIE 7

RECENSION PËR LIBRIN "GJURMË REALITETESH"- ARTIKUJ PUBLICISTIKË DHE POLEMIKA, NGA MR. ARDIAN RAMADANI 11

RECENSION PËR LIBRIN "GJURMË REALITETESH"- ARTIKUJ PUBLICISTIKË DHE POLEMIKA, NGA MR. ARDIAN RAMADANI 14

SISTEMI POLITIK I BELGJIKËS- MODEL SHPËTIMTAR PËR MAQEDONINË 21

1.Belgjika - prezentim i monarkisë parlamentare belge 21

2. Sistemi politik belg 24

3. Kushtetuta e Belgjikës-federalizmi belg 25

4. Kompetencat e mbretit 34

5. Komunitetet në belgjikë bashkëqeverisin apo 36

6. Religjioni 40

7. Sistemi politik i belgjikës dhe institucionet e saja 41

8. Statusi i brukselit-kryeqytet 43

9. Komuniteti francez i belgjikës 50

10.Parlamenti dhe senati belg 53

11. Partitë politike në belgjikë 54

Konkluzion 57

REXHAILI DHE GJITHË TË BURGOSURIT TJERË JANË ABSOLUTISHT TË PAFAJSHËM 59

I BURGOSURI SHQIPTAR ENDE PO PRET, E QEVERITARI SHQIPTAR PO LAHET NË DET 63

NËNË MOJ, MBAJ ZI PËR VËLLANË *(HARUN ALIUT-KUSHTRIMIT)* 67

KULTUROCIDI NDAJ LIBRIT SHQIP NË MAQEDONI 72

TË FOLURIT EVROPIAN, TË VEPRUARIT DHE TË MENDUARIT BIZANTIN 75
DO TË DALIM, NUK DO TË DALIM..... 78
TENTATIVAT PËR KIDNAPIME: OBSESIONE APO REALITETE 81
KARAKTERISTIKAT E NJË LLOJ LIDERI 84
DILEMA E SHTETIT TË MAQEDONISË: RUSIZIM APO EVROPIANIZIM 92
MBRESAT E NJË VIZITE TË PAHARRUAR (NË KULLËN E JASHARAJVE)..... 96
UEJL- PROJEKT I MADH KOMBËTAR I SHQIPTARËVE NË MAQEDONI DHE REZULTAT I POLITIKËS SË MENÇUR TË ARBËR XHAFERIT 111
A KANË NEVOJË SHQIPTARËT NË MAQEDONI PËR PARTI TË REJA POLITIKE? 115
MBRESAT NGA VIZITA E BËRË MËMËDHEUT..... 126
NËNTË VITE STAGNIM DHE ZVARRITJE TË MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT 135
SHQIPTARËT NUK E KANË ENDE TË ZGJIDHUR PROBLEMIN KOMBËTAR, PO TI MOS VETËKRIJO PROBLEM FETAR..... 147
MISIONARI NACIONALIST ME KOKARDËN E FSHEHTË TË "CËRNA RUKËS", NË MISIONIN E TIJ ANTIKOMBËTAR..... 154
KASTRIOT MYFTARAJ, KRYEPLAKU I ÇMENDUR I MËHALLËS SË TË ÇMENDURVE, ALIAS SHPIKËSI ANTISHQIPTAR I "RACIZMIT BRENDASHQIPTAR".....171
KONKLUZIONE 186
KËNGËT E BIN LADENIT DHE VEHABIZMI, THIRRJET E DOM ANTON KÇIRËS DHE THIRRJET SHËN BARTOLOMEISTE, RREZIKU I RI PËR KOMBIN SHQIPTAR..... 198

SISTEMI POLITIK I BELGJIKËS-MODEL SHPËTIMTAR PËR MAQEDONINË

1. BELGJIKA - PREZENTIM I MONARKISË PARLAMENTARE BELGE

"**Mbretëria Belge**" (flamenisht: **Koninkrijk België;** frëngjisht: **Royaume de Belgique;** gjermanisht: **Königreich Belgien)** ndodhet në pjesën perëndimore të Evropës dhe kufizohet me Holandën, Gjermaninë, Luksemburgun dhe Francën. Belgjika ka mbi dhjetë milionë banorë, që jetojnë në një sipërfaqe prej rreth tridhjetë mijë kilometra katrorë. Ndikimi i përhershëm i gjermanishtes dhe asaj romake kanë përshkruar dhe ndarë kulturën dhe linguistikën belge. Belgët flasin kryesisht dy gjuhë: gjuhën flamane (neederlands), e folur në veri dhe frëngjishtja në rajonin Valon, në jug të Belgjikës. Rajoni kryesor i saj është ai i Brukselit në të cilin zyrtarisht fliten të dy gjuhët. Pakicë e njohur zyrtarisht janë folësit e gjermanishtes, që në ditët e sotme jetojnë në lindje të vendit. Këto dallime gjuhësore reflektohen edhe në politiken e tanishme të Belgjikës si dhe në jetën belge.

Termi Belgjikë vjen nga banuesit e parë të këtij vendi "belgët", fis keltë të njohur nga provinca romake, Galia belge. Në të kaluarën e largët, Belgjika ka qenë pjesë e tokave të ulëta (Beneluksi) në të cilat bënte pjesë edhe Holanda dhe Luksemburgu. Që nga gjysma e

mesjetës deri në shekullin e XVII, ky vend ka qenë qendër kulturore dhe tregtare e këtij rajoni evropian. Nga shekulli i XVI deri në kohën e pavarësisë së Belgjikës, rrethina e saj quhej "Holanda jugore" dhe ishte fushëbetejë e fuqive evropiane.

Belgjika është një ndër anëtaret dhe themeluesit e Bashkimit Evropian (BE) dhe në tokën e saj ka kryeqendra organizatave të ndryshme evropiane dhe botërore, të tilla si p.sh. NATO etj.

Që të njihemi më mirë me shtetin dhjetë milionësh të Mbretërisë së Belgjikës, e cila kufizohet me Francën, Gjermaninë dhe Luksemburgun në veriperëndim të Evropës, është e arsyeshme që të hyjmë në esencën e morfologjisë së kushtetutës dhe historisë së këtij shteti, ndoshta më saktë të popujve të saj.

Shteti i Belgjikës, pra siç e potencuam edhe më lartë, ka fituar emrin nga Belgët e fiseve me prejardhje kelte, të cilët ishin të vendosur në territorin ndërmjet liqenit Seina dhe Raina. Duke e pushtuar këtë vend Cezari e quajti Galia Belgica e ngjashme me atë që e quajmë sot Francë, kurse në kohën romake quhej thjeshtë Galia. Francezët Saliciskë këtë vend e pushtojnë më shekullin V. pas erës së re. dhe u vendosen në kufi të gjuhëve, (flamanët dhe valonë) si ndarje e fizionomisë etnike-romake dhe gjermane. Këtë vend me shekuj e ndanin princat dhe grofët gjermanë dhe ata francezë. Vendi historik i Belgjikës ishte qendra e luftërave në kohën e re. Në luftërat ky vend hyn nën juridiksionin spanjoll. Mandej aneksohet nga francezët dhe nga ana e Monarkisë Habsburge të pushtetit (austriak). Në kohën

e Napoleonit ky vend hyn në sistemin shtetëror të Francës (të nëntë departamenteve franceze).

Me vendimet e Kongresit të Berlinit (1815), territori i Belgjikës i bashkohet mbretërisë së Holandës, ***(fr. Royaume Uni des Pays –Bas)*** si element dominues në Qeveri. Me revolucionin francez shpërtheu kryengritje politike në Bruksel. Qeveria e përkohshme shpall pavarësinë më 4 tetor të vitit 1830. Në Konferencën e ambasadorëve në Londër, më 1831 vërtetohet pavarësia e shtetit të Belgjikës.[1]

Sipas kushtetutës të vitit 1831 Belgjika ka qenë monarki kushtetuese-parlamentare, nga brezi mashkullor i shtëpisë Sachsen-Gotha, i themeluar si shtet (unitar) dhe i decentralizuar. ***(Etat unitaire dêcantralisê).*** Si i tillë ka ekzistuar deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 1970, nëse marrim parasysh edhe jo shumë të rëndësishmet ndryshimet kushtetuese të vitit 1893 dhe 1921. Morfologjia kushtetuese e Belgjikës ka qenë relative e thjeshtë dhe transparente. Pas pushtetit qendror kanë ekzistuar rajone dhe komuna, por jo me pushtetin që kanë sot ***(si për shembull autonominë fiskale).*** Me shprehjen politike e quanim "doktrina e tre rretheve shtetërore" (doctrine des trois cercles), e cila i përgjigjej konceptit të Montesquiesë mbi pushtetin e ndarë, në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Ndërsa edhe sot Belgjika është monarki kushtetuese dhe parlamentare, e cila funksionon në bazë të parimit të demokracisë reprezentative. Parlamenti

[1] Clausener-Petit, Magali, Marine Lath-Jeunesse : Des Ados en Europe, Paris 1999, fq. 95

zgjidhet nga shumica parlamentare proporcionale. Vota është e obligueshme.

2. SISTEMI POLITIK BELG

Belgjika përbëhet nga 3 komunitete: komuniteti francez, flaman dhe gjermanofon. Ajo përbëhet poashtu edhe nga 3 rajone, edhe atë: Valonia, Flandria dhe kryeqyteti Bruksel apo në ***fr. Bruxelles-Capitale.*** Këto tre rajone përbëjnë shtetin federal. Disa dispozita garantojnë ekuilibrin linguistik ose kushtetues në sajë të zonave gjeografike. Pra, Belgjika është shtet federal si dhe në të njëjtën kohë monarki parlamentare dhe kushtetuese. Ky sistem politik në të cilin Qeveria është përgjegjëse përpara Parlamentit të zgjedhur në mënyrë proporcionale, duhet të ketë pushtet ekzekutiv, i cili duhet të jetë i formuar nga koalicioni i partive të cilët disponojnë me shumicën në Parlament. Prej këtu rrjedh tendenca e të qenit monarki parlamentare. Influenca e partive e posaçërisht e kryetarëve të partive është tejet i madh, për këtë arsye disa politolog dhe analistë e krahasojnë këtë tendencë me partiokracinë. Politizimi i tillë, e gjithashtu edhe pushteti i Qeverisë dhe kohezioni i madh i grupeve parlamentare, ndikojnë që shumica parlamentare të ndjek dhe të sjell në shumicën e rasteve vendimet e ekzekutivit, pra Qeverisë.

Kushtetuta belge cila përjetoi katër reforma suksesive edhe atë 1970, 1980, 1988-89 dhe 1993-94, thekson ndarje precize dhe tejet të qartë në mes tre komuniteteve e posaçërisht kjo ndarje vërehet kryesisht

në nivelin e qytetit të Brukselit, i cili njëkohësisht është edhe kryeqytet i Belgjikës.

Tendenca federale e Belgjikës vërehet edhe në kushtetutën e saj.

3. KUSHTETUTA E BELGJIKËS-FEDERALIZMI BELG

Për të kuptuar më mirë federalizmin belg, mjafton që të lexojmë pesë nenet e Kushtetutës belge.

Neni 1

Belgjika është shtet federal i cili përbëhet prej bashkësive dhe rajoneve.

Neni 2

Belgjika ka tri bashkësi: bashkësia franceze, bashkësia flamane dhe bashkësia gjermanofolëse.

Neni 3

Belgjika ka tre rajone: rajoni Valon, rajoni Flaman, rajoni i Brukselit (kryeqytetit).

Neni 4

Belgjika ka tre rajone gjuhësore: rajoni i gjuhës franceze, rajoni i gjuhës holandeze dhe rajoni dy gjuhësorë i Brukselit – kryeqyteti (Bruxelles-capitale) dhe rajoni gjermanofolës.

Neni 5

Rajoni valon përbëhet nga këta provinca: Brabanti Valon, Hainut Liege, Luksemburg dhe Namur. Rajoni Flaman përbëhet nga këto provinca: Anvers (në holandezen Antwerpen), Brapanti Flaman, Flandrija Perëndimore, Flandrija Lindore dhe Limburgu.

Mbreti belg, Albert II, shpalli Kushtetutën e re më 17 shkurt të vitit 1994. Kushtetuta ka **198 nene dhe është e ndarë në 9 kapituj**. Në krahasim me Kushtetutën e vitit 1831, Belgjika ka pasur 139 kapituj. Me ndryshimet dhe plotësimet suksesive të Kushtetutës së vitit 1893 dhe 1921 dhe në veçanti me amendamentet kushtetuese të vitit 1970, 1980, 1988, 1993 ka ardhur deri te ndryshimet substanciare të rregullimit të Kushtetutës belge, e cila në asnjë mënyrë nuk mundë të shikohet si harmonizim i gjuhëve apo si kozmetikë gjuhësore.

Në themelet e shtetit belg akoma është ideja e kombit si është koncipuar në shekullin XIX, edhe atë se "krejt pushteti del nga kombi" (neni. 33. i kushtetutës). Por, që të frenohet partikularizimi rajonal, me nenin 42 të Kushtetutës qartë është e precizuar që "anëtarët e të dy dhomave e prezantojnë kombin e jo vetëm ata që i kanë zgjedhur". Ligjvënësi me këtë "përfaqësuesin e kombit e ka përkthyer në përfaqësues të kombit sovran".[2]

Tendencat Centrifugale të federalizmit belg janë që t`i largohen ligjshmërisë së federatës klasike, ***(e deversitata unitas).*** Por, qendërsynueset apo (centripetalët) e fuqishëm nuk janë vetëm fryte të ndjenjave të solidaritetit të bashkësisë si dhe të gjithë njësive konstituive të shtetit, por edhe të vet faktit që kushtetutat e tre komuniteteve etnike taksativisht emërojnë kompetencat federale në mënyrë që kompetencat t`ju barten njësive federale. Pikërisht për këtë, në pjesën suksesive të ndryshimeve kushtetuese, Belgjika si shtet thjesht i

[2] Preface de Pat Cox: Le parlement Européen, Paris 2002, fq. 4. Pat Cox ka qenë më 2002 president i Parlamentit Evropian.

decentralizuar është krijuar me lidhje të bashkësive politike.

Kjo është edhe ajo që e ka thënë në Parlament kryeministri i atëhershëm belg, Georgies Eysken, me rastin e miratimit të ndryshimeve të amendamenteve të vitit 1970, "ndodhitë e kanë shkelur shtetin unitar". [3]

Në lidhje me nenin 2 të Kushtetutës (rregullimi i bashkësive), duhet theksuar që bashkëjetesën (commnu-nautorisation) kryesisht e kishin potencuar flamanët duke insistuar në legalizimin dhe zhvillimin e gjuhës dhe kulturës së tyre, valonët kishin insistuar në rajonalizëm me qëllim që të kenë autonominë në planin ekonomik e social dhe me qëllim që sa më mirë të zgjidhnin krizën ekonomike në vendin e tyre. Frankofonët e Brukselit, për ndryshe me shumicë të përfaqësuar në rajonin e Brukselit (në kryeqytet), pretendonin në riorganizim që ky rajon të jetë entitet i veçantë me pushtet të njëjtë si ishin edhe rajonet e valonëve dhe flamanëve. Me këtë arritën sukses nëpërmjet amendamenteve të miratuara në vitin 1988, në të të cilën rajoni i Brukselit u riorganizua në rajon të Brukselit (kryeqyteti). Me dispozitat e nenit, 166, alineja 2 të Kushtetutës trupat e këtij rajoni përfaqësojnë njëkohësisht edhe rajonin edhe krahinën, kurse bashkësitë dhe rajonet kanë Këshilla ligjvënëse ***(Conseil)*** dhe organet ekzekutive ***(Gouvermente-Qeveria).*** Puna mbi veprimtarinë e tyre rregullohet me Kushtetutën federale në bazë të ligjeve të miratuara me mazhorancë të veçantë (loi federale à majorite speciale), me fjalë të tjera ligji votohet me votat

[3] Daniel, Maja/ Jean Marie, Achard: L`état du monde junior-Encyclopédie historique et géopolitique, Paris 2002, fq.11.

e mazhorancës së të dy bashkësive gjuhësore të të dy parlamenteve, si dhe nëse numri i votave pozitive të të dy bashkësive gjuhësore arrin dy të tretat e shumicës së votuesve (neni 4, alineja 3 e kushtetutës). Ky shembull i votimit aplikohet vetëm në rastet taksative të parapara në Kushtetutë, kurse trupat e bashkësisë flamane njëkohësisht përfaqësojnë rajonin flaman, që do të thotë te flamanët institucionalizohet vetëm Këshilli flaman (neni 124 i kushtetutës), por te valonët ekzistojnë këshilla të veçanta të bashkësisë ***françeze (Conseil de la Communauté française)*** nga gjithsejtë 94 anëtarë të zgjedhur të Këshillit të rajonit Valonas (Conseil regional wallon), edhe atë me 75 anëtarë të zgjedhur. Kjo bëhet nga shkaku se kompetencat e bashkësisë flamane dhe asaj valonase njëkohësisht shtrihen në territorin e rajonit bilingual të Brukselit- (kryeqytet), (neni 115- 120 i Kushtetutës).[4]

Bashkësitë e rajoneve kanë trupa të veçantë ligjvënëse për dallim nga ata të federatës ligjvënëse. Për pyetjet e shumta si janë (kultura, arsimi, shfrytëzimi i gjuhës në disa raste si dhe pyetje statutare), bashkësitë dhe rajonet miratojnë vendime (dekrete) me fuqi ligjore. Ato vendime i nënshtrohen gjykatës arbitrare ashtu si edhe ligjet federale. Ky specificitet i rregullimit të Kushtetutës belge, është ndryshe në krahasim më disa ligje federale. Në këtë rast nuk vlen parimi, që ligjet federale të refuzojnë ato rajonale ***(Bundesrecht bricht***

[4] La constitution belge, Octobre 2007 Chambre des representant, fq.15

Landerecht), por vlen parimi komulativ ***(ratione materia i ratioe laci).***[5]

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1970 futet në përdorim sistemi trilinguistik me gjuhët franceze, flamane (me ngjashmëri holandeze) dhe gjermane, ku secila nga bashkësitë gjuhësore ka aparatin e vet ligjvënës ***(Conseil),*** i cili ka fushëveprim në lëmin e kompetencave politike si p.sh. që të miratojë dispozita me fuqi ligjore ***(dekret ayant force de loi),*** në lëmin e aktiviteteve kulturore, sistemit arsimor dhe politikës së punësimit.

Me nenin 24 të Kushtetutës janë dhënë garanci më të shumta në sistemin e arsimit. Që të pengohen iniciativat ligjore të njërës nga dy dhomat e Parlamentit me qëllim që me iniciativat ligjore të prishen të arriturat mes dy bashkësive gjuhësore, neni 54 i Kushtetutës parasheh procedurë të veçantë, e ashtuquajtura procedura të alarmit (procedure de sonneté d'alarme). Kjo dispozitë kushtetuese jep mundësi njërës nga dy bashkësitë gjuhësore, që të suspendojnë iniciativat ligjore për 30 ditë, deri sa për propozimin, prapë me konsensus të deklarohet Qeveria e cila vet është e konstituuar në bazën e paritetit të ministrave flaman dhe atyre valon. [6]

Ky arsenal i mekanizmit kushtetues e arsyeton strukturën bipolare të shtetit të Belgjikës, meqenëse ekzistimi i Belgjikës varet nga koekzistenca dhe bash-

---

[5] Jean, Meynaud, Jean, Ladriere, François, Perin, La Decision politique en Belgique, CRISP Bruxelles et Librairie, Arman Colin, 195, fq. 110

[6] Charles Etienne Lagasse, Les nouvelles institutions politiques de la Belgique et de l`Europe, Erasme, Namur, 2003. fq. 182

këjetesa mes të dy bashkësive gjuhësore në të njëjtin territor. Por, edhe vetë fakti tjetër është, që struktura bipolare mundet të paralizojë shtetin federal meqë secila nga të dy bashkësitë gjuhësore kanë fuqi të neutralizojnë njëra-tjetrën, meqenëse vetë modeli i Kushtetutës belge është sistem i kompleksit të frenimit. Me qëllim që të ndërpritet centralizimi, krijuesi i kushtetutës belge i ka rregulluar krahinat dhe komunat si pushtet subordinar (të varur) " krejt në interes të krahinave dhe komunave" (neni 41dhe 162 i Kushtetutës). Por, është e nevojshme të sqarohet që krejt vendimet dhe aktet e pushtetit lokal janë nën mbikëqyrjen e organeve të tutorit ***(organe de tutella),*** me qëllim që të mos vjen deri te prishja e ligjit dhe të rrezikohet interesi i përgjithshëm (neni 162 alineja 2 e Kushtetutës).

Komunat dhe aglomeracionet mund të bashkohen në shoqata apo lidhje të komunave (federations de communes), por vetëm në bazë të ligjit. Secila nga ata kanë Këshillin deliberativ ***(Conseil)*** dhe organin e ekzekutivit ***(College executif).*** Me nenin 165 të Kushtetutës mundësohet themelimi i trupave të cilët do t`i koordinojnë interesat e aglomeracioneve dhe lidhjeve të komunave, me qëllim që të bashkëpunojnë bashkërisht në punët teknike siç janë: uji, komunikacioni, shkollat, spitalet e komunës dhe të qytetit. Interesante është alineja 3 e këtij neni kushtetues, që këshilltarëve të këtyre këshillave ua ndalon të vendosin në seancat e përbashkëta.

Pyetjet e financimit të bashkësive dhe rajoneve në Belgjikë, kanë paraqitur një problem, sepse deri në vitin 1980 ata janë financuar nga buxheti dhe donacio-

net e federatës. Mjetet e shpërndara janë harmonizuar në parimin e fortifikimit të qëllimit. Bashkësitë dhe rajonet lirshëm kanë deleguar mjetet financiare deri te shfrytëzuesit e buxhetit dhe në organet më të ulëta.

Me amendamentet kushtetuese të vitit 1980, bashkësitë dhe rajonet janë kompetente të grumbullojnë taksat dhe tatimet ***(neni 170 alineja 1 e kushtetutës).*** Por, të drejtën për autonomi fiskale teorikisht e kanë të dy bashkësitë flamane dhe valone, meqë kushtetuta askund në mënyrë taksative nuk precizon në cilin vend konkret të bashkësive apo rajoneve mund të kryejnë të drejtën e tyre fiskale, (Nullum ius sine terae), por ajo e drejtë nuk mundet të aplikohet në të njëjtin vend fiskal, dhe nuk mund të grumbullohen mjete financiare në dy xhirollogari. Kjo në praktikë do të thotë se nëse në një vend fiskal ka tatim federal, si për shembull mbrojtja e ambientit jetësorë, atëherë bashkësitë dhe rajonet nuk munden të caktojnë të njëjtin tatim për nevojat e buxhetit të tyre ***(neni 175 dhe 177 të kushtetutës).***[7]

Sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare, shteti belg ka shkuar shumë përpara, në krahasim me shtetet tjera federale. Kushtetuta e re e Belgjikës artikulohet në dy shtylla kryesore: subjekte federale ***(bashkësi dhe rajone),*** të cilëve ju është dhënë mundësia maksimale në raport apo në bashkëpunim me faktorin juridik ndërkombëtar, kurse qeverisjes federale i`u është dhënë mundësia që të forcohet nëpërmjet subjekteve ndërkombëtare dhe supranacionale në të drejtat dhe obligimet e saja. ***(neni 167 i kushtetutës).*** Kësisoj bashkësitë dhe

[7] Yves Quairiaux, L`image du Flamand et Wallonie, Labor, Bruxelles, 2006, fq.74

rajonet munden të nënshkruajnë kontrata ndërkombëtare (por vetëm në pyetjet taksative të parapara me Kushtetutë me pëlqim suplementarë, por jo edhe me pëlqimin e të dy Dhomave të Parlamentit ***(neni 167 alineja 2 e Kushtetutës).***

Më hollësisht kjo bëhet për dy shkaqe: me mundësinë që ose shteti i Belgjikës nuk e ka pranuar atë shtet, ose nuk ka lidhur marrëdhënie diplomatike, ose janë lidhur marrëveshjet, por në rrethana të trazuara diplomatike, ose ka mundësi që shteti i Belgjikës të ketë bërë marrëveshje ndërshtetërore në planin ndërkombëtarë supranacional ***(si p.sh. anëtarësimi në Unionin Europian neni 169 i Kushtetutës).***[8]

Në kategorinë e veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare, është edhe bashkëpunimi në fushën e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare. Edhe për këtë pyetje Kushtetuta e re e Belgjikës u mundëson rajoneve ingerenca shumë të mëdha ***(neni 134 i kushtetutës),*** duke precizuar se prej tash rajonet në mënyrë autonome mund të udhëheqin politikën e tyre ekonomike në planin ndërkombëtar. Pushteti federal edhe më tej do të ketë kompetencat në garancionet dhe atë në punët tregtare me jashtë në lëmin e investimeve, punëve promovuese, si dhe në politikën e bashkëpunimit koordinues. Me dispozitat e reja kushtetuese rajoneve ju mundësohet që të hapin përfaqësitë e tyre ekonomike jashtë vendit, me ç`rast nuk përjashtohet mundësia që rajonet bashkërisht të punojnë nëpërmjet marrëveshjeve inter-rajonale.

---

[8] Po aty, fq. 77.

Për bashkëpunim sa më të frytshëm, Qeveria federale është e obliguar të raportojë në Parlamentin federal ***(Conseil)*** dhe parlamentet e bashkësive dhe rajoneve, në lidhje me krejt propozimet mbi ndryshimet dhe plotësimet e kontratave ndërkombëtare, e në veçanti atyre që dalin nga anëtarësimi i Belgjikës në Unionin Evropian. Kjo është shumë me rëndësi, meqë neni 146 i kontratës së Mastrichtit i mundëson vendeve anëtare që në trupat punuese, shtetet anëtare të mund të përfaqësohen nga përfaqësuesit e njësive federale, kur është në pyetje çështja që ka të bëjë drejtpërdrejtë me kompetencat e bashkësive dhe rajoneve. Këto lloj ingerencash të mëdha në marrëdhëniet ndërkombëtare i fut disa konstitucionalistë në konkluzione që kur është në pyetje, Kushtetuta e Belgjikës, të japin fizionominë e konfederatës së shtetit të Belgjikës ***(sui generis)*** apo e llojit të veçantë. Andaj me të drejtë konstatohen tendencat e të qenit shtet konfederal.

Me rëndësi poashtu grandioze në Kushtetutën re të Belgjikës, është edhe rregullimi i Gjyqit arbitrar ***(Cour d' Arbitrage),*** i rregulluar me ndryshimet kushtetuese të vitit 1980. Ky institucion në mënyrë progresive ka fituar prerogativë të Gjyqit kushtetues klasik (***neni 142 i kushtetutës).*** Prej pavarësisë së shtetit mbrojtja e kushtetutshmërisë ka qenë vetëm nën ligjvënësin (sovranë dhe parlamentin) e jo edhe nën gjykatësit e ndonjërit trup të Gjykatës së Lartë. Deri atëherë Gjykatat arbitrare kanë mundur të drejtohen në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë deri te faktorët politik. Me këtë reformë Gjykata Arbitrare është akcesibile për, ***"secilin person që ka interes juridik" (neni. 142 i kushtetutës), e cila nënkupton edhe secilin subjekt juridik apo fizik.***

4. KOMPETENCAT E MBRETIT

Meqenëse Belgjika është monarki kushtetuese, personi sovran (Mbreti) ka rol kryesorë, por jo edhe rol protokollar. "Mbreti emëron dhe shkarkon ministrat" (neni 96 i kushtetutës) dhe "sekretarët shtetërorë federal " (neni 104 i kushtetutës). Ai "udhëheq me marrëdhëniet ndërkombëtare" (neni 167 i kushtetutës), prej nga del edhe e drejta e emërimit në akreditimin e ambasadorëve (neni 107 i kushtetutës). Mbreti njëkohësisht udhëheq edhe me forcat ushtarake, verifikon gjendjen luftarake dhe ndërprerjen e armiqësisë "(neni 167 alineja 1 e kushtetutës)". Mbreti verifikon kontratat ndërkombëtare "(neni 167 alineja 2 e kushtetutës). Ai "mund të kontestoj kontratat e mëparshme ndërkombëtare" (neni 167 alineja 5 e kushtetutës), "sanksionon dhe shpall ligjet" (neni 109 i kushtetutës), " ka të drejtën të fal dhe zvogëlojë dënimet gjyqësore" (neni 110 i kushtetutës). Në emrin e Mbretit shtypen valutat' (neni 111 i kushtetutës), mbreti "jep apo gradon personat ushtarak" (neni 107 i kushtetutës), ai "ka të drejtë të thërrasë seanca të jashtëzakonshme në parlament" (neni 44 i kushtetutës). Mbreti" përfundon seancat e sesioneve të parlamentit" (neni 44 alineja 3 e kushtetutës), "ka të drejtë të ndajë dekorata, por pa asnjë privilegj personal" (neni 113 i kushtetutës). Duhet të rikujtohet që " personi Mbret është i paprekshëm dhe i pacenueshëm" dhe që ministrat e tij janë përgjegjës" (neni 88 i kushtetutës). Prej këtu në hollësi dalin edhe këto dispozita kushtetuese: asnjëri nga aktet e Mbretit nuk kanë fuqi ligjore, nëse nuk e nënshkruan edhe ministri, me çka i njëjti bëhet edhe përgjegjës (neni 106 i kushtetutës). Përgjegjësia e ministrit rregullohet me nenin

101 të kushtetutës." Ministrat janë përgjegjës edhe të dhomave përfaqësuese të parlamenteve".

Sa u përket ingerencave gjyqësore të pushtetit federal dhe njësive federale, Kushtetuta e Belgjikës është kryesisht e shkurtë në këta hollësi, gjitha ingerencat i janë lënë rregullativës ligjore. Në dispozitën III të qeverisjes sa i përket rregullimit gjyqësor, është relevant vetëm neni 40 i Kushtetutës që shpreh se: "Qeverisjen gjyqësore e udhëheqin gjyqet e ultë dhe ata të lartë-tribunalet (cours et tribunaux –faq. 1.), zgjidhjet gjyqësore dhe aktvendimet i kryejnë (a nuk mund edhe ti shpallin) në emrin e Mbretit" (alineja 2). Sa ju përket trupave të lartë gjyqësorë, Kushtetuta belge precizon edhe: " Organizimin e gjyqit (Cour de Cassasion) për krejt shtetin e Belgjikës" (neni 147 alineja 1 e kushtetutës). Në Belgjikë ka pesë gjyqe të apelacionit (neni 156 i kushtetutës). Në kuadër të shtetit belg funksionojnë edhe gjyqet e shtetit në formë të këshillave (Conseil d' Etat), me kompetenca të punës të parapara me ligj (neni 160 i kushtetutës).

Dispozitat dhe organizimin e formacioneve të sigurimit ushtarak në Kushtetutën belge mund t`i gjejmë vetëm tek këto dispozita ligjore, edhe atë si vijojnë: mënyrën e regrutimit në njësitë ushtarake e cila rregullohet me ligj, e gjejmë tek neni 182 i Kushtetutës si dhe organizimin dhe kompetencat e xhandarmërisë të cilat rregullohen me ligj i gjejmë tek neni 184 i Kushtetutës. Kushtetuta e Belgjikës në asnjë fjalë nuk përmend në mënyrë eksplicite rregullimin, kompetencat, dislokimin dhe radhitjen e njësive të rendit publik.[9]

[9] La constitution belge, article de Wikipedia, http://fr.wikipedia.org/wiki/Belgique.laconstitutionbelge.

5. KOMUNITETET NË BELGJIKË BASHKËQEVERISIN APO.....

Pyetja dilemë që shpesh parashtrohet nga shumë qytetarë është se vallë komunitetet në Belgjikë bashkëqeverisin apo bëhet fjalë për ndonjë farsë. Si është e mundur që një komunitet pakicë të ketë kompetenca të njëjta si komuniteti shumicë. Le të analizojmë me radhë.

Federalizmi belg siç edhe cekëm diku më lart mundëson prezencën e rajoneve në tre komunitetet e ndryshme, sepse thamë se ky shtet kishte tre komunitete të ndryshme. Deputetët e Parlamentit valon dhe brukselas zgjedhën direkt. Partia në përbërje me deputetë frankofonë brukselasë ***(bruxellois)*** formon së bashku me numrin total të deputetëve valon, Parlamentin e Valoni-Brukselit. Habia më e madhe është se rajoni i Brukselit edhe pse me shumicë frankofone ka në krye një qeveri ku numri i ministrave flaman është strikt identik me numrin e ministrave frankofonë, përderisa flamanët përfaqësojnë 10 % të popullatës së përgjithshme brukselase. Me këtë rast një analist francez me emrin ***Philippe Van Parijs*** gjatë një diskursi të tij më 5 korrik 2005 në Bruksel, në seancën e tretë të Parlamentit frankofon të të rinjve në Bruksel citon se ka një asimetri në nivel të përfaqësimit demografik dhe institucional në Bruksel. Sipas tij meqenëse banorët frankofon të Brukselit nuk dalin në votime, sepse janë të zhgënjyer nga një lloj politike e tillë, përfaqësimi flaman atëherë sillet me rreth 14 % të votave, por këto 14 % të votave zgjedhin 19 % të përfaqësuesve të Këshillit rajonal (17

përfaqësues përkundër 72 përfaqësuesve frankofon). Pra, me gjithë dallimin në nivel të përfaqësuesve të Këshillit rajonal, edhe pse përfaqësuesit frankofon janë më të shumtë në numër në Bruksel, fushëveprimi i tyre nuk është aq i theksuar përkundër përfaqësuesve flaman që janë më minor në këtë Këshill rajonal.

Ndërsa në Qeverinë federale, numri i ministrave frankofon është ekuivok me numrin e ministrave flaman, pa e llogaritur këtu numrin e kryeministrit, edhe pse frankofonët janë me një pozicion minoritar 40 me 45 % në nivel federal nëse ia bashkëngjisim këtu numrin e frankofonëve të pjesës së Flandrisë. Por, sipas mendimit tim, këto dy pozicione nuk janë të krahasueshme. Pse? Sepse njëri krahasim, pra ai i flamanëve të Brukselit konstituon një komunitet në një qytet, përderisa ai Valon dhe ai i Brukselit frankofon konstituon popullatën pothuajse të tërë një entiteti të federuar (pra rajonin Valon), i cili përfshinë pjesën më të madhe të territorit belg. Abstraksioni i bërë ndaj minoritetit gjermanofon, raportet e forcës përcaktuese të politikës belge, e posaçërisht ato flamane-frankofone, çuan drejt një bipolarizimi i cili implikoi vendosjen e një serie të mekanizmave të cilët do të siguronin tretmanin e barabartë të secilit komunitet në nivel federal. Kjo domethënë që u pajtuan të tre komunitetet për:

1. rregullimin i miratimit të disa ligjeve të ashtuquajtura të veçanta në aspekt institucional me shumicën e secilit grup linguistik *(artikulli 4 i Kushtetutës)*
2. paritet linguistik në kuadër të këshillit të ministrave federal

3. paritet në funksionin e lartë publik federal dhe në juridiksionin më të lartë.

Pra, ky pajtim e zbuti fërkimin e të dy komuniteteve shumicë, të cilët ishin tejet revindikues në kërkesat e tyre. Valonia që ka praktikisht 100 % frankofonë dhe Brukseli me principin bilingual, por me një përdorim të madh të gjuhës frënge, janë njëri prej tjetrit autonom. Pra kemi paritet në funksionimin e këtij shteti federal, por nuk kemi paritet në popullsi, sepse komuniteti shumicë në territorin e Belgjikës ***janë flamanët me afro 6 milionë banorë.*** Përderisa komuniteti ***francez është me një pjesëmarrje prej 4 milionë frankofonëve,*** ndërsa ***komuniteti gjermanofon përbëhet nga 71 000 gjermanofonë.*** Ndërsa, megjithë dallimin në popullsi, bashkëqeverisja është evidente dhe të tre komunitetet janë me të drejta të barabarta. Kjo është një habi e madhe, sepse një gjë të tillë se gjen dot në shtetin e Maqedonisë.

Rajonet, ai valon, flaman dhe ai i Brukselit- kryeqytet janë entitete federale dhe kryesisht kompetente në fushën ekonomike.

Komunitetet ai francez, flaman dhe gjermanofon janë entitete federale që janë kompetente në fushën e kulturës dhe arsimit. Këto tre komunitete janë të varura (subsiduara) nga shteti federal.

Provincat përfaqësojnë një nivel politik ndërmjetësues mes rajoneve dhe komunave. Belgjika në përjashtim të rajonit brukselas (la région bruxelloise), i cili konstituon një territor provincial, është e ndarë në 10 provinca të cilat mvaren direkt nga rajonet.

Provincat flamane janë këto :

Anvers (Anvers) – ***Antwerpen*** **(*Antwerpen*)**
Brabant-Flamand (Louvain) – ***Vlaams-Brabant*** **(*Leuven*)**
Flandre-Occidentale (Bruges) –West-Vlaanderen (Brugge)
Flandre-Orientale (Gand) – Oost-Vlaanderen (Gent)
Limbourg (Hasselt) – ***Limburg*** **(*Hasselt*)**



(Rajonet dhe provincat në Belgjikë)

Provincat valone janë këto :
Brabant-Wallon (Wavre) – *Waals-Brabant* (*Waver*)
Hainaut (Mons) **–** ***Henegoueen*** **(*Bergen*)**
Liège (Liège) **–** ***Luik*** **(*Luik*)**
Luxembourg (Arlon) **–** ***Luxemburg*** **(*Aarlen*)**
Namur (Namur) **–** ***Namen*** **(*Namen*)**

6. RELIGJIONI

Liria e religjionit apo e fesë është e potencuar edhe në Kushtetutën belge. Religjioni më i përhapur në këtë shtet është religjioni katolik, por edhe ai islam, protestant, ortodoks, judaist etj. Belgjika subvencionon kishat, objektet tjera fetare dhe organizatat tjera filozofike jokonfesionale prezentë në territorin e saj. Kjo gjë është e theksuar posaçërisht në artikullin 181 të Kushtetutës belge. Kjo theksohet kësisoj :

« Les traitements et les pensions des ministres des cultes sont à charge de l'État ; les sommes nécessaires pour y faire face sont annuellement portées au budget. (…) »

*« **Tretmanet dhe pensionet e kulteve fetare janë nën mbikëqyrjen dhe detyrën e shtetit ; shumat e nevojshme dhe të domosdoshme të parapara për to janë të vendosura në buxhetin vjetor** ».*

Në këtë drejtim shteti belg për vitin 2007 ka harxhuar :

Kulti katolik : 458,62 milionë euro
laik : 75,36 milionë euro
kulti islamik : 20,33 milionë euro
kulti protestant evangjelik : 18,80 milionë euro
kulti izraelit : 3,21 milionë euro
kulti ortodoks : 2,36 milionë euro
kulti anglikan : 0,46 milionë euro

Një kult tjetër është edhe ai budist i përfaqësuar nga 30 000 deri në 50 000 besimtarë.

Ndërsa, sa i përket armatës, shteti belg përbëhet nga 26 400 ushtarë tokësorë, 8 600 në aviacion, 2 400 në marinë dhe 2 000 në shërbimin mjekësor. Pra, gjithsejtë 39 400 veta. Rekrutimi është vullnetar prej suspendimit të Ligjit mbi shërbimin ushtarak më 1 mars 1995.

7. SISTEMI POLITIK I BELGJIKËS DHE INSTITUCIONET E SAJA

QEVERIA - Mbreti emëron kryeministrin sipas rezultateve të zgjedhjeve parlamentare. Qeveria belge në fakt është tradicionalisht një lloj qeverie e koalicionit e përbërë nga më së paku 2 parti me të njëjtat tendenca në Flandri dhe në Valoni.

ASAMBLEJA PARLAMENTARE FEDERALE (Sistemi bikameral)- Asambleja Parlamentare Belge apo legjislativi belg kompozohet apo është i përbërë nga dy nivele :

1. Dhoma e përfaqësuesve e cila përfshin 150 deputetë të zgjedhur direkt
2. Senati që përbëhet nga 72 anëtarë, prej të cilëve 40 të zgjedhur direkt, të ndarë në tre kategori edhe atë: senatorë të ashtuquajtur cooptes, senatorë të drejtësisë dhe senatorë komunitarë).

Senatorët dhe deputetët kanë mandate katërvjeçar.

ASAMBLEJA PARLAMENTARE E RAJONEVE DHE KOMUNITETEVE

Në Asambletë rajonale dhe komunitare vlen sistemi monokameral. Secila Asamble e secilit komunitet përbëhet si vijon:

1. Këshili flaman (Conseil flamand)-I cili përfaqëson Asamblenë e rajonit apo komunitetit flaman. 118 anëtarë prej 124 anëtarëve gjithsejtë sa janë, zgjidhen drejtpërdrejtë, ndërsa gjashtë të tjerët emërohen përmes listave prezentë në listat elektorale flamane të Këshillit të Brukselit-Kryeqytet.
2. Këshilli valon – Është flurim apo miks legjislativ i Rajonit Valon dhe numëron gjithsejtë 75 anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejtë.
3. Këshilli i Komunitetit Francez-përbëhet nga 75 anëtarët e Këshillit Valon dhe nga 19 këshilltarët tjerë që i përkasin grupit linguistik francez të Këshillit të Brukselit-Kryeqytet.
4. Këshilli Komunitetit Gjermanofon përbëhet nga 25 anëtarë, të gjithë të zgjedhur drejtpërdrejtë.
5. Këshilli i Rajonit të Brukselit-Kryeqytet- përbëhet nga 75 anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejtë.

Ajo që është me rëndësi të ceket për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve është ajo që të gjitha zgjedhjet për Këshillat mbahen në të njëjtën kohë me mbajtjen e zgjedhjeve evropiane. Ndërkaq këshilltarët kanë mandat pesëvjeçar.

MËNYRA E VOTIMIT NËPËR ZONAT ELEKTORALE

Përfaqësuesit zgjidhen drejtpërdrejt nga votat e përgjithshme në një raund në formën proporcionale. Një pjesë e zgjedhjes së senatorëve bën përjashtim nga kjo rregull, sikurse edhe anëtarët e Këshillit të Komunitetit francez, të cilët nuk janë të zgjedhur drejtpërdrejtë.

(Ndërtesa e Parlamentit belg)

8. STATUSI I BRUKSELIT-KRYEQYTET

Statusi i Brukselit, kryeqytetit të Belgjikës, si dhe të Rajonit të Brukselit-Kryeqytet është njëra prej sfidave më të theksuara të federalizmit belg, i cili shpesh venitet si pasojë e divergjencave të theksuara të dy komuniteteve shumicë, atij flaman dhe atij francez. Ky rajon siç

edhe cekëm më parë është i pastër frankofon, por njëkohësisht është edhe zyrtarisht bilingual. Është në një vorbull të dilemave të shumta politike dhe institucionale, është një sfidë edhe për vet ekzistimin e shtetit belg e më saktësisht në lidhje me atë që ka të bëjë me ardhmërinë e shtetit (sigurish në rast të pavarësimit të Flandrisë, fr. La Flandre), e cila rrethon territorialisht Brukselin. Pra, ekzistojnë kolizione në mes flamanëve holandezë dhe frankofonëve. E poashtu ekzistojnë divergjenca edhe mes vetë përfaqësuesve përbrenda këtyre dy komuniteteve, në mes të unitaristëve dhe rajonalistëve.

Brukseli, qyteti i shumë etniteteve, qytet i selisë së Unionit Evropian, përmban në vete shumë institucione internacionale. Qytet bilingual llogaritet si kryeqytet i Komunitetit Francez, është qytet kompetent për gjithçka që ka lidhje me frankofoninë. Ky qytet është poashtu edhe qytet i Komunitetit Flaman dhe është njëkohësisht kompetent për distribuimin e materialeve të gjuhës flamane në rajonin e Brukselit. Pra, është qytet i të dy komuniteteve. Aty ku gjërat janë më të komplikuara janë institucionet e komunitetit flaman, ku bëjnë pjesë flamanët e Brukselit dhe ato të rajonin flaman, ku nuk bën pjesë Brukseli, me ç`rast gjërat janë fuzionuar qysh prej krijimit të tyre, sepse shpesh Brukseli edhe pse nuk ka shumicë flamane, por frankofone tentohet të bëhet si referencë e kryeqytetit të Flandrisë, nga vetë flamanët. Shumë frankofonë nuk duan që Brukseli të llogaritet si kryeqytet i Flandrisë. Ata theksojnë se Brukseli mund të jetë kryeqytet i përbashkët edhe i frankofonëve edhe i komunitetit flaman, por jo edhe i Flandrisë.

Kjo shkrirje në mes komunitetit dhe rajonit flaman ka sjellë de facto që Brukseli të bëhet kryeqytet i rajonit flaman, një entitet politik ky ku Brukseli nuk bën pjesë dhe i cili rajon nuk ka asnjë kompetencë në territorin e Brukselit-Kryeqytet. Kjo situatë paraqet një burim tensionimi politik mes përgjegjësve frankofonë dhe flamanë. Për frankofonët Brukseli paraqet një qytet me shumicë frankofone, por me një vokacion ndërkombëtar dhe me shumë minoritete. Ata duan të koekzistojnë korrektësisht me flamanët. Për këtë arsye të dy komunitetet kanë të drejta të barabarta. Ky pikëvështrim është tejet koherent me kushtetutën (e cila i njeh të dy komunitetet me kompetenca identike), si dhe me realitetin në terren.

Në nivel institucional kjo theksohet edhe përmes institucioneve të secilit komunitet, si për shembull Komisioni komunitar flaman ***(VGC)*** dhe Komisioni komunitar francez ***(COCOF),*** i njohur ndryshe edhe me emrin Parlamenti Frankofon i Brukselit, i cili ka një autonomi të madhe të administrimit. Frankofonët vënë në pah aksentin mbi një autonomi absolute të institucioneve të rajonit, siç janë Parlamenti dhe Qeveria e Brukselit. Për atë arsye ata shprehin dyshim shpesh mbi ingerencat e Flamanëve të jashtëm të rajonit. Në këtë debat, sinjifikacioni i termit "flaman" krijon një konfuzion me ambiguitet edhe atë: një flaman si qytetar i komunitetit flaman (i cili mund të jetë edhe flaman i Brukselit) ose një flaman si rezident në një territor të jashtëm, rajoni flaman. Poashtu një valon i cili shpërngulet apo del nga Brukseli prap quhet si valon. Pjesa më e madhe e frankofonëve të zgjedhur në votimet e

Brukselit theksojnë se Brukseli duhet të mbetet një rajon me karakteristikat e tij specifike, një entitet federal me realitetin e tij institucional aktual, me të njëjtin status dhe kompetenca me dy rajone tjera, Flandrinë dhe Valoninë. Por, të zgjedhurit flamanë mendojnë ndryshe. Për këtë arsye mund të themi se ky kryeqytet është një çik problematik për këta dy komunitete.

Më 20 dhjetor 2006 ngritët një iniciativë nga ana e frankofonëve me thënien "Nous existons", shqip, Ne ekzistojmë. Me këtë thirrje shumë personalitete frankofone kërkuan fort dhe theksuan se rajoni i Brukselit-Kryeqytet me gjithë kompleksitetin e tij është shumëkulturor dhe duhet të mbetet ashtu. Me këtë thirrje ata iu drejtuan mandatarëve të Brukselit për të mbrojtur tërësinë e këtij rajoni megjithë dallimet mes tij. Teksti thekson dhe kërkon më shumë rajon (territor), e më pak komunitet, thënë troç. Kësaj thirrje shumë personalitete valone iu përgjigjën në mënyrë afirmative më 7 maj. Për dallim prej frankofonëve, flamanët vënë në pah domosdoshmërinë për një kooperim më të mirë në mes të institucioneve të metropolit dhe në mes të dy komuniteteve të mëdha. Ata theksojnë rëndësinë e një neutraliteti në mes të flamanëve dhe frankofonëve, saqë shkojnë deri aty ku thonë se roli i kryeqytetit duhet të implikojë në një kooperim mes institucioneve federale, dhe shprehin qartë mundësinë e mbrojtjes së flamanëve të Brukselit nga Qeveria flamane. Për këtë arsye, duke u bazuar në solidaritetin me minoritetin flaman në Bruksel, dhe në kuadër të një autonomie të garantuar nga Kushtetuta belge, Parlamenti flaman ka zgjedhur të investojë në këtë qytet, sikur të ishte Brukseli kryeqytet

i Flandrisë. Ky vendim në Parlamentin Flaman ishte sjellë unanimisht. Sipas flamanëve Brukseli duhet trajtuar sikurse edhe shteti federal belg. Me këtë ata do ta shprehnin më qartë se frankofonët duhet të trajtohen si pakicë në Bruksel, edhe pse janë shumicë aty, por sipas tyre ata janë pakicë në Belgjikë, pra në shtetin federal.

Sikurse të pavarësohet Flandria, atëherë do të hapeshin shumë dilema në lidhje me këtë qytet. Independentalistët, apo ata që kërkojnë pavarësinë e Flandrisë nuk janë shumicë, por nuk duhet të injorohen. Nëse do të vinte deri tek një shkëputje apo pavarësim i Flandrisë, atëherë me siguri se disa frankofonë do të kërkonin një shtet të pavarur, i cili do të përfshinte rajonin Valon dhe rajonin e Brukselit-Kryeqytet me një sistem politik të monarkisë kushtetuese, disa të tjerë do të kërkonin bashkëngjitjen me Francën, etj.

Ndërsa në mesin e flamanëve ka më shumë divergjenca dhe dilema. Disa theksojnë rëndësinë e pavarësimit në një shtet të pavarur, disa thonë se Brukseli nuk duhet të jetë kryeqytet i shtetit të pavarur flaman dhe që rajoni i Brukselit-Kryeqytet të mos i bashkohet Flandrisë, disa flamanë kërkojnë krijimin e një distrikti (rrethi apo rajoni) evropian në vend të rajonit aktual të Brukselit-Kryeqytet. Pra, mbetet të shihet në të ardhmen se si do duket ky konfiguracion.

Në vitet e fundit po qarkullon edhe mendimi apo hipoteza për një Belgjikë me dy rajone dhe atë me rajonin e Brukselit dhe me rajonin e Valonisë. Ky vokacion shprehet nga ana e frankofonëve të Brukselit në rast të pavarësimit të Flandrisë. Kjo kërkesë artikulohet rreth disa elementeve edhe atë:

1. Një përafrim me rajonin Valon
2. Krijimin e identitetit brukseloaz (sepse historikisht Brukseloazët nuk janë Valonë, ata kanë dallime, sepse kanë origjina të ndryshme)
3. Krijimin e një unioni federal me Valoninë me emrin aktual Belgjikë
4. Një kompromis institucional me Flamanët minoritet në Bruksel (kjo do të thoshte 100 000 flamanëve të Brukselit tu jepeshin të drejta në shtetin eventual 4.3 milionësh frankofonë).
5. Pranimin e Brukselit si qytet historikisht me kulturë flamane, por me karakter dhe konfiguracion esencialisht frankofon, por jo edhe ekskluzivisht.
6. Dy shtete pjesë permanente të UE-së, pra një Flandri me 5.9 milionë banorë, dhe një Belgjikë e "re" me 4.3 milionë banorë me përbërje prej dy Rajoneve autonome dhe federale (Valonia dhe Brukseli-Kryeqytet).

Pra, të dy shtetet sipas këtij konfiguracioni do të ishin me dimensione krahasuese sikurse shtetet tjera evropiane si p.sh. Irlanda me 4.2 milionë banorë, Danimarka me 5.4 milionë banorë, Norvegjia me 4.6 milionë banorë etj. Ndërsa varianti i distriktit apo rrethit evropian, sipas ish- ministrit- presidentit të Flandrisë do të ngjasonte me imazhin e Washingtonit, D.C. në SHBA.[10]

Por, megjithë tenativat për një bashkim me ndonjë shtet fqinj, asnjë shtet nuk ka shfaqur pretendime territoriale, as Luksemburgu, as Franca e as Holanda, por as edhe Gjermania. Të gjitha këto shtete janë shpre-

[10] TV5, Intervistë me M. Yves Leterme, 20 nëntor 2003.

hur qartë për ekzistimin ashtu si është të Belgjikës me tre rajonet ekzistuese.

9. KOMUNITETI FRANCEZ I BELGJIKËS

Komuniteti francez i Belgjikës i njohur si i tillë në termin kushtetues, ndërsa me emrin zyrtar si Komuniteti Valoni-Bruksel, është komunitet tejet i rëndësishëm, pjesë e shtetit federal belg. Megjithë termin kushtetues, me propozimin e ish-presidentit francez, François Mitterrand, emri Komunitet francez i Belgjikës u propozua që të ndryshohet në këtë të dytin, pra Komuniteti Valoni-Bruksel, me qëllim që të evitohet keqkuptimi dhe konfuzioni me francezët e Francës që jetojnë apo punojnë në Belgjikë. Është komunitet me institucionet e tij, sikurse e potencuam edhe më lartë, me 94 parlamentarë, prej të cilëve 19 parlamentarë prej Brukselit-Kryeqytet dhe 75 Valonë. Ka Qeverinë, Parlamentin e tij dhe Hymnin. Ky komunitet flet edhe të ashtuquajturën frëngjishte të Belgjikës, një frëngjishte kjo e ndryshme prej frëngjishtes standarde të Francës. Përmban 41 % të popullsisë totale belge, në krahasim me 58 % e komunitetit flaman dhe me 1 % e komunitetit gjermanofon. Ky komunitet nuk përbën një territor, por një komunitet njerëzish që jetojnë në Valoni dhe në Bruksel.

Në sistemin federal belg duhet bërë dallim mes tre komuniteteve linguistike dhe tre rajoneve federale.

Komuniteti francez ka sikurse edhe e potencuam, institucionet e veta. Ushtron kompetenca në fushën e arsimit, kulturës, kërkimeve, shëndetësisë, rinisë dhe sporteve. Me Marrëveshjen e Shën Kuentinit të vitit 1993 një pjesë e kompetencave të Komunitetit francez të

Belgjikës iu transferuan Rajonin Valon dhe Komisionit komunitar francez **(COCOF).**
Bëhet fjalë për:

1. **fushën e kulturës**
2. **politika e shëndetësisë**
3. **ndihma njerëzve**

Brukseli është kryeqendra e Parlamentit dhe Qeverisë së Komunitetit francez. Parlamenti i këtij komuniteti në përbërjen e vet ka këto parti:

1. ***Partia Socialiste 41 vende***
2. ***Lëvizja Reformuese 26 vende***
3. ***Qendra Demokrate Humaniste 17 vende***
4. ***Ekolo 5 vende***
5. ***Fronti Nacional 4 vende***
6. ***Të pavarur: nuk ka, pra 0 vende.***

Qeveria nuk zgjidhet nga Parlamenti, por nga koalicioni i formuar i fituesve zgjedhor rajonalë. Njëri prej këtyre anëtarëve së paku, i takon Rajonit të Brukselit-Kryeqytet.

Ky komunitet ka edhe flamurin e tij, i cili përbëhet nga një gjel hardi i kuq dhe flamur të verdhë. Ky flamur u shpalos më 17 shtator 1991 nga Pierre Paulus. Prej 1998 flamuri valon është zyrtarisht edhe flamur i rajonit Valon. Ndërkaq, logoja përbëhet nga gjeli i Paulusit apo në fr: le coq de Paulus. ***Gjeli poashtu është edhe simbol i Francës.***

Komuniteti francez i Belgjikës në kompozicionin e vet ka edhe shumë gjuhë endogjene. Këto gjuhë janë

gjuhë romane si ***(champenois, lorrain, picard, wallon)*** ose gjuhë gjermanike si ***(francique, limbourgeois, luxembourgeois, brabançon, bruxellois).*** Por, gjuha frënge mbetet gjuhë oficiale, edhe atë në të dy rajonet, edhe atë Valon edhe atë Brukselas.

Me status të njëjtë është edhe Komuniteti flaman, i cili i ka institucionet e njëjta, me gjuhën zyrtare flamane, me logon e tij dhe me një kompozicion të njëjtë të gjërave.

Foto nga Parlamenti i Komunitetit francez të Belgjikës. Në këtë parlament u mbajt sesioni III i Parlamentit frankofon të të rinjve nga e gjithë bota prej datës 3 korrik e gjer më 10 korrik 2005. *Pjesëmarrës nga Maqedonia ishin: Ardian Ramadani, (student i vitit të tretë në UEJL) dhe Natalia Gjeorgjeviq (studente e vitit të tretë në Universitetin e Shkupit). Në të djathtë kryetari i Parlamentit të Komunitetit francez z. Jean Fransoi Istasse, në të majtë një ish-ministër i*

Qeverisë së Komunitetit francez, tani deputet aktual, z. Andre Bouchat.

10. PARLAMENTI DHE SENATI BELG

Hemicikli i Dhomës ***(la Chambre)*** përbëhet nga 150 deputetë, prej të cilëve 88 të zgjedhur nga grupi gjuhësor flaman ***(kryesisht në Flandri)*** dhe 62 nga grupi linguistik frankofon (48 në Valoni dhe 14 në Bruksel).

Senati përbëhet nga 74 senatorë. 40 senatorë janë zgjedhur direkt më 10 qershor 2007, pra ditën e zgjedhjeve, ndërsa 25 nga ana e Kolegjit flaman, si dhe15 senatorë nga ana e Kolegjit frankofon. 21 senatorë janë zgjedhur nga Parlamenti i Komunitetit flaman edhe atë 10 flamanë, 10 francezë dhe 1 gjermanofon. Poashtu kemi edhe 10 senatorë të ashtuquajtur cooptes, prej të cilëve 6 emërohen nga 35 senatorët flamanë dhe 4 emërohen nga 25 senatorët frankofonë. Ndërsa, të tre fëmijët e mbretit Albert II të Belgjikës, konsiderohen si senatorë të drejtësisë (senateurs de droit).

Qëllimi final është transformimi i kësaj Dhome belge në Dhomë të shteteve federale, model ky prezent në Gjermani si p.sh. Bundesrati i Gjermanisë. Një muaj para zgjedhjeve të reja kryeministri çlirohet nga angazhimet e tij misionare dhe nuk qeverisë më me asgjë, në përjashtim të gjërave të përditshme brendashtetërore, ose gjithçka që ka të bëje me administratën dhe gjërat tejet urgjente. Më pas partitë dërgojnë shenjat dhe logot e tyre tek ministri i Punëve të Brendshme. Pastaj, Këshilli i ministrave pas konsultimeve me Gjykatën Kushtetuese, me Këshillin shtetëror, me ministrat-kryetarë të komuniteteve dhe rajoneve, vendosin se cilët artikuj janë të paraparë dhe duhet të merren në

konsideratë. Ditën e zgjedhjeve Qeveria shpërndahet, para mbretit. Ai i vëzhgon gjërat e nevojshme, deri sa të zgjidhet një qeveri e re dhe të emërohet nga mbreti. Ditën e nesërme mbahen zgjedhjet në të gjitha zonat elektorale të Mbretërisë.

Ndërtesa e Parlamentit federal belg (Pallati i Kombit) në Bruksel.

11. PARTITË POLITIKE NË BELGJIKË

Partitë më të njohura në Belgjikë janë këta si vijojnë:

1. Belgische Unie - Union Belge (BUB), është parti centriste për bashkim nacional apo kombëtar të Belgjikës, parti unitare prezent edhe tek frankofonët edhe tek flamanët

2. Centre démocrate humaniste (cdH), Parti Demokratike Humaniste Frankofone

3. Chrétiens démocrates fédéraux (CDF), Parti Demokratike-Kristiane, Unitare

4. Christen-Democratisch en Vlaams (CD&V), Parti Demokratike Kristiane, Flamane, në lidhje me la Nieuw-Vlaamse alliantie, Parti Separatiste Flamane

5. Comité pour une Autre Politique (CAP), Parti Unitare e së Majtës

6. Ecolo, Partia e Gjelbër Unitare

7. Forza Flandria, flamane

8. Front national (FN), Parti Nacionaliste, Frankofone

9. Groen!, Parti e Gjelbër, Flamane

10. Ligue arabe européenne, Organizatë Panarabe e vendosur në Belgjikë dhe në Holandë

11. Liste Dedecker, parti e ish-senatorit, Jean-Marie Dedecker, flaman

12. Mouvement réformateur (MR), Parti Liberale Frankofone, në aleancë me Front démocratique des francophones dhe le Mouvement des citoyens pour le changement

13. Nee, Parti Flamane

14. Parti communiste de Belgique (PCB), Parti e së Majtës Ekstreme, Frankofone

15. Parti du travail de Belgique (PTB+/PvdA+), Parti Unitare e së Djathtës Ekstreme,

16. Parti socialiste (PS), Parti Social-Demokrate, Frankofone

17. Rassemblement Wallonie France, Parti Separatiste, ithtare e bashkimit me Francën, frankofone

18. Socialistische Partij-Anders (sp.a), Parti Social-Demokrate, Flamane, në lidhje të ngushtë me Spirit, Parti Konfederaliste, flamane

19. UNIE, Parti Unioniste, frankofone dhe flamane

20. Vlaams Belang, Parti Nacionaliste, flamane

21. Vlaamse Liberalen en Democraten (VLD), Parti Liberale, flamane, në lidhje me Vivant, Parti

Unitare, dhe *Liberaal Appèl*, Parti Liberale e së Djathtës, flamane

22. VLOTT, parti e ish senatorit VLD, HugoeCoveliers, liberal, flamane

23. Wallon, Parti Separatiste, protagoniste e pavarësisë së Valonisë dhe bashkimit të saj me Francën, frankofone.

Këto janë partitë më të theksuara në Belgjikë, në mes të cilave zhvillohet gara për Dhomën e Përfaqësuesve dhe për në Senat.

Në Senatin belg bëjnë pjesë këto parti kryesore:

Front national
Centre démocrate humaniste
Christen-Democratisch en Vlaams
Vlaams Belang
Mouvement réformateur
Vlaamse Liberalen en Democraten (Open VLD)
Parti socialiste
Groen!
Socialistische Partij-Anders-Spirit
Ecolo
Liste Dedecker
Parti communiste de Belgique (PCB)
Comité pour une Autre Politique
Rassemblement Wallonie France
Parti du travail de Belgique (PTB+/PvdA+)[11]

---

11 www.wikipedia.com.lespartispolitiquesenBelgique.20%html

KONKLUZION

Në këtë punim jam munduar që të analizoj sistemin politik të Belgjikës, me të gjitha predispozitat, mangësitë dhe përparësitë si dhe me shkallën e zhvillimit të organizimit politik të shtetit të Belgjikës, duke filluar nëpërmes katër reformave kryesore të kushtetutës, të organizimit të sotshëm mbi rregullimin e kompetencave (federale) në raport me rregullimin e kompetencave të njësive federale siç janë: (bashkësitë, rajonet, krahinat dhe komunat). Ekzistimi i këtij shteti është i mundshëm edhe siç mund të shihet vetëm duke iu falënderuar lojalitetit ndaj federalizmit dhe solidaritetit ndërnacional të qytetarëve të Belgjikës, pavarësisht nga dallimet e tyre historike e gjuhësore.

Sikurse edhe mund të shihet, konkludojmë se federalizmi i shtetit të Belgjikës ka tre karakteristika kryesore: centrifugalitetin, bipoliritetin dhe territorialitetin. Këto hollësi qëndrojnë në atë që e quajmë ne "ius soli ius personae", në të cilën tre karakteristikat në mënyrë subtile janë të gërshetuara dhe ekuilibruara. E arritura më e madhe e këtij shtetit është që në mënyrë paqësore ka arritur zgjidhje apo model të këtij lloj koncenzusi kushtetues. Mes shumë debateve, zënkave etj, që në të kaluarën i ka përjetuar shteti i Belgjikës e ndoshta edhe ende i përjeton, ato mund të tejkalohen nëse ekziston vullnet i mirë, duke respektuar dallimet. Artikulimi i proceseve demokratike dhe federalizmi koncensual i shtetit të Belgjikës, me siguri do të vazhdojë edhe më tej, nëse jo për diçka, me siguri për hir të primatit të saj dhe të qenit të saj kryeqendër e Unionit Evropian dhe institucioneve tjera ndërkombëtare, si

p.sh. NATO etj, por jo vetëm për atë. Shoqëria e Belgjikës arriti që të shtyp interesin partikular në interes të bashkëjetesës nacionale dhe solidaritetit nacional, dhe megjithë divergjencat dhe kolizionin e komuniteteve shumicë, Belgjika arriti që të jetë model edhe për shtetet tjera, si dhe si udhërrëfyes se si duhet bashkëjetuar. Në një rast ish presidenti francez Zhak Shirak pat thënë se nëse shkatërrohet Belgjika apo prishet sistemi i saj federal, atëherë cila do të ishte shpresa për Unionin Evropian? Me siguri edhe UE do të kishte fatin e njëjtë, pra do të përjetonte fiaskon. Dhe e kishte me të drejtë, z. Shirak. Por, edhe për vet faktin që ekziston si territor i vetëm ekonomiko–monetar, lojaliteti ndaj federalizmit paraqitet si faktor i të arriturave ndër nacionale (a pse mos themi edhe shtetformuese).

Ndoshta ky është shembulli më i mirë që Maqedonia duhet ta ndjek, si rrugë të vetme për arritjen e barabarësisë së plot midis popullit shqiptar dhe maqedonas. E ndoshta shërben edhe për shtete tjera në mbarë globin.

REXHAILI DHE GJITHË TË BURGOSURIT TJERË JANË ABSOLUTISHT TË PAFAJSHËM

(Përkitazi me burgosjen e bashkëfshatarit tim të pafajshëm, Rexhail Qerimit, ish-luftëtar i UÇK-së dhe kontribuues i çështjes kombëtare shqiptare)

I tërë opinioni shqiptar, e posaçërisht ai në rrethinën e Shkupit dhe të Kumanovës u shtang dhe u shokua me shqiptimin e dënimit ndaj bijve më të mirë të tyre, nga Gjykata maqedonase, edhe atë me burgim të përjetshëm. Çfarë flet kjo?Kjo flet se ky shtet edhe ashtu i brishtë dhe duke u mbajtur me infuzione ndërkombëtare, është duke dëshmuar se i takon epokës së gladiatorëve dhe përbëhet nga mentaliteti i pareformuar shtazarak. Të dënosh njerëzit e pafajshëm me burgim të përjetshëm, kjo është krim i gjykatave dhe i gjithë atyre

përgatitësve të këtij skenari. Vallë a vetëm shqiptarët duhet të dënohen me burgim të përjetshëm, vetëm ata duhet t`i mbushen burgjet, vetëm duke u mbyllur shqiptarët luftohet krimi....

Këtyre gjërave të liga dhe antidemokratike është duke i ndihmuar me ose pa dashje faktori politik shqiptar, pjesëmarrës në qeverinë Gruevski, i cili gjatë kësaj periudhe heshti dhe po hesht në absurditet, duke mos mundur dhe ditur si ti mbrojë qytetarët e vet shqiptarë, ish- pjesëtarët e luftës së vitit 2001 e mbi të gjitha njerëzit e pafajshëm. Rasti i Rexhail Qerimit, si bashkëfshatarë i imi më tronditi personalisht edhe mua, ngase sipas gjithë dëshmitarëve gjatë kohës së vrasjes së policit,ky njeri ka qenë në fshatin e tij me shokë, si dhe nuk ka pasur kurrfarë lidhje me aktin e vrasjes së policit.

Por jo, kjo nuk merret parasysh nga qeveria dhe gjykatat e korruptuara që janë shndërruar sikurse gjykatat serbe të Rankoviçit dhe Millosheviçit, sepse përbrenda saj nuk ka gjykatës, po viça dhe monstrumë, që janë të mpirë nga ideja që burgjet maqedonase t`i mbushin me shqiptarë të pafajshëm. Rexhail Qerimi me shokë, si dhe shumë të burgosur të tjerë të pafajshëm, ata të Sopotit, të Brodecit,... e kështu me radhë janë të pafajshëm. Ata nuk janë kriminelë, po njerëz punëtorë, atdhetarë që në momentet kur u thirr kushtrimi i lirisë i`u përgjigjën pa asnjë dyshim. Andaj nga burgjet famëkeqe dëgjojmë kushtrimin e tyre për t`i ndihmuar dhe për t`i liruar nga burgu. Por, ky kushtrim nuk shkon tek shurdhmemecët, tek injorantët dhe të mjerët, që nuk i`u dëgjua zëri në asnjë moment, nga shkaku se i mbyllen luftëtarët në çdo ditë, ngase ish- luftëtarët nuk mundën

të shohin një ditë të bardhë, ngase zonat shqiptare janë të rrezikuar çdo ditë nga aksionet e mundshme policore "për kapje të kriminelëve" nga kriminelët. Qeveritarët shqiptarë, deputetët e zonave në vend se të braktisin institucionet e këtij shteti të mbrapshtë, ata shkojnë marrin rrogat e tyre, bredhin nëpër kafene dhe restorante, e në anën tjetër duke u shitur patriotë folklorik dënojnë veprimet e qeverisë dhe gjykatave, edhe pse janë vet pjesë e qeverisë dhe të gjykatave.

Në anën tjetër Rexhaili i gjorë dhe shumë Rexhaila të tjerë kalben burgjeve duke mos e ditur për asnjë moment se përse u arrestuan, përse u shpallën fajtorë. Po dihet, ata janë shqiptarë, alibi tjetër edhe ish-luftëtarë, e ata ku e kanë vendin? Në burg, pra. Ja kjo është logjika e mendësisë shtazarake të Gjykatave demokratike, që ndërkombëtarët në çdo kohë i kritikojnë si të korruptuara dhe joefiçiente, qeveritarët i lavdërojnë, qeveritarët shqiptarë i servojnë, ndërsa qytetarët shqiptarë i mallkojnë.

Andaj i nderuar deputet, ministër, zëvendëskryeministër, politikan, dreq e engjëll, hapni sytë dhe të ndihmojmë Rexhailin (ish i burgosur edhe për shkollat shqipe në vitin 1988), si dhe gjithë shqiptarët tjerë të pafajshëm që po na kalben burgjeve, që të dalin nga burgjet, **sepse " Kush hesht tani kur duhet të flitet është djall i nemitur".**

Zaten duke heshtur dhe duke simuluar se çdo gjë funksionon si duhet janë duke na ndodhur fatkeqësitë një nga një, në mënyrë serike, mirë të planifikuara dhe realizuara.

Ti o qeveritarë shqiptar, që je veshur me vellon e nuses së braktisur nga burri, zgjohu dhe ngrit zërin e

arsyes dhe ndërgjegjes, e mos lejo që bijtë tu më të mirë, atëherë kur më së shumti i duhen familjeve dhe popullit, të qëndrojnë në burgje pa pikë faji.

Ti o qeveritarë dhe deputet shqiptar, nëse e ndien veten shqiptar mendo pak për këta të burgosur, si dhe për ata të Sopotit e shumë e shumë të tjerëve, ngase edhe ish-ambasadori amerikan e tha me gojën plot se ata njerëz janë të pafajshëm.

Duke qenë ata njerëz të pafajshëm, edhe këta të tjerët, e edhe ata më herët, edhe Rexhaili, e kështu të gjithë shqiptarët me radhë që mbahen nëpër burgje, janë të pafajshëm. Andaj zgjohu nga kjo letargji e mallkuar e mos hesht, mos u bë i urtë, se ajo dele që bëhet e urtë e han ujqit.

Bëhu koshient se këto gjy(ms)kata dhe kjo qe(n)veri janë antishqiptare dhe bile mundohen që **edhe gomarin mashkull t`a bëjnë me barrë.**

I BURGOSURI SHQIPTAR ENDE PO PRET, E QEVERITARI SHQIPTAR PO LAHET NË DET

(Përkitazi me shpalljen e dënimit me burgim të përjetshëm për Rexhail Qerimin, si dhe shqiptarëve të tjerë të pafajshëm që dergjen burgjeve të Maqedonisë pa pikë faji)

Shqiptarët e Maqedonisë kanë me të vërtetë politikanë që të bëjnë të qeshësh dhe të qash në të njëjtën kohë. Ata ngjajnë me personazhet donkishotesk të De Servantesit, që me kryeneçësi dhe arrogancë sillen ndaj popullit, respektivisht votuesve të vet kur janë në pushtet, ndërsa para zgjedhjeve elektorale dinë, ngase janë mësuar, të premtojnë edhe çudira, po edhe më shumë se kjo. Kësisoj me paraqitjet e tyre amatoreske para popullit që do të zgjidhin gjitha problemet që preokupojnë popullin, ata nuk bëjnë asgjë tjetër përpos që dëshmojnë dhe afirmojnë që sikur të luanin në filmin vizatimor "Pinokio", do ta luanin shkëlqyeshëm rolin e këtij të fundit dhe hunda do iu rritej nga gënjeshtrat deri në atë shkallë, saqë do të kishin problem që edhe ta mbanin me dy duar.

Këtë uverturë e bëra me qëllim, për t`i përkujtuar ata, nëse i ka mbetur pak kujtesë kuptohet, që para se të përgatisin valixhet për të shkuar në pushim, kanë një mori punët të pakryera, të lëna në gjysmë të rrugës, apo edhe të panisura fare. Kësisoj ata i kanë borxh zgjedhës-ve të vet, popullit dhe kësisoj edhe demokracisë, aq

shumë, saqë edhe Banc of California nuk do mund t`i lante borxhet e tyre të pafalshme.

Vallë shtroj pyetjen retorike për deputetin, pushtetarin shqiptar, politikanin si dhe qytetarin e thjeshtë, se para se të niset për pushim në bregdet, mal apo gjetiu, se a i bjen ndërmend se burgjet e Maqedonisë ngjasojnë me kampet e përqendrimeve naziste, ku pjesa dërmuese janë shqiptarë të pafajshëm? Vallë, a e dinë se nëpër burgje po kalbet rinia jonë e pafajshme e lënë në mëshirën e fatit, rini kjo e internuar brenda pa kurrfarë vërtetësie apo prove për ndonjë krim të bërë, apo për ndonjë veprim penalizues? Vallë, i shkon ndërmend pushtetarit shqiptar, i burgosuri i Opajës me burgim të përjetshëm, Rexhail Qerimi, që lëre që qytetarët e këtij vendi e dijnë, po edhe zogjtë e malit dhe fushës dëshmojnë që në momentin e vrasjes së policit për të cilin akuzohet ky person i pafajshëm, ai ka qenë me bashkëfshatarët e vet duke pirë kafe, bile edhe babai i viktimës (lexo: policit të vrarë) në momentin e shqiptimit të dënimit kapital ndaj Rexhailit, afirmoi se po gjykohen njerëz të pafajshëm, e fajtorët shëtitën si prostituta nate nëpër rrugë. Vallë i shkojnë nëpër mend pushtetarit shqiptar, se të burgosurit e Brodecit janë ndokund, që ata tani nuk janë as pjesë e spoteve televizive partiake të tyre, e lëre më në listat për lirim? Vallë, deri kur burgjet në Maqedoni do mbushen me shqiptarë të pafajshëm, vetëm se janë shqiptarë dhe se kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë së lavdishme çlirimtare, kryengritës të një kryengritje të pambaruar? Vallë dhimbsen ata nëse kanë shpirt për tu dhimbsur, për familjarët e burgosurve shqiptarë, për fëmijët, prindërit,

vëllezërit..., që nuk mund t`i shohin të dashurit e tyre, vetëm për qejfin e ndokujt të tregohet i gjithëfuqishëm në këtë shtet, si dhe për tjetrin që të ruajë karrigen e pushtetit? Kam edhe shumë pyetje të tjera, po frikohem se do ngelin pyetje retorike, ngase përgjigja gjendet brenda pyetjeve, si dhe kam drojën se pushtetari shqiptar do e kaplojë patetizmi apo nostalgjia, do e brejë ndërgjegjja, e kësisoj do zgjohet nga gjumi dimëror në verë, e do bëjë zgjidhje të problemeve me shkopin magjik, (lexo: hundën e Pinokios gënjeshtar).

Kësisoj ai pushtetarë që shkon për pushime në det, mos të harrojë se i burgosuri shqiptar që dergjet burgjeve i pafajshëm, edhe kur të lahet pushtetari, edhe kur të rrezitet, edhe kur të notojë, edhe kur të hajë në restorante të shtrenjta peshkun apo sallatën, ai e pret, nuk shkon asgjëkund, vetëm nëse nuk i inskenohet ndonjë "vetëvrasje"! Kësisoj, ti o i nderuar pushtetarë, që i "bëre të gjitha" për qytetarin tënd shqiptarë, votuesin tënd, ti që harrove të burgosurit e shumtë shqiptarë nëpër burgje, kujdes nga rrezitja e tepërt, mos djegësh, se vaj halli kush do na përfaqësojë pastaj. Kujdes nga noti në det në vende të thella, ngase mund te vijnë dallgë të mëdha e ti nuk di not, këtë jam më se i sigurt, e kam frikën mos të gjejë diçka e keqe e papritur, e mbesim pa pushtetarë e pa ty o haj medet! Kujdes nga haja e tepërt, se kam frikë se do shtosh kilogramë në trup, e aspak kilogram në mendje, e mund të kesh probleme shëndetësore, e kush na përfaqëson pastaj se?! Kujdes kur të shikohesh në pasqyrë, ngase mund të frikohesh nga karikatura jote, e vaj halli pastaj, kur të kthehesh nuk je më narcisoid, ashtu siç ishe kur shkove në

pushime. E di që, këto gjëra që i shkrova ndoshta do ju bëjnë të rikujtoheni, mos harroni se pas gjithë këtyre fatkeqësive që i kanë ndodhur shqiptarëve të pafajshëm nëpër burgje, fatkeqësia tjetër është të ju rikujtojmë kështu herë pas here për këta njerëz, sa herë që ju bëheni gati të shkoni për pushim. Mos harro se në errësirë duhet dritë e në fatkeqësi duhen mend. Mos harro, ti o i nderuar pushtetarë, politikan, deputet, ministër.... që politika është e ëmbël sikurse lufta, po njëherazi edhe po aq e rrezikshme sa ajo. Në luftë vritesh, shpallesh hero. Po nëse vdes politikisht, e di se çka shpallesh? Andaj, prano gabimin, përvishu punës si duhet, angazhohu që vëllezërit e tu që dergjen burgjeve të shpallen të pafajshëm dhe të lirohen menjëherë, ngase duke u penduar që ke gabuar, gati je i pafajshëm. E të shkosh në pushime, e të mos pranosh gabimet që ke bërë, do të thotë se bën gabimin edhe më të madh, i kthen shpinën popullit dhe e len në mëshirë të fatit. E ti politikan, pushtetarë, deputet, ministër e ku e di unë çfarë je, mos u lodh të kontribuosh për pamjen dhe dukjen tënde, po mundohu të kontribuosh për karakterin tënd.

NËNË MOJ, MBAJ ZI PËR VËLLANË
(HARUN ALIUT-KUSHTRIMIT)

I nderuar lexues, përderisa jam duke e shkruar këtë artikull, lotët më shkojnë nëpër sy dhe shpirti më djeg, kur e mendoj se si mund që njeriut të tillë, t`i ndodhte kjo gjë, si mund që një njeriu të madh si ai, t`i veshin akuza të tilla monstruoze, si mundej që këtij njeriu i cili sakrifikoi gjithçka për komb e shqiptari, t`i veshin etiketa gojëliga, nga ata ndjellakeq që gjatë këtyre viteve sollën vetëm fatkeqësi për kombin shqiptar në Maqedoni. Ditë më parë ndodhi aksioni i "suksesshëm" policor që shtangu të gjithë shqiptarët që i thonë bukës bukë e ujit ujë. U vra, Kushtrimi i lirisë shqiptare, njeriu i cili ishte Shëmbëlltyrë e kombit shqiptar në Maqedoni. Meqenëse ky njeri i madh arriti që të hyjë ne botën e dëshmorëve, përmes tradhtisë shqiptare, mua nuk më shkojnë mendtë askund tjetër përpos tek analogjia e rastit të Komandant Kushtrimit,

me heroin tjetër shqiptar Luigj Gurakuqin, për të cilin është thurur një elegji e bukur nga Fan Stilian Noli. Pse?

E para, sepse Harun Aliu, njeriu i cili luftoi për komb e atdhe u vra pabesisht në një vend të banuar me shqiptarë, nga policia e një shteti që nuk arrita asnjëherë ta mësojë se si duhet të quhet, ngase në çdo dhjetë vjet pjesëtarët e komunitetit që pretendojnë se janë shumicë në këtë shtet, si dhe qeveritarët dhe shtetarët e këtij "shteti", performojnë me emra të ndryshëm, herë si maqedonas, herë si sllavomaqedonas, herë si maqedonas antik....

E dyta, heshtja e faktorit politik shqiptar në qeveri përpos meje, e neveriti çdo shqiptar, ngase partia e cila pretendon se është parti vijuese e luftës dhe e UÇK-së, dëshmoi edhe njëherë për të satën herë me radhë, se nuk ka legjitimitet në qeveri, nuk lë përshtypje se ekziston dhe se është thjesht e paqenë në qeveri. Kjo parti, e cila fatkeqësisht po hesht atëherë kur duhet të flitet më së shumti, sakrificën sublime të shqiptarëve për liri dhe avancim të të drejtave e grisi copa- copa. Paramendoni, i shprehin ngushëllime familjes së Harunit të ndjerë, ndërsa i bëjnë lutje Gruevskit për plotësim të kërkesave të tyre të skaduara, të cilat kërkesa duheshin të bëheshin kur hynë në qeveri e jo tash.

E treta, të pretendohet nga shteti dhe qeveritarët aktual, se njerëzit e vrarë në Radushë, janë kriminelë ordiner dhe terroristë, kjo nuk është përbuzje vetëm për të vrarët, po edhe për kombin shqiptar në përgjithësi. Një njeri si Haruni, e di secili që nuk ka qenë i tillë, ngase kriminelët ordinerë janë të lirë dhe kanë përkrahjen institucionale në Maqedoni, ndërsa çlirimtarët e vërtetë

ose janë nëpër burgje, ose janë të vrarë, ose kërkohen nga policia e janë në arrati, ose janë në listën e ardhshme për ekzekutim.

E katërta, edhe fëmija i djepit,e mori vesh se në vrasjen e Komandant Kushtrimit gisht kanë edhe disa shqipfolës. Po po, e them me përgjegjësinë më të madhe shqipfolës, sepse askush më mirë se ata shqipfolës, që do t`i mallkojë Perëndia dhe Shqiptaria, nuk ka mundur të dijë dhe të spiunojë vendndodhjen e Harunit. E siç do të thoshte Faik Konica, "Armiku më i madh i shqiptarit është vet shqiptari", (e ka pasur mendjen tek shqipfolësit që pretendojnë se janë shqiptarë), me të vërtetë zë vend bash në këtë vrasje.

E pesta, pretendimet e shtetit që mëton se është demokratik, e simulon skenarë që provokojnë zjarr, duke vrarë të pafajshëm (fajësia e tyre nuk u dëshmua kurrë) nxjerr në shesh gjërat që dëshmojnë se ky shtet duke tentuar të locojë problemet me emrin dhe identitetin në çështje të tjera, duke tentuar që të relativizojë problemet ndëretnike, dëshiron që të paraqes shqiptarët si frenues të proceseve, edhe pse janë pikërisht shqiptarët, ata që e mbajnë me infuzione këtë shtet dhe shpesh qeveritarët shqiptarë aktualë e duan më shumë se vet Gruevski dhe suitat e tij këtë shtet, bile edhe përjetojnë orgazëm për këtë shtet.

E gjashta, miratimi i kësaj vrasje dhe heshtja e faktorit politik shqiptar në Kosovë, dëshmon edhe njëherë se shqiptarët atëherë kur duhet të jenë unik janë të përçarë, atëherë kur duhet të jenë stoik janë të ndarë. Ardhja e z. Bajram Rexhepit (i cili nuk arriti që ta zgjidh problemin në shtëpinë e tij në Mitrovicë, e në

Kosovë, ngase si Ministër i Punëve të Brendshme nuk arriti që të arrestojë të paktën një kriminel serb, që ka marr pjesë në krime ndaj shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë, e të cilët kriminelë shëtisin të lirë rrugëve të Kosovës pa iu trembur syri, e lëre më të ndihmojë ndonjë zgjidhje të problemeve shqiptare në Maqedoni), përulja e tij para Jankullovskës, e cila si çdoherë tregohet suprematívе ndaj shqiptarëve, sa herë që vret shqiptarë të pafajshëm, dëshmon se Kosova ende është larg të qenit shtet. Imagjinoja sikur të ishte vrarë ndonjë serb kriminel në Kosovë, Serbia do të ngrinte zërin në qiell për ta, ndërsa shteti i Kosovës në vend se të gjykojë vrasjen e shqiptarëve, ai e miraton këtë vrasje, bile pranon edhe listën e zezë të personave që na qenkan në Kosovë, e të cilët duhet t`i kthehen burgjeve të Maqedonisë së Gruevskit dhe Jankullovkës.

E shtata, Shqipëria në vend që të thotë një fjali të thjeshtë të paktën dhe të kritikojë këto veprime antinjerëzore të policisë maqedonase, ajo në momentet vendimtare të kombit, ose është e nxënë në protesta, ose politikanët atje na paraqiten kozmopolitë të tepruar, saqë të krijojnë përshtypjen e zombit, njerëzve pa identitet, si dhe shpesh del ndonjë analist a publicist abdall dhe bile fajëson shqiptarët e Maqedonisë, për mospasje devotshmëri ndaj shtetit që të vret natën e ditën.

Andaj, për ty o dëshmor i kombit, o Harun Aliu, Komandant Kushtrimi, që prehesh sot në qetësi ashtu siç dinë të prehen trimat e lirisë që nuk vdesin edhe kur tu pushojë së rrahuri zemra, u vrave në pabesi duke u shitur nga dorë e tradhtarit, por jemi krenar me ty si shqiptarë, që të patëm bir, vëlla, shok dhe dashamirë.

Për ty vlen thënia e Ciceronit ***"Jeto si trim, e nëse fati nuk është me ty, kundërshto rënien me zemër trimërie"***. E ti, dite të kundërshtosh rënien si burrë, sepse nuk u përule, sikurse ca të tjerë para shantazheve dhe kërcënimeve. Në momentin që po shkruaj këtë artikull për ty që je në përjetësi, më sillet nëpër kokë elegjia e Nolit, që unë ta kushtoj ty, "*Nënë moj mbaj zi për vëllanë, me shumë plumba na e vranë, na e vranë e na e shanë, na i thanë kriminel e vrastar*". Po ti nuk je i tillë, historia dëshmon dhe do të dëshmojë, atëherë kur këtij kombi fatkeq do t`i vijnë liderë të vërtetë, që para se gjithash do të jenë shqiptarë.

KULTUROCIDI NDAJ LIBRIT SHQIP NË MAQEDONI

Javës së kaluar i tërë opinioni shqiptar, por edhe më gjerë u shokua nga mungesa apo deficiti i librit shqip në Panairin e organizuar në qytetin e lashtë dardan të Shkupit. Mungoi libri shqip nga Shqipëria dhe nga Kosova. Edhe ato pak libra që ishin në shqip të sjellura nga ca shtëpi botuese shqiptare, nuk plotësuan nevojën e lexuesit shqiptar, sepse ishin tituj vetëm se të njohur më përpara dhe të konsumuara deri diku nga lexuesi. Arsyeja se përse mungoi libri shqip në këtë Panair, pak a shumë e din të gjithë. Po ajo që të çudit më shumë është mosreagimi i intelektualëve, akademikëve, njerëzve të penës dhe partive politike shqiptare në përgjithësi.

Gjithçka kaloi në heshtje. Sikurse edhe çdo veprim tjetër antishqiptar. Dhe prapë heshtje. Prapë në vend se të reagohet, heshtet. Thuaja se nuk vlen për ne thënia e urtë ***"I pësuari, i mësuari".*** Ne vazhdimisht pësojmë dhe asnjëherë nuk mësojmë. Pse, shtrohet pyetja? Sepse mungon zëri kritik, apo edhe ai zë i vetëm dhe i rrallë që është margjinalizohet. Pushteti aktual maqedonas në vazhdën e politikës së tij antishqiptare din ku të godet më së miri. Ai godet në librin shqip. Sepse është koshient për thënien ***"Kush më shumë di, më shumë do të dijë"***. Ky pushtet nuk do që shqiptarët të dinë. Ai i do shqiptarët servil, puthadorësh, të mjerë, analfabet apo edhe më keq analfabet me diploma. Si çdoherë. Ky pushtet në vend se të jetë i hapur ndaj librit ai tkurret në absurditet. Sot kur në botën e civilizuar

dhe qytetëruar flet gjuha e kibernetikës, e shkencës, e librit të digjitalizuar dhe të internetizuar, në Maqedoni ndodh e kundërta. Lëre më që mungojnë këto të fundit, por edhe libri shqip ndalohet e nuk lejohet. Pushtetarët maqedonas kanë frikë prej tij, sepse e dinë se arma më e fortë për të sfiduar tjetrin është leximi. Për këtë pushtet është shumë mirë kur shqiptari hesht dhe nuk flet, kur shqiptari nuk lexon, kur shqiptari në vend se të kërkojë dituri kërkon servilitet. Për atë arsye fatkeqësitë na rrjedhin në mënyre serike një pas një, pa ndalur. Për atë arsye si kombi më i vjetër në Ballkan dhe në Evropë, anashkalohemi nga pushteti, përfaqësuesit e të cilit nuk e dinë para 20 vitesh çfarë kanë qenë e çfarë janë tashti. Dhe neve në vend se të veprojmë, heshtim.

Habia dhe mllefi edhe më i madh më ndodh çdoherë kur vizitoj Prishtinën dhe Tiranën dhe kur blej libra atje. Kur kthehem për në shtetin "tim", në kufi doganieri çdoherë më kontrollon veturën dhe çantën e mbushur përplot me libra. Dhe e shoh se i pengon. Herën e fundit i pengoi tej mase libri shume i bukur me ilustrime i studiuesit shqiptar nga Kosova z. Faton Mehmetajt, me titull ***"Natë yjendezur, nga mbreti Pirro e deri tek Adem Jashari"***. Dhe kur doganieri më pyeti dhe më tha se çfarë është kjo, iu përgjigja me një pezëm të madh. "A je zotëri i shkolluar, ky është libër e asgjë tjetër". Më tha që gjoja se nuk paskam të drejtë të kaloj në kufi me libra. Atëherë durimi nuk më pushoi e i thash troç "Kapni hajnat, kontrabanduesit e armëve dhe të drogës, kriminelët, vjedhësit e fëmijëve që humbin çdo ditë, e më leni rehat". Nuk kishte çfarë të bëjë dhe u step i hidhëruar tej mase.

E bisedoja me vetveten, se përse i pengon këtij njeriu libri shqip, duke e ditur përgjigjen aty për aty, por duke u hidhëruar edhe më shumë me partitë politike shqiptare në pozitë posaçërisht, po edhe ato në opozitë, se si nuk e ngritin asnjëherë zërin ndaj diskriminimit të librit shqip. Dhe përnjëherë më dalin përpara rrëfimet e babait tim dhe të familjarëve e dashamirëve shumë më të vjetër se unë, që më rrëfenin për vështirësinë e leximit të librit shqip dhe blerjes së po të njëjtit gjatë kohës së monizmit. E thash vet me vete, po çfarë ndryshimi kanë rrethanat aktuale neomoniste prej atyre më përpara. Asgjë. Tani më duket edhe më keq. Përpara sillej libri nga Shqipëria e Kosova edhe pse me vështirësi nëpër duart e shqiptarëve të Maqedonisë edhe pse me barriera të shumta, ndërsa tani në vend se të hiqen barrierat ato na performojnë dhe shfaqen në formë tjetër edhe më të vrazhdë.

Dhe më vjen ndërmend pyetja për pushtetarin aktual shqiptar në qeverinë e Maqedonisë, ***"A do, e s'di, a din e s'do"*** **?** Kam drojë së mos vallë janë të dyja.

Dhe papritmas nga frika mos të personalizoj asgjë, duke qenë çdoherë koshient për thënien ***"Sa më shumë të flasësh në vetën e parë, aq më pak je vetvetja"***, përmes këtij artikulli shpreha indinjatën e çdo lexuesi shqiptar që është ndier i ofenduar tej mase nga kultorocidi i librit shqip në këtë Panair dhe gjithkund në shtet, si dhe nga heshtja e paskrupullt e **akadhemykëve** që duhet të flasin, si dhe e pushtetarëve servil shurdhmemec. Andaj besoj se nuk do të has në hidhërim, por në mirëkuptim. Sepse, ***Kritika është ilaç i hidhur, po ilaç ama.***

TË FOLURIT EVROPIAN, TË VEPRUARIT DHE TË MENDUARIT BIZANTIN

Është bërë rutinë që në Ballkan të dëgjosh togfjalëshin dhe refrenin ***"procese euro-integruese, integrime euro-atlantike"***, e shumë e shumë gjëra të tjera, saqë nuk i japin përshtypje as bujkut këto fjalë, sepse edhe ai është ngopur, e mos të flasim më për elitat dhe intelektualët e mirëfilltë. Këtë togfjalësh dhe refren më së tepërmi e dëgjojmë nga pushtetarët dhe shtetarët aktual maqedonas në qeveri, saqë të ngjallin dhe japin një lloj neverie dhe sikleti të theksuar, që vështirë se mund ta mbash. E aq më shumë kur e dëgjojmë kryeministrin, ministrat, e qeveritarët tjerë që përdorin çdo minutë këtë togfjalësh, ndërsa në çdo moment marrin kritika dhe pika negative nga Brukseli dhe qendrat e vendosjes ndërkombëtare.

Këtyre ditëve, në një gazetë shqiptare pata rastin të lexoj një artikull në lidhje me ftohjen dhe prishjen e marrëdhënieve me OSBE-në nga ana e pushtetarëve "tanë". Kohë më parë në gazetë u paralajmërua dhe informua edhe për përkeqësimin dhe ftohjen e marrëdhënieve me eurodiplomatin. Z Fuere. Këtu nuk duhet harruar edhe vlerësimet negative për çdo gjë, nga ana e diplomatëve të tjerë ndërkombëtarë, duke mos e harruar edhe pezmin dhe vrerin e mbledhur edhe nga ana e shqiptarëve si dhe komuniteteve të tjera pakicë në Maqedoni.

Kritikat vijnë edhe nga ana e fqinjëve. Kësisoj Bullgaria nxjerr shifra me dëshmi për numrin e bull-

garëve në Maqedoni, Greqia siç dihet kërkon me ngulm ndryshimin e emrit të vjedhur nga "ata" e shumë e shumë gjëra të tjera... Ndërsa ende dëgjojmë të folurit evropian nga ana e qeveritarëve.

Dëgjojmë nga qeveritarët dhe participientët qeveritarë se marrëdhëniet ndëretnike janë të relaksuara, ndërsa nga ana tjetër kemi një varg serik të problemeve si p.sh: paralajmërime për protesta gjithëpopullore, për konflikt të mundshëm, greva të shqiptarëve nëpër burgje, imponime të politikave sllavocentriste sikurse është të mësuarit e sllavomaqedonishtes nëpër shkolla, mungesën e investimeve nëpër zonat shqiptare, eksodin e shqiptarëve për botën e jashtme, mungesën e vullnetit për zgjidhje të statusit të luftëtarëve shqiptarë të 2001-shit të garantuar ndërkombëtarisht me arbitrazh ndërkombëtar nga Marrëveshja letargjike e Ohrit, aksione spektakolare të arrestimit të të dyshuarve për korrupsione, të cilët pas ca muajsh jemi mësuar ti shohim të lirë dhe të pafajshëm, e shumë e shumë gjëra të tjera që kanë mbushur kupën.

Ndërsa në njërën anë kemi këtë pasqyrë të zymtë, karakteristike për mentalitetin bizantin, në anën tjetër kemi refrenet evropiane të elitës shtetërore, thuaja se neve si shqiptarë nuk e dimë se çdo të thotë të sillesh dhe të jesh evropian.

Andaj të nderuar shtetarë, ndryshe është të flasësh si evropian e të mendosh dhe veprosh si bizantin. Me projekte që tensionojnë marrëdhëniet ndëretnike, me projekte si "Shkupi 2014" që rrezikojnë të kthejnë Maqedoninë dhe Ballkanin në vitin 1914, vështirë se mund të perceptoheni si evropian. Evropa ka lënë

anash ksenofobitë raciste dhe dashakeqe, ndërsa ju lëre që i kultivoni të njëjtat, po edhe mburreni dhe i shfrytëzoni për të përfituar poena politik, si dhe influenconi edhe masat popullore, që për fat të keq janë shndërruar në lypsarë dhe robotë, ***ngase i talluri të tall***. Dhe prapë paralelisht me këto zhvillime negative, lodhemi duke dëgjuar nëpër televizionet e ndryshme refrenet e mërzitshme që na lodhin, ngase e dimë sepse paraqesin vetëm broçkulla dhe asgjë tjetër. Me sa duket për ju, fjala e urtë ***"Ai qe di më së shumti, flet më së paku dhe vepron më së shumti"***, nuk vlen.

Andaj na është bërë mjaft, siç thonë francezët **Ras-le-bol.** Ngase duke dëgjuar çdo ditë e më shumë përpjekjet bizantine për *"moshumbjen e identitetit maqedonas dhe promovimin e të njëjtit"* dëshmohet edhe më shumë se ky identitet është shpikje e llojit që mund të definohet me fjalën e urtë ***" Pyetën mushkën, cilin ka baba; "kam dajë kalën" – tha ajo."***.

Andaj siç do të thoshte ish-presidenti historik i Kosovës, i ndjeri z. Ibrahim Rugova, ***"Demokracia është të hash gurë"*** në kuptimin që duhet përkushtim dhe sakrificë e madhe, ashtu edhe unë kam porosi që besoj se çdo intelektual e ndan, ***"të jesh dhe të sillesh si evropian është privilegj, kënaqësi dhe vlerë, por është edhe sakrificë, fleksibilitet, përkushtim dhe veprim aktiv"***. E ne deri më tani shohim vetëm kryeneçësi, imponim, vulgarizim të demokracisë dhe sjellje bizantine. Andaj i nderuar kryeministër dhe të nderuar qeveritarë aktualë, kujdes sepse duhet të keni parasysh fjalën domethënëse ***"Ç'ke moj zemër që rënkon; koka bën, koka pëson"***.

DO TË DALIM, NUK DO TË DALIM

E fillova kësisoj këtë artikull ngase me të vërtetë i tërë elektorati shqiptarë, e posaçërisht votuesit e partisë shqiptare në shtetin pa pushtet në Maqedoni, ndjehen tejet të lënë pas dore dhe në dilemën e madhe hamletiane, për shkak të deklaratave herë euforike e herë joracionale të krerëve të kësaj partie, për gjoja (mos)braktisje të koalicionit qeveritar alla Gruevski. Sa herë që dëgjojmë ndonjë lidere si z. Teuta Arifi që me një guxim të pashoq e pranon se në këtë qeveri thjesht shqiptarët janë vetëm Barbi Kukulla, në anën tjetër dëgjojmë krerët tjerë të po kësaj partie për mosbraktisjen e qeverisë, për hir të proceseve (ç)integruese të vendit. Kjo i bie, për hir të interesave ***par excellence*** të Gruevskit. Pse? Sepse partia shqiptare në pushtet, duke e ditur se interesi i Gruevskit nuk janë integrimet, po poshtërimi dhe shterja e partive shqiptare dhe e shqiptarëve në përgjithësi, tregimi i muskujve të tij karshi tyre. Po të ishin prioritare integrimet për këtë qeveri dhe për Gruevskin, ajo nuk do të ftohte raportet më gjithë korin diplomatik ndërkombëtar në Maqedoni dhe me të gjitha misionet e huaja që gjenden këtu. E mbi të gjitha do të angazhohej për një shtet ku të gjithë qytetarët do të ndiheshin të barabartë dhe të trajtuar njëjtë. Por jo. Po çfarë bën lideri i integristëve, i cili në vitet 2001 shihej si shpresa e vetme e shqiptarëve. Ai kur duhet ti dëgjohet më së shumti zëri hesht. Kur duhet më së shumti të veprojë ai pasivizohet. Dhe e tëra kjo jorastësisht. Por, sepse është koshient se është shterur më nga zotëri Gruevski dhe

duke pranuar poltronizimin nuk i ka mbetur më asgjë, përpos të luajë rolin e të qenit tolerant, atëherë kur duhet të bëhet më stoik dhe i vendosur.

Do të dalim apo nuk do të dalim, shtron pyetjen secili shqiptarë. Dhe prapë amulli dhe përplot dilema. Dalim por si? Dalim po në ç`mënyrë? Paj, edhe ashtu jemi të dalë e të ç'dalë, ngase injorim në çdo sferë. Injorim i flamurit kombëtar; injorim i zgjidhjes së statusit të luftëtarëve shqiptarë të 2001-shit; injorim i mos-procesuimit të Rasteve të Hagës; injorim i kërkesave të partive shqiptarë; projekte galopante për bizantizim dhe sllavizim nën emrin e antikizimit të qytetit të Shkupit e varfërim dhe mosinvestim në zonat shqiptare; nxjerrje të Enciklopedisë monstruoze sllavomaqedonase ku paraqitet shqiptari sikurse fiset e egra afrikane, si fise shpellash dhe mosdhënie përgjegjësi për këtë; aksione policore për burgosje të "kriminelëve shqiptarë"; dënime drakonike për shqiptarë; mos kokëçarje për të burgosurit e gjorë të Sopotit që pa pikë faji ngelin prapa grilave, për fajin që kurrë se kanë bërë përkundër dëshmive të ish Ambasadorit Bigman; injorim i faktorit ndërkombëtar; varrosje të Marrëveshjes së Ohrit; aksione spektakolare për burgosje të të akuzuarve për korrupsion dhe lirim shumë i shpejtë i tyre pas dy- tre muajsh; injorim i pafalshëm i gjuhës shqipe... e pa fund gjëra të tjera dhe "ne" ende "jemi" brenda???

Dhe në mes tjerash edhe unë shtroj pyetjen," ***A do, e s'di, a din e s'do***"? Dhe përgjigjen nuk mund ta gjej dot. Blasfemitë dhe kuietizmi (mosveprimi) i faktorit politik shqiptarë i ka ardhur secilit shqiptarë në majë të hundës. Ngase shihet qartë edhe nga protagonistët e po

kësaj partie pjesëmarrëse në pushtet se më i ka ardhur fundi për gjithçka, janë të lodhur, si dhe aq të pahetueshëm për Gruevskin, saqë nuk i bëjnë më përshtypje atij dot.

Ky kuietizëm (mosveprim) tregon qartë se shtetit që nuk e mësova kurrë si quhet dhe si duhet të quhet, i ka ardhur koha që të pagëzohet ashtu si çdo shtet normal, si dhe të definojë raportet mes dy komuniteteve shumicë atij që pretendon se është shumicë, e që kontestohet nga gjithkush përbrenda dhe jashtë dhe atij që trajtohet si pakicë, e në fakt është shumicë, po (vet)injorohet. Por, prapë na qëndron si shpata e Demokleut mbi kokë refreni, **të dalim apo mos të dalim.** Andaj në vend se populli dhe opinioni shqiptarë të pres se a do të dal ndokush apo nuk do të dal nga qeveria, më mirë është që të pres momentin e duhur dhe të ndëshkojë me votë politikën e mbrapshtë e dashakeqe të llojit **a do të dalim apo nuk do të dalim.**

Sepse popull i dashur, **Ai që nuk di dhe nuk di pse nuk di – është i marrë; largohu prej tij, Ai që nuk di dhe e di se nuk di, është fëmijë, mësoje dhe ndëshkoje; nëse ti di, e nuk e mëson ke bërë gabim. Ai që di dhe nuk e di që di, është i fjetur; mos e lë të flejë por zgjoje – nëse nuk e zgjon ke bërë mëkat. Ai që di dhe e di se di është i mençur; andaj shko pas tij, nëse shkon pas tij do të kesh udhën e ndriçuar.** Se në cilin grup binë qeveritarët aktualë shqiptarë, po edhe ato më përpara ne e dimë apo jo?

TENTATIVAT PËR KIDNAPIME: OBSESIONE APO REALITETE

Kohëve të fundit i gjithë opinioni në Maqedoni, e posaçërisht ai shqiptar është i shokuar dhe i tendosur nga tentativat për kidnapime të fëmijëve.

Në fakt kidnapimi dhe tentativat për kidnapime të fëmijëve janë bërë si të thuash **modë** e kohëve të fundit. Si një akt barbar këto dukuri të këqija kanë qenë të pranishme vite me radhë nëpër shumë vende, por në trevat shqiptare deri kohën e fundit ishin dukuri apo fenomene të panjohura. Mirëpo, ajo që të shqetëson më së shumti është çështja se përse këto kidnapime, respektivisht tentativa për kidnapime të fëmijëve ndodhin vetëm në zonat shqiptare.

Thuaja se vetëm tek popullata shqiptare ka vend për prani të krimit, për prani të fenomeneve barbare.

Ajo që të habit më së shumti është heshtja qeveritare dhe "miratimi" i lehtë dhe shumë normal i këtyre tentativave për kidnapime, sa që të japin përshtypje se këto tentativa për kidnapime mund të kenë edhe përkrahjen e caktuar institucionale, ngase kohëve të fundit niveli i mosbesimeve ndëretnike është shumë i madh dhe në prag të shpërthimit dhe është fare e lehtë që të besohet se këto gjëra të shëmtuara kanë edhe miratimin e palës tjetër, respektivisht suportin e qarqeve të caktuara institucionale në formë direkte apo indirekte, qoftë ky veprim i kryer edhe nga shqipfolës të ndyrë që para së gjithash nuk janë njerëz. Përse sot në territorin e komunës së Likovës, Kumanovës (kujdes, vetëm në zonat

shqiptare ama), në zonën e Shkupit (po ashtu pjesa shqiptare), si dhe në zona tjera shqiptare në Maqedoni fëmijët nuk janë të rehatshëm, ndërsa prindërit shqiptarë i shoqërojnë fëmijët e tyre vazhdimisht për në shkollë dhe për në shtëpi? Ngase pushteti aktual maqedonas është duke tentuar që vëmendjes së akumulimit të problemeve sa e sa vjeçare, t`ia ndërrojë kursin, respektivisht direkt apo indirekt locon apo sajon një dukuri apo fenomen të tillë barbar, në mënyrë që qenia shqiptare të njolloset, që zonat shqiptare të paraqiten si zona problematike ku nuk ka perspektivë dhe rehati, ku mungon klima e volitshme për rritjen e gjeneratave të reja dhe ardhmërisë së botës, (lexo fëmijëve). Eksponimi i zonave shqiptare si të rrezikshme para faktorëve ndërkombëtarë dhe opinionit publik flet për mungesën e një kulture demokratike të qeverisë maqedonase, ngase mungesa e investimeve në këto zona duhet të "arsyetohet" disi. Kësaj politike i ndihmojnë edhe disa komunjarë, qe më vjen turp ti them prefektë që pranojnë me ose padije që këto zona ku po ndodhin tentativat për kidnapime janë zona krize, me ç`rast i lehtësohet puna palës tjetër, sepse duke afirmuar kështu, ata vet e pranojnë se në zonat e tyre nuk ka qetësi dhe rehati.

E normal që nuk ka rehati, ngase fëmija shqiptarë i gjorë duke u privuar nga qeveritarët shqiptarë që na kanë zhgënjyer vazhdimisht, më shumë është i preokupuar se kur do ja fillojë lufta apo konflikti, në vend se të flet për gjëra të tjera, si për shembull ku do t`i kaloj pushimet verore, çka do të lexojë, cilin zhanër të librave e shumë e shumë gjëra tjera.

Fëmija shqiptarë i gjorë nuk ka kohë të ëndërrojë për gjëra që i`a shtojnë rritën ngase në çdo skaj mund të jetë gjah për kidnapim nga të ligët, në secilin kanal televiziv sheh dhe dëgjon për kidnapime, vrasje, burgosje dhe dënime drakonike ndaj shqiptarëve, në çdo katër vjet është i mësuar që të pres se kur do të fillojë lufta, kur do t`ia kris pushka e kështu me radhë. E përse? Sepse politi(kuajt) shqiptarë nuk i ofrojnë atij garancinë për rritje pa brenga dhe me perspektivë, por i ofrojnë varfëri. Po këta qeveritarë atij nuk i ndërtojnë një kopsht për lojtore si dhe disneylande, sikurse që i ndërton pala maqedonase fëmijëve të tyre, por i shkatërron edhe pak ato gjëra dhe ëndrra që i ka.

Mallkuar qofshin ata politi(kuaj) që nuk mendojnë për ardhmërinë e fëmijëve të tyre dhe fëmijëve të tjerë, sepse ata janë të gjithë njësoj, janë fëmijë, ej more janë fëmijë të shkretët. A thua i kanë mësuar dhe lexuar Konventat e garantimit të të drejtave të fëmijëve dhe moscenimit të dinjitetit dhe ëndrrave të tyre?! Pajë, çfarë të lexuara ore, ata nuk dinë të lexojnë, ngase edhe po të lexojnë, lexojnë mbrapsht ose i ngatërrojnë shkronjat.

"Mos u prishni lumturinë, mos i`u prekni dashurinë, as kërkush mos ta provojë se nënat s`ju lejojnë" janë këta vargje të këngëtares shqiptare Parashqevi Simaku, që kisha dashur që secili njeri, qoftë ai edhe me pamje të njeriut dhe brendësi monstrumi t`i dëgjojë dhe ti ketë parasysh.

KARAKTERISTIKAT E NJË LLOJ LIDERI

Është më se e vërtetë që çelësi kyç i udhëheqjes së një populli drejt lumenjve të suksesit është lideri dhe lidershipi. Zaten, po mos të kishte lider dhe lidership efiçient, populli dhe kombi si subjekt më i lartë do të zhyteshin në dështime dhe në humbje të thella. Është më se e qartë se koha e liderit njësh, koha e kultit të individit ka përfunduar, e kam fjalën këtu për shtetet demokratike dhe me demokraci liberale. Tani në këto shtete është koha e lidershipit, pra e atyre liderëve që punojnë në ekip, në grup, që menaxhojnë dhe qeverisin në formë ekipore, ngase edhe përgjegjësitë janë më të vogla edhe rezultatet janë më efiçiente njëkohësisht.

Shtrohet pyetja se si dallohet një njeri si lider, cilat janë karakteristikat e tij, me çfarë gjëra shquhet ai si lider, cilat janë ato karakteristika që e paraqesin he e eksponojnë një njeri si lider? Janë shumë gjëra që do përpiqem që t`i analizoj në formë të thuktë.

Për ti shkoqitur këto gjëra, duhet pasur parasysh dhe duhet bërë ndarje mes liderit në një shtet demokratik dhe atij në një shtet me demokraci të brishtë, neodiktatoriale, me sisteme të korruptuara joefiçiente, me mungesë të kulturës dhe përvojës demokratike.

Është më se e qartë se pushteti është mjaft i lidhur me liderin dhe e kundërta, lideri është i lidhur për pushtetin. Pushteti dhe lideri apo lidershipi maten me sasinë e prodhimit të ideve ndaj efekteve të paparashikuara. Dhe kjo ndodh jo vetëm në formën teorike , por edh enë formën praktike.

Karakteristikat e një lloji të liderit demokratik, të një njeriu i cili nuk vuan nga sëmundja kancerogjene e kultit të individit, të një njeriu i cili nuk vuan për mbështetjen qind për qind nga masat e thjeshta, sepse është koshient që nuk mund të ketë përkrahjen qind për qind nga masat, sepse kjo në një mjedis demokratik është e pamundur. Them E pamundur sepse siç do të thoshte Gandi "Bota nuk do të kishte kuptim pa diversitetin e theksuar", andaj me këtë mëtoj të them që çështja e diversitetit, e alteritetit, e mendimit pro e contra është çdoherë e pranishme dhe e paevitueshme, andaj një lider duhet të mësohet që të respektojë mendimin pro dhe mendimin contra.

Nëse flasim në bazë të digresioni të bërë më parë që ekzistojnë tipe të ndryshme të liderëve dhe lidershipit, atëherë duhet patjetër të potencohen edhe tipet e këtyre liderëve, që do të thotë të shpalosen dhe shkoqiten secili veç e veç.

Por, një gjë dihet, ata që janë të arsyeshëm dhe racional e pranojnë gjykimin dhe vlerësimin, si dhe njëkohësisht edhe realitetin që koha e liderëve historik tradicional sasior në Ballkan ka përfunduar, si dhe ata janë pjesë e historisë dhe mendësisë së shekullit që lamë pas. Mirëpo, edhe pse në doza të caktuara mund të hasim edhe më tutje liderë të llojit demodé, të shekullit të kaluar, ata liderë duhet të izolohen që mos tu jepet mundësia që të tregojnë veten e tyre, të promovohen si dhe të keqpërdorin masën e njerëzve. Ata që nuk pajtohen me këtë realitet objektiv janë pesimistë subjektiv dhe të verbër politikisht.

Në Ballkanin e trazuar që shkon drejt qetësimit dhe rehabilitimit si duhet, megjithë tendencat e ca liderëve që përmes politikave nacionaliste të mbajnë turmat nën kontroll dhe të shpijnë proceset prapa, është me rëndësi të thuhet që liderët që përdorin nacionalizmin, populizmin, retorikën demagogjike, politikën e forcës, mjetet e presionit dhe shtypjes, imponimin e mendimeve dhe vendimeve... po shkojnë drejt margjinalizimit edhe nga faktori ndërkombëtar edhe nga faktori kohë fatmirësisht, sepse rrethanat dhe kohërat aktuale nuk lejojnë mendësinë patriarkale dhe nacionaliste të para dy luftërave botërore. Kjo nuk do të thotë që lideri duhet të bëhet kozmopolit dhe të harrojë krejtësisht interesin kombëtar, por ai duhet të ketë parasysh interesin njerëzor mbi të gjitha e mandej edhe atë racional. Mediokriteti për liderin dhe lidershipin aktual nuk mund të shkojë.

Megjithë fatkeqësinë që kemi pasur si njerëz, si gjenerata që të jemi peng i liderëve që janë të kompozuar nga mendësia e të qenit superior ndaj gjithçkaje, duke abuzuar me masat, koha aktuale, koha dhe rrethanat që na kanë sjellë impaktin e theksuar të globalizimit, të kibernetizimit, të një miksi jashtëzakonisht të madh dhe të theksuar të gjërave që më përpara ishin utopi për liderët e atëhershëm, na detyrojnë patjetër që të mendojmë si duhet, të sillemi si liderë dhe lidership politik, intelektual dhe diplomatik, si një ansambël dhe tërësi pjesë e procesit demokratik dhe integrues.

Koha e liderit kult ka mbaruar. Ata që mëtojnë të sillen dhe të luajnë me këtë kartë janë të prirë që të vdesin politikisht dhe intelektualist. Rasti i të tillëve

është numeroz. Kemi me qindra e qindra. Mirëpo ata janë pjesë e historisë së shëmtuar, ndërkaq ata që sillen si lider po që respektojnë lidershipin, pra poqë se punojnë në ekip, që konsultohen për çdo vendim me këshilltarë profesionistë, që pranë vetes kanë kuadro profesionale, që respektojnë alteritetin, që krijojnë tampon zona mes nacionalizmit negativ dhe patriotizmit nacionalist pozitiv, ata janë te prirë që të jenë të suksesshëm dhe të kenë harmoni gjatë qeverisjes së tyre me masat popullore.

Mirëpo kur jemi tek lideri historik dhe lideri i futurologjisë, këtu duhet të kemi parasysh çështjen e asaj se vallë cili i takon njërës anë e cili tjetrës. Lideri nacionalist, demagog, mediokër, hipokrit që manipulon me masat, i përket historisë së shëmtuar, ndërsa ai që respekton masat, që është transparent, që respekton popullin dhe kombin e tij (këtu duhet pasur parasysh dallimin mes popullit dhe kombit), që respekton qenien njerëzore si "L`Etre Humaine, që respekton atë që quhet alteritet, që respekton mendimin ndryshe, i përket liderit tipik për rrethanat aktuale dhe rrethanat që kushtëzojnë të ardhmen. Koha e liderëve pushtet (Shteti jam unë do të thoshte Luigji i XIV), është histori, ndërsa tani flet koha e liderëve që janë pushtet i institucionit dhe kjo duhet të jetë karakteristikë për këta liderë, koha e liderëve autokratik është e përfunduar, autokracizmi si formë e qeverisjes i takon plejadës së njerëzve që kanë hyrë në histori për të keq, përkundrazi koha e liderëve të rinj dhe modern sjell liderin apo lidershipin demokratik, pranues e jo imponues, tolerant dhe elitar, e joautoritarist dhe mediokër.

Koha e diletantizmit të mjerë të liderëve që prodhojnë kriza dhe luftëra ka përfunduar, edhe pse në nuanca hasen edhe të tillë që nuk mund të pajtohen me realitetin. Për shembull në Afrikë, në Ballkan dhe në vendet ku ka destabilitete, frustrime dhe probleme të natyrave të ndryshme, hasen liderë me sëmundjen e pashëruar të liderizmit që nënkupton, që njerëz të rëndomtë bëhen politikanë brenda natës, partiakë dhe militantë mediokër bëhen ministra, zëvendësministra, populistë të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, liderë provincialistë dhe krahinor, bajraktarë të fiseve primitive, është pasojë dhe reperkusion i totalitarizmave të llojit sui generis, që janë relikte të së kaluarës, por që pengojnë edhe të tanishmen, në rrugën drejt të ardhmes. Kjo kategori e njerëzve duhet të hiqet krejtësisht nga skena politike, sepse ENAF IS ENAF.

Karakteristikat e një lloji të liderit modern, të ndryshëm prej atij tradicional, kërkojnë një angazhim të këtij të parit për të sfiduar të dytin dhe rënien në kurth nga ai, sepse ky i pari duhet që të promovohet shumë përmes punës dhe norma edhe fjalëve, për t`u formuar, njohur dhe pranuar si i tillë. Edhe pse duhet shumë mund për t`u paraqitur, publikuar dhe pranuar, sepse ata gjithçka bëjnë vet, që nga produkti i tyre cilësor e deri tek prezantimi, promovimi dhe pranimi, ky lloj i liderëve modern janë modele kreativiteti, individualiteti me përplot sakrifica. Por, Danteja do të thoshte, "Rruga që të shpie kah lavdia, asnjëherë s`ka qenë e shtruar me lule" vlen për këtë lloj liderësh dhe lidershipësh modernë.

Lufta kryesore mes liderit modern që e shoqëron gjithashtu edhe karakteristika e guximit, krenarisë, si dhe vlerave të tjera të lartpërmendura, si dhe atij lideri tradicional, mund të definohet në luftën vlerë- antivlerë. Në Evropë për shembull, e më konkretisht në shtetet që kanë demokraci të konsoliduar dhe shoqëri të hapur ku vlen mendimi kritik dhe ai kreativ, konkurrenca nuk bëhet në mes këtyre dy lloje të modeleve të liderëve, po zhvillohet konkurrencë dhe garë në frymën vlerë- vlerë, ngase shoqëria e konsoliduar i ka në harresë reliktet e liderëve antivlerë. Konkurrenca e vlerave sjell përparim. Ndërsa lufta vlerë antivlerë nuk është kaherë përfituese për të parin, ngase ky i dyti i instaluar institucionalisht dhe i veshur me petkun demokratik, edhe pse herët a vonë del në sipërfaqe, sfidon të parin.

Lideri në mes tjerash duhet të ketë parasysh realitetet, traditat gjeopolitike, të ketë doktrinën e tij, të tregojë të kundërtën e doktrinës së oponentit të tij. Ky lider nuk duhet të shndërrohet në lider enigmatik ngase enigma do të thotë manipulim, fshehje nga ajo që je, respektivisht siç do të cilësohet nga shumë studiues pushtet i pamerituar dhe i keq i vlerësuar. Lideri dhe lidershipi nuk duhet të bëhen peng i idesë, po duhet të ndjekin kohën dhe tempon e zhvillimeve, në mënyrë që sa më shpejtë të ikë koha, ai të ngarende pas saj. Kur një lider kritikohet apo vlerësohet mëson t`i vlerësojë si duhet situatat dhe rrethanat politike, kur ndesh në fatkeqësi ai mëson të vërtetat e botës reale dhe objektive.

Jemi mësuar të dëgjojmë se kush pëson mëson, andaj pësimi nuk duhet të perceptohet si zhgënjim,

humbje dhe tërheqje, por përkundrazi të mëson të bëhesh i kujdesshëm, i hapur, stoik dhe prudent, apo i matur.

Beteja për të fituar postin e liderit të merituar, të lidershipit meritor, nuk do të thotë betejë rrugaçe,por betejë institucionesh, vlerash, doktrinash, si një lloj gare vrapimi, por me vlera e jo me forcë, edhe pse kjo e fundit nevojitet çdoherë.

Andaj secili që aspiron që të aderojë në botën e ashtuquajtur liderë duhet të ketë parasysh që të konsultohet me të mençurit dhe të diturit, si dhe t`i ketë ato aleatë të devotshëm. Lideri duhet të mësojë që edhe të japë dorëheqjen në momentin e duhur e jo të bëhet peng i karriges dhe i fronit, ngase dorëheqja është virtyt që lartëson një politikan, me kusht që ajo dorëheqje të jetë në çastin e duhur në mënyrë që të aprovohet nga elektorati dhe populli si meritë dhe si vlerë. Në politikë, ashti si edhe në gjitha fushat tjera asnjë nuk është ***eternelle,*** i përjetshëm, por veprat dhe idetë që i len pas janë të tilla. Lideri dhe lidershipi i duhur duhet të vlerësojë atë që i përshtatet së drejtës e më pas ajo çka është e drejtë, pra të kihet parasysh siç thoshte Kardinali Rishelje, ishudhëheqës i Francës, respektivisht kryeministër, i cili solli mpakte të fuqishme epokale, pra në politikë për të qenë lider duhet të vihet në rend të parë intelekti, arsyeja, nacionaliteti e më pas moralja.

Lideri që do të vuloset si lider i përshtatshëm dhe i pranuar nuk duhet të ketë revanshin pjesë të shpirtit të tij dhe politikës, por përkundrazi duke mos urryer dhe duke përbuzur tjetrin, ai duhet të tregohet jo i nxituar, por i matur të dijë të presë. Lideri që do të

arrijë të bëjë ekuilibrimin apo balancën mes militantëve apo turmave të nxehta dhe pushtetit është lloji i liderit që nevojitet sot në këtë kohë të "knowledge society", sepse interesat e këtyre dy palëve janë të kundërta dhe shpesh kundërthënëse.

Lideri i mirëfilltë, në bashkëpunim me ekipin duhet t`i shërbejë atdheut në çdo kohë, në çdo regjim, në çdo situatë, po duke mos futur hundët edhe aty ku nuk kërkohet prej tij.

Për në fund, thënia: ***"Nuk mbahet shtëpia me apo në një shtyllë"***, duhet të jetë udhërrëfyese për liderin, ngase edhe shteti, respektivisht pushteti nuk mbahet me një njeri, po me ekip. Kjo duhet të respektohet dhe pasur parasysh nga lideri bashkëkohor.

"Ce n`est pas l`époque de leaders, c`est l`époque de leadership", pra nuk është koha për liderë, po për lidership.

DILEMA E SHTETIT TË MAQEDONISË: RUSIZIM APO EVROPIANIZIM

Shteti i Maqedonisë, ky shtet i cili mezi po mbahet me këmbët e qelqta dhe të krisura që i ka, prej pavarësimit të tij e deri ën ditët e sotshme, po përballet me sfida të natyrave të ndryshme. Sfidat e këtij shteti, po i përjetojnë të gjithë qytetarët, po ata që më së shumti po i paguajnë janë shqiptarët. Pse e them këtë? Ngase ky shtet, qysh prej pavarësimit shumë të lehtë dhe të çuditshëm nga ish-Federata Jugosllave, i zënë peng nga politikanë dhe shtetarë me mendësi Kumroveci, në vend që të ofrohet drejt vlerave të mirëfillta evropiane dhe qytetëruese, ai edhe më tej zhytet dhe bëhet shtet model për Rusinë e Putinit. Këtë e ka dëshmuar dhe po e dëshmon edhe më tej. Me gjasë që do të dëshmojë edhe më tutje. Kjo u dëshmua me Ladorishtën. Vijoi me aferën e armëve. Kur u sajua e ashtuquajtura "Afera e armëve" shtetarët maqedonas menjëherë nxituan dhe fajësuan shqiptarët e këtij shteti pa më të voglin dyshim. Këtë e paguan shtrenjtë shumë qytetarë, po edhe disa politikanë. Mandej hiç më lehtë dhe shumë keq e përjetuan edhe qytetarët shqiptarë me rastin e Bit Pazarit, me rastin e hapjes së Universitetit të Tetovës, me rastin e kryengritjes së vitit 2001 me çrast u vrajtëns humë civilë shqiptarë të pafajshëm, me rastin e hezitimit maqedonas kundruall faktorit ndërkombëtar për shumë çështje, me rastin e kundërshtimit të ndërkombëtarëve, me rastin e Rakovecit të harruar dhe të Sopotit, me rastin e Brodecit dhe të Vaksincës, me rastin e

Radushës e shumë e shumë raste të tjera. Partitë politike shqiptare, nuk është që nuk duan që të ndihmojnë avancimin e çështjes shqiptare, po i mungon senzibilizimi i nevojshëm për të bërë këtë gjë, i mungon nisma dhe iniciativa vepruese, platforma e duhur para se të hyhet në qeveri. Këtë e shohim edhe tani, kur në 2008 me turr dhe pa kokë, faktori politik shqiptar në qeveri pa asnjë program çapitej i lodhur të ulet ne prehrin e Gruevskit dhe me këtë Gruevski të shter edhe një parti politike shqiptare. Grushtin e parë i`a dha PDSH-së, me ç`rast tronditi këtë parti me Brodecin si dhe me çarjen që ia shkaktoi, përmes fraksionimit dhe nxitjes së formimit të partisë të ashtuquajtur DR, e cila në asnjë rast nuk dëshmoi se është parti që mbron shqiptarët (përjashtim bën këtu vetëm deputeti i kësaj partie Abedin Zymberi), po përkundrazi në momentet kur duhej të vinte në shprehje nacionalizmi i saj, ajo bëhej më kozmopolite se edhe partitë liberale evropiane, duke dëshmuar se vepron si filiale e VMRO-DPMNE-së. PDSH-ja edhe më tej mbeti në terr informativ, duke mos i`u dhënë hapësirë aspak, për të performuar, duke e lënë në bllokadë totale këtë parti. Partitë tjera shqiptare të margjinalizuara skajshmërisht, u anatemuan aq shumë, saqë të krijojnë përshtypjen se veprojnë si parti individësh dhe jo si parti të qytetarëve. Pra, qeveritarët maqedonas përmes shkollës së Putinit, dëshmuan se janë mjaft të suksesshme në drejtim të shterjes dhe venitjes së partive politike shqiptare. Ata përmes metodës së rusizimit të çdo pore të jetës në Maqedoni, po dëshmojnë se nuk janë për evropianizim të Maqedonisë. Divergjencat e këtyre shtetarëve me ndërkombëtarët që shpëtuan këtë shtet nga

kolapset e ndryshme që i vinin si valët e detit që përplasin anijet, dëshmojnë rusizimin e Maqedonisë. Antikizimi i Maqedonisë, vjedhja e historisë shqiptare (pellazgo- ilire) dhe asaj helene, tregon se ky shtet nuk meriton të jetë në hartën e Evropës, po komshi me Rusinë e Putinit. Vizitat e kreut shtetëror serb, të dalluar për shovinizëm dhe nacionalizëm, që promovojnë politikë të mbrapshtë rajonale anti-amerikane dhe anti-evropiane, po dëshmojnë se ku dhe kah e ka "***kiblën***" ky shtet. Shpalosja e projekteve anti-perëndimore, që po promovohet këtyre ditëve, e që mëton që pas JO-së së prerë evropiane, të kulmojë me protesta anti-evropiane po tregon fytyrën e vërtetë të këtij shteti dhe të qeveritarëve maqedonas. Kjo JO, do të thellojë Maqedoninë e leckosur edhe më tutje në varfëri dhe në destabilitet. Kjo qeveri që po mbahet më shumë me infuzionet ndërkombëtare si dhe BDI-së, e cila vazhdimisht po "shpëton" këtë shtet me promovimin dhe me (mos)implementimin e marrëveshjes së vdekur dhe varrosur të Ohrit, do të na shpie në një pasiguri dhe animozitet total. Moroziteti dhe dëshpërimi i qytetarëve do të kulmojë me të panjohura, sepse i ka ardhur secilit te hunda. Shpëtimi dihet. Largim i kësaj konjukture qeveritare nga skena politike, anatemim dhe dënim për këtë ndjekje të kësaj politike, përmes protestave, manifestimeve dhe demonstratave që duhet të organizohen nga partitë opozitare dhe lëvizjet qytetare, me përkrahjen ndërkombëtare. Edhe z. Fuere, eurodiplomati i spikatur, shihet që është mjaft i zhgënjyer me këtë politikë të mbrapshtë. Pajë, kush nuk mbeti i pazhgënjyer? Të gjithë. Në përjashtim të disa strukturave të ngushta dhe të vogla qeverisëse të BDI-së

dhe shumicës së VMRO-DPMNE-së. Qytetarët e këtij shteti, po edhe faktori ndërkombëtar po shohin fytyrën e vërtetë të kësaj qeverie të mbrapshtë, që është shndërruar në qeveri të llojit të Putinit dhe që po putinizon dhe po bën rusizimin e Maqedonisë. Zgjedhja është kjo. Braktisje e qeverisë nga ana e faktorit politik shqiptar, mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme, e në rast të fitimit të zgjedhjeve përsëri nga VMRO-DPMNE-ja, ofrim i alternativave për avancim të shqiptarëve, e nëse kjo e fundit refuzohet përsëri, atëherë edhe shqiptarët nuk duhet të qëndrojnë duarkryq e të bëjnë sehir, se si anatemohen dhe margjinalizohen skajshmërisht, po hapje të letrave dhe alternativave të tjera, siç mund të jenë: shpallje të Parlamentit paralel dhe institucioneve paralele në këtë shtet, kërkesë për federalizim. Kjo vetëm kërkohet nga disa parti politike shqiptare siç janë: PDSH-ja, BDSH-ja si dhe BDK-ja, po e njëjta duhet të legjitimohet me votën e popullit shqiptarë në Maqedoni. Kjo do të pengonte rusizimin e mëtutjeshëm të Maqedonisë dhe përshpejtimin e oksidentalizimit dhe evropianizimit të këtij shteti.

MBRESAT E NJË VIZITE TË PAHARRUAR (NË KULLËN E JASHARAJVE)

Ditë e zakonshme qershori. Edhe pse në dukje më dukej se ishte ditë e tillë, nuk e dija që ajo ditë e datës 12 qershor, dita e përvjetorit të largimit të trupave serbe nga Kosova, do të më mbetej e vulosur çdoherë në zemrën time dhe në kujtimet e mija. Ashtu disi pa menduar thellë, vendosa të shkoj në Prekaz të Kosovës martire, t`a vizitoja vendin që u shndërrua në simbol rezistence dhe në emblemë të shqiptarisë. Për të shkuar deri atje m`u desh që të kaloj ca kufi improvizues, të vendosur fatkeqësisht në dëm të shqiptarëve padrejtësisht, në Marrëveshjet e Berlinit, Londrës, Versajës, Jaltës... Mu deshtë që të kaloja kufijtë që në të gjitha anët janë të banuara me shqiptarë, por që kontrollohen nga të tjerë. Përshëndetjen e parë ***"Dobro jutro" Mirëmëngjesi***, e fillova në gjuhën maqedonase. Thonë që sa më shumë gjuhë flet, aq më shumë vlen. Pajë, le të jetë kështu. Atëherë, po vlejsha sadopak. Po nuk e dija se në cilën gjuhë po flisja, ngase kjo gjuhë ende nuk është e definuar si duhet, se si do të jetë: sllavomaqedonase, maqedonase apo maqedonasoveriore... këtë do e dëshmojë koha. Pra, e kalova këtë kufij, duke u ndier i dëshpëruar, pse edhe pas sa viteve ***"demokraci"***, përplot sfida, kryengritje të vitit 2001, ende më duhej të përshëndetesha në gjuhën maqedonase, në një kufi të një shteti të kontestuar gjithandej, në një zonë të kufizuar në të gjitha anët, kryesisht me shumicë absolute shqiptare. E gjithë kjo ngase politikanët shqiptarë të këtij

shteti, ende nuk arritën ta jetësojnë si duhet përdorimin e gjuhës shqipe në nivel shtetëror, apo nuk arritën ta zyrtarizojnë si duhet. Shkaqet dihen. Në pjesën tjetër të kufirit me Preshevën, mu deshtë prapë të përshëndetesha në gjuhën serbe, (shumë e ngjashme me këtë të parën, e thuaja pa asnjë dallim). E prapë thash vet me vete: ***"e sa ta ngjashme janë, si ngjajnë si veja vezë".*** Po, u dëshpërova ngase edhe aty nuk pash dhe nuk dëgjova fjalë shqip, ngase Marrëveshja e harruar dhe e vdekur e Konçulit nuk ishte aspak funksionale, ishte varrosur, bile as varri nuk i dihej. Të paktën, kësaj Marrëveshjes sonë, pra Marrëveshjes së Ohrit, po i dihet varri, e asaj të Konçulit as varri nuk i dihej. Prapë, andej kufirit zona me shumicë absolute shqiptare, e ndarë padrejtësisht nga ata që ndajnë e ç'ndajnë. Kalova nëpër Preshevën e harruar nga të gjithë, ku përpos kafeneve dhe shqiptarëve me duar ne xhepa dhe flamurit serb, nuk pash asgjë. Kështu arrita në kufirin tjetër. Në kufirin formal, po hermetikisht të kontrolluar nga xhandarmëria serbe, u ndala në kufirin administrativ Kosovë-Kosovë Lindore, (disa thonë Luginë e Preshevës), e në fakt Koço Danaj do të thoshte me plot të drejtë, kufiri Shqipëri- Shqipëri, e mu deshtë prapë, edhe aty të përshëndetesha në gjuhën serbe. Kaluam disi kufirin, duke shpresuar se në kufirin e shtetit ahtisarian të Kosovës, do të përshëndetesha shqip. Po, shqetësimi dhe zhgënjimi më i madh më ndodhi mu aty, ngase edhe aty më erdhi përshëndetja ***"Dobar dan"*** si një goditje rrufeje. I`a ktheva me Mirdita në shqip. Ai vazhdoi prapë kërkimin e dokumentacionit në gjuhën e tij, serbe. E u habita tej mase, ngase mendova mos jam diku

në Kraguevc, apo në ndonjë zonë të Zemunit. E po thash, vet me vete. Pse, mos të flas ky serbisht. I` a mundëson kushtetuta, ligjet dhe pakoja e Ahtisarit, edhe pse është kolonizatorë në këto treva dhe nuk përbën më shumë se 3-4 përqind të popullatës. E ka gjuhën të zyrtarizuar si duhet, tipike për një shtet si Kosova e Ahtisarit, shtet të komuniteteve, shtet me shoqëri multietnike. Kurse, përnjëherë bëra krahasimin me shtetin tim të brishtë, Maqedoninë e çudirave, ku edhe pse jemi shumicë, konsiderohemi *de jure* si pakicë, e trajtohemi *de facto* si inekzistent. Dhe, shtrova pyetjen, se çka fituam ne, me kryengritjet e pambaruara si duhet?! Shumë pak. Vazhdova rrugëtimin tim, duke u ndier i zhgënjyer për këtë realitet të hidhur. Arrita në fshatin Pasjan, fshat me shumicë serbe, ku përpos derrave, plakave dhe pleqve, nuk pashë asgjë tjetër. Valëvitej sikurse flamuri nazist, flamuri i Serbisë, me katër shkronjat –ES (C), prapë e mbarë (Samo sloga spasi srbima). E u zhgënjeva edhe më shumë ngase, nuk kisha mundësinë ta valëvitja lirshëm flamurin tim, kuq e zi, në vendin tim nga vija, nga Kumanova, e këtu këta të tjerët, po. Vazhdova, rrugën duke hyrë në Gjilan, qytetin e bukur, ku bëja dallimin mes Gjilanit të viti 1997 dhe atij të 2010. Nuk e harroj kurrë një përmendore të Vuk Karaxhiqit, apo e ndonjë viqi tjetër (saktësisht nuk e dijë), në Gjilan që rrinte si monstër, e tani ajo nuk ishte më, ishte hequr pikërisht më 12 qershor të 1999, 2 vjet pas vizitës time të parë të këtij qyteti. E atë ditë, (çuditërisht dhe aksidentalisht ishte përvjetori i vizitës time të parë në Gjilan, si dhe i largimit të forcave serbe nga Kosova), atë bust nuk e pash, menjëherë fillova të frymojë më lirshëm.

Vështroja në të gjitha anët flamurin kuq e zi, po ndokund edhe atë të Pakos ahtisariane si dhe flamuj partiak, edhe pse në raritet. E mendoja, e shqiptarë e shqiptarë, me përplot flamuj, partiak, shtetëror, krahinor, mëhallore..., vetëm një flamur si duhet, atë kombëtar. Duke vazhduar rrugën, më vriste syrin varfëria e kësaj ane, mungesa e investimeve, rrugët përplot me gropa dhe të parregulluara, rrugë këto të ndërtuara gjatë qeverisjes së Titos, atëherë kur gjithandej "mbisundonte mirëqenia" që të hante shpirtin sikur krimb, dalëngadalë, e pak para se të arrija në Prishtinë, arrita në Graçanicë, komunën serbe, ku kjo komunë shfaqej më serbe se Serbia vet, me pamflete të kryekriminelit Sheshel, si dhe të kriminelëve tjerë. Më ngjau sikur bëra udhëtim nëpër kohë, sikurse u ktheva në vitin 1997, kur pata kaluar për të parën herë andej, po jo, realiteti ishte ndryshe, ishte viti 2010. Asnjë gjurmë shqipe nuk pashë aty. Në mes të rrugës së kësaj komune gjendej Kisha ortodokse që ruhej nga ushtarët e KFORI-t, thuaja se do të sulmohej nga ndokush. Të paktën shqiptarët është dëshmuar se nuk sulmojnë objekte fetare kurrë, atë e bëjnë serbët. E mendoja, e kjo kishë që në fakt duhej të ishte e jona, sepse na është vjedhur nga serbët, e ata tani e "ruajnë" nga ne. Shqiptarët edhe pse shumicë myslimane, kurrë nuk kanë shfaqur ksenofobi ndaj objekteve fetare, sepse ne nuk kemi pasur kurrë Shën Bartolomej, apo nuk e kemi të njësuar fenë (lexo: fetë) me kombin. Pas pak çastesh arrita në Prishtinën, që ndërtohej e ç'ndërtohej, me (pa)leje. Objekte të mëdha që mbinin sikur kërpudha nga të gjitha anët, dendshmëri e madhe e popullatës, shumë vetura, shumë njerëz, thuaja e

gjithë Kosova shqiptare ishte aty. Mezi se arrita të dilja nga ai *"traffic jam"* angl., ose nga ai *"embouteillage", frengj.*), shqip nga ajo ***ngarkesë komunikacioni.*** Sytë më rastisën drejt e në flamurin e madh të Ahtisarit, i cili, kurrë nuk u pranua nga shqiptarët e këtij shteti, po ja që ishte *modus* i arbitrazhit ndërkombëtar, e na u servua dhe ne e gëlltitëm. Mezi arrita te miku im, Q.P. Nëpër kryeqytetin e Kosovës, (lexo Prishtinën metropol), me rrugët e saja të shkapërderdhura, u futa në një lagje të Prishtinës, e cila çuditërisht ngjante sikur ndonjë zonë malore, pa asfalt. E mora mikun tim, duke rënkuar për shkak të mos rregullimit të rrugëve, mos investimit të duhur në rrugë, e në anën tjetër bëja llogarinë vet me vete, e më dilte se në Kosovë shumë personel ndërkombëtar ka, saqë estimohet se ai personel bën harxhime ndokund 1 milionë euro në ditë. Ah, sikur të shfrytëzohej ajo shumë për rregullim të rrugëve. Atëherë do të vlente thënia, "***Një shtet mburret me rrugët e mira, tjetri me njerëzit e mirë, tjetri me ligjet e mira. Shteti i mirë i ka të trija".*** Kosova, si shtet i kishte njerëzit e mirë, po jo edhe ligjet, sepse ata ligje nuk e kishin burimin në kushtetutën e gatuar nga populli, po në kushtetutën e Ahtisarit. Mandej ligje kishte shumë, po ata ligje lypsej që të zbatoheshin, kur të plotësohen shumë gjëra të tjera, kur Kosova do të pastrohej nga zyrtarët e korruptuar ndërkombëtarë, që nuk bëjnë asgjë, përpos shëtitjes dhe sorollatjes poshtë e përpjetë me xhipat e tyre 4*4, Grand Sheeroke..., atëherë kur Kosova nuk do të ishte ***kondominium,*** (qeverisje e një territori nga më shumë subjekte, lexo Kosova qeveriste nga UNMIK, EULEX, nga Serbia, posaçërisht komunat serbe dhe nga

shqiptarët). Këtë model nuk e ke askund në botë. Kosova është shtet *sui generis,* me të drejtë mund të thuhet kjo.

Vazhdova rrugën duke hasur në pluhurin e rrugëve që ndërtoheshin me shpejtësi breshke, e destinacioni im ishte Prekazi. Deri para se të kaloja Fushë Kosovën, vërejsha aty- këtu edhe flamujt e kaltër të çuditshëm, pa asnjë gjurmë shqiptare, e konkludoja vetë me vete, se përpjekja e Ibrahim Rugovës u "kurorëzua" me sukses. Ai më përpara pat propozuar një flamur të tijin, "kombëtar", që u pat flakur nga qytetet e Kosovës, me eufori, nga njerëzit e partisë shqiptare aktuale në shtetin pa pushtet të Kosovës (pra, nga njerëzit e PDK-së). E tani, ai flamuri i Rugovës më dukej shumë më i mirë në krahasim me këtë të fundit, edhe pse asnjëri nuk kishin të bëjnë me atë të vërtetin, me atë për të cilin është sakrifikuar me shekuj. Dhe menjëherë, më shkoi ndërmend teoria e disa analistëve servil nga vendi im, si dhe nga Kosova, që promovonin *kombin politik,* e kësisoj tentonin fragmentarizmin e identitetit shqiptarë, edhe ashtu të çorientuar. Modeli i shteti- komb në Kosovë me sa duket kishte filluar të sfidonte identitetin e formësuar shqiptarë me shekuj. E unë edhe pse isha koshient se epoka e krijimit të shteteve ende nuk kishte përfunduar, shpresoja se epoka e *nation building* të kishte përfunduar. Për mua po, po edhe për shumë shqiptarë të tjerë, po jo edhe për Migjenin e Vogël të Lulit të Madh, jo për Nexhmedinin e mëhallës së Mitrovicës, që i kishte mbetur qyteti i lindjes Mitrovica, e ndarë si kufiri koreano- jugor me atë verior, e tani ai merrej me *nation building* të kombit kosovar, (sajesë sllave), jo për Halil

Matoshin dhe për nacionalizmin e tij etatik dhe për qëndrimin e tij prej një llastiku, e ndoshta edhe për të tjerë shpezë si këta.

Dalëngadalë duke i`u afruar Drenicës trime, shikoja vetëm flamujt shqiptarë, me shqiponjën dykrenore, që më dukej më e bukur se kurrë. Arritëm në fshatin i cili do të mbetet emblemë dhe simbol i shqiptarizmës, në fshatin bastion të rezistencës shekullore shqiptare, në vendin e Shaban Polluzhës, në vendin e Tahir Mehës, Ahmet Delisë, ... për të ardhur më në fund te kryetrimi shqiptarë, Adem Jashari, respektivisht te kullat e Jasharajve, *kibla kombëtare gjithëshqiptare*. Aty fryma mu ndal. Nuk mund ta përshkruaj me fjalë, ngase vetëm shpirti di të përjetojë asi gjëra të pashpjeguara dhe të papërshkruara. U stepa në vend. Nuk më

pengonte as dielli që përvëlonte, e as lodhja nga vozitja me veturë e rrugës, jo edhe të shkurtër, Kumanovë-Prekaz. Harrova gjithçka. Sytë më mbetën tek varrezat impozante që flitnin, po po, ata flitnin për ata që kanë vesh dhe mendje. Fliste varri i Ademit, Hamzës,... i 53 dëshmorëve, i mijëra dëshmorëve, zëri kumbues i historisë shqiptare, zëri i lirisë, zëri i së vërtetës, zëri autentik i një heroi. Shihja dhe ndjeja luftën e tij të bërë, përjetoja rezistencën e tij, dëgjoja këngën e tij në momentet e vdekjes, shihja kufoma çetnikësh e barbarësh të vrarë rreth e përqark. Dëgjoja kushtrimin e lirisë dërguar shqiptarëve gjetiu nëpër botë. Dëgjoja kushtrimin për unitet kombëtar, për luftë kombëtare, nën flamurin kombëtar me shqiponjën në mes, e jo me ato yjtë dhe hartën e Kosovës shumetnike joshqiptare. Dëgjoja thirrjen e tij drejtuar qeveritarëve të kaluar, aktual dhe atyre që do të vijnë, që të mos lëshojnë pe para presioneve të çfarë do qoftë qofshin ato, në dëm të çështjes dhe kauzës kombëtare.

Pas nderimit të bërë para varrit të kryetrimit dhe varreve të trimave të tjerë, u ngjita me miqtë, shpatit përpjetë për të parë nga afër bunkerin e kësaj legjende të legjendave. U impresionova shumë nga aftësia dhe strategjitë e tij ushtarake, nga guximi i pashoq, ku vetëm ca metra më tutje kishte pasur Fabrikën e Municionit serb dhe një numër të madh çetnikësh, paramilitarësh dhe policësh serb, që paraqiteshin si hiena të çoroditura. Sa herë që kishin tentuar t`i ofrohen këtyre kullave bishat e egra, kryetrimi me të vëllanë i kishte stopuar.

E më në fund, Davidi kundër Goliathit. Por Goliathët ishin të shumtë, e Davidi, një, dy.... Duke luftuar dhe kënduar kishte dhënë shpirtin e tij të ëmbël, për t`i kënduar më pastaj këngëtari i shquar shqiptar, Ilir Shaqiri këngën, ***"Hapuni o dyer të xhenetit".*** Me të vërtetë këto dyer u hapën, ngase edhe ne, banorët e kësaj bote e dëgjuam hapjen e këtyre dyerve për këtë kryetrim, për këtë njeri, ikonë të burrërisë dhe guximit shqiptar. Pajë, sikur mos të kishte kësi lloj burrash, ç`më duhej të jetoja, frymoja dhe flisja shqip? Dhe me të vërtetë nga impresionimi im prej kryeheroit dhe veprës së tij, u detyrova të bëj klasifikimin e heronjve në dy grupe: Ademin (lexo: Jasharin dhe Jasharajt) dhe të tjerët.

Pas vizitës së bunkerit të tij improvizues, e shihja kryetrimin Jashari me familjarët duke luftuar me bishat e egra, sikurse të shihja filmin e zhanrit, *Action*, Rambo III, ku protagonisti luftonte kundër hordhive ruse në Afganistan. Po, ama ai ishte vetëm film. E kjo imagjinata ime, ishte film i vërtetë, që kishte ndodhur, po që më parafytyrohej, nuk e di se pse, e më bënte që ti shihja storiet dhe veprimet e Ademit, për së gjalli. Pa mëdyshje vazhdova me miqtë e mi, rrugën drejt librarisë, ku kishte mjaft libra për kryetrimin (kryetrimat) duke blerë ca libra, paratë e të cilave dedikoheshin për ndërtimin e Kompleksit Memorial "Adem Jashari". Pas fotografive të ndryshme të bëra nga unë, gati se çdo drenicak që takoja, më ngjante në Ademin, e thash vet me vete, ***"O Zot, sa Adema paska kjo tokë. Po, përse janë grumbulluar të gjithë vetëm me një vend, e nuk shpërndahen gjetiu nëpër Kosovë dhe troje tjera shqiptare? Po, ama Drenica dhe Prekazi kishin ndikuar që të lindnin të gjithë Adema."*** E ç`ti bësh, se kemi vetëm një Drenicë?

Pas shpjegimeve të thukta, të prera dhe të thurura me mjeshtri nga ana e Ciceronit, hapëruam drejt shtëpive muze, drejt kalasë së pamposhtur të Jasharajve. Më dilnin skenat që i kisha parë si fëmijë kur isha në klasën e tetë të shkollës fillore në vitin jo fort të largët 1998, si dhe shtëpitë e djegura, traktori i kaltër i djegur dhe i lënë aty, e që kishin mbetur po në të njëjtin vend, për t`i dëshmuar brezave, si dhe atyre që mund të "harrojnë" rastësisht për luftën e një njeriu, që nuk i`a gjen shoqin askund në botë. Dhe pas disa diskutimeve dhe bisedave vëllazërore, vazhduam agjendën tonë të takimit me vëllanë e kryetrimit dhe trimave të tjerë, bacën Rifat, njeriun që më së shumti e din, se si është të jesh vëllai i një "INVICTUSI", i një legjende që nuk e shpjegon dot historia. Pas ngjitjes në dhomën e pritjes, aty ku më shfaqeshin para syve skenat me Ademin me Hamzën, si dhe bisedat e tyre me nënën Salë, simbolikën e nënës shqiptare, u ulëm të gjithë këmbë kryq dhe i`a filluam bisedës. Nuk e di, po kisha përshtypjen, se flitja me Ademin vet, me Hamzën vet, dhe me gjithë ata trima të lirisë. Pas shkëmbimit të batutave, buzëqeshjeve të herë-pashershme, pas pirjes së ujit, mund ta them lirisht se ndihesha më i lumturi në botë, në ato momente, ngase pija ujin e familjes, e cila është emblemë e shqiptarisë. Më linin përshtypje mustaqet e bacës Rifat, gjenerozitetі i tij, pasuria e tij shpirtërore, këshillat e tij dhe fjala e tij që do të më mbetet gjithmonë në zemër : *"Shkau (lexo: serbi) na ka vra, na ka djeg, na ka përdhunuar motrat, gratë, nënat dhe bijat tona. Ne nuk duhet ta harrojmë këtë. Ata janë të njëjtët. Po, ama dikush ka filluar t`i harrojë këto. Pse, sepse me siguri nuk është djegur. Po, mos harroni o vllazën, se nëse është përdhunuar një shqiptare, ajo është motra jonë, shkau*

*nuk ka mund të arrijë tek të gjithë shqiptaret tjera, nëse është masakruar një shqiptar, ai është vëllai i jonë, ngase shkau ka pas dëshirë t`i vrasë gjithë, po nuk ka mundur, nuk i erdhi radha. Andaj vëllazën të jemi të bashkuar e mos të ndahemi."* Këto fjalë më mbetën dhe m`u ngulitën thellë në mendje dhe zemër, ngase ka ca shqiptarë që flasin shqip, po që ende dëgjojnë muzikën e Cecës, Draganës, Bojaniqit, Bregoviçit, (ky i fundit bile u shpërblye në mes të Tiranës nga Edi Rama) apo të ndonjë Lepa Brene serbe (kjo më ka rastisur disa herë në qytetin e Tetovës, po edhe në vende të tjera nga taksistë të ndryshëm), që përjetojnë orgazëm nga *turbo folku* serb, protagonistët e së cilës muzikë bënin thirrje për krime ndaj shqiptarëve në Kosovë. Këta mjeranë do t`i mallkojë historia dhe gjiri i nënës shqiptare.

Në anën tjetër më bëhej zemra mal, kur shihja bacën Rifat duke buzëqeshur, i lumtur dhe krenar për historinë e kësaj familje, më pëlqeu shumë batuta e tij dhe e prindit tim, që filluan të më përqeshin mua dhe Murat Jasharin (të birin e bacës Rifat), për titullin akademik, *Magjistër.* Baca Rifat përsëriste vazhdimisht fjalët që i`a kishte drejtuar Muratit, e kësisoj m`i përsëriste indirekt edhe mua, e babait tim zemra i bëhej mal dhe afirmonte me kokë atë që thoshte baca Rifat, *" Ju mund të jeni magjistra në Prishtinë, po ama magjistër në Prekaz jam unë"*. Pas të qeshurave të këndshme, shkoqitëm shumë tema, prekëm shumë elemente, përmendëm shumë ndodhi, normalisht, duke e dëgjuar me vëmendje bacën Rifat dhe këshillat e tij. Erdhi momenti për të dalë dhe për tu kthyer nga kishim ardhur. Në të dalë i dhurova bacës Rifat, dy librat e mi, ca libra të tjerë të mikut tim që më shoqëronte, z. Q.P., e falënderuam për

mikpritjen e ngrohtë shqiptare. Duke dalë në oborr, vërejta shumë fëmijë (në fakt ata ishin të gjithë Jasharaj), mu bë zemra mal, që gjenerata e re e kësaj familje kishte ripërtëri emrat e heronjve dhe kishte vazhduar qenësimin dhe edukimin në frymën e njëjtë patriotike.

Pasi u përshëndetëm me familjarët, me Muratin dhe bacën Rifat, duke shpresuar në takime të tjera, në të dalë prej kullës së kësaj familje gjigante mu kujtuan fjalët e Ministrit të jashtëm të Francës, z. Bernard Kushner, në kohën kur ishte kryeadministrator i Kosovës, ***"Po të kishte çmim Nobel për luftë, kjo do t`i takonte Adem Jasharit me familje".*** Dhe kishte pasur të drejtë, miku i shqiptarëve, z. Kushner. Përnjëherë më shkoi ndërmend edhe tentativa e disa figurave të ndryshme politike, disa të ndjerë e disa gjallë të djerrë, që tentonin në fillim të anatemonin këtë luftë dhe figurën e madhe të Adem Jasharit. Më irritoi tej mase mungesa e guximit për t`u bërë tok, për të ardhur dhe për t`u përulur para varrit të kryetrimit legjendar, (lexo: kjo atyre do t`i shërbente si *katarsë* për shkak të takimeve që patën me kryekriminelin Millosheviq dhe me kryekriminelët tjerë), kjo do t`i shpëtonte ata nga të qenit fajtor për politikën e dështuar "pacifiste" dhe tentativat për të ndërtuar shtetin e pavarur të Kosovës, të hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë. Pra, imagjinoni Kosovën e hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë. Ajo është e mbyllur sot ndaj Shqipërisë, e hapur ndaj Serbisë, sepse sa herë që duan kriminelë të ndryshëm serb si dhe pushtetarë serb, vizitojnë Kosovën dhe e pagëzojnë si djepin e serbizimit, e në anën tjetër një iniciativë për unifikim të abetareve, plan-programeve, me Shqipërinë nuk është ngritur ende institucionalisht. Ja, thosha vet me vete çka

na solli politika e atyre njerëzve *shpezë të qyqes*, që propagandonin thënien se Kosova duhet të jetë e hapur ndaj Serbisë dhe Shqipërisë. Po, fatmirësisht që PERËNDIA dërgon shumë rrallë njerëz si Ademi dhe të tjerët, por që ndryshojnë histori për 100 vjet. Të shpresojmë se Kosova do të gëzohet e tëra, si Drenica, atëherë kur do të ketë të plotë sovranitetin ndaj gjithë territorit, atëherë kur Mitrovica nuk do të jetë e pagëzuar *"Dy Mitrovicat"*, atëherë kur shqiptarët e Kosovës nuk do të jenë të (keq)qeverisur nga shumëkush e askush, atëherë kur shqiptarët do të jenë mes veti pa kufij, të caktuar nga fuqitë e Mëdha padrejtësisht, kufij këto të formalizuar edhe nga politikanët shqiptarë, që më shumë krenohen të jenë të parët në katund, se të tretët në Shqipërinë tok.

Dhe, i mbushur mirë me frymëzim, pas përshëndetjeve të bëra me drenicakët e fundit që i takova para se të hyja në veturë për t`u kthyer, me këta trima që takova rastësisht, më mbeti thellë në mendje dhe shpirt thënia e një drenicaku, që e njoftova po që nuk do të ja përmendi emrin: "Ne e kryem misionin tonë, atë të çlirimit të Drenicës, këtu nuk ka asnjë bishë të egër kriminelë, por misioni ende nuk është përfunduar. Ky mision përfundohet kur Kosova do të jetë shtet i shqiptarëve të Kosovës, e jo shtet i bashkësive dhe i komuniteteve në Kosovë, atëherë kur Kosova do të frenojë të folurit "kosovarçe", dhe do të promovojë të folurit shqip, sipas standardeve të vitit 1972, atëherë kur nëpër institucionet shqiptare të Kosovës, do të shkruhet dhe flitet shqip dhe anglisht (lexo: si gjuhë ndërkombëtare), e gjuha serbe do të përdoret vetëm në Serbi dhe nëpër shtëpitë e serbëve të ndershëm, që mund të jetojnë të lirë në

Kosovë.” Ky mision do të përfundojë atëherë kur do të mendojmë NJË, kur do të dimë të zhvillojmë politikë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare vetëm duke qenë NJË TOK, e jo kështu të përçarë si jemi, nga politikanët e sotshëm, që nuk morën asnjë mesazh nga lufta çlirimtare e Ademit dhe të tjerëve, të cilëve sa herë që ju duhen vota dhe thurje elozhe, vizitojnë këtë familje. Fatmirësisht unë nuk jam politikan, sepse kjo që thash do të vlente edhe për mua. Andaj pas përshëndetjeve vëllazërore mora rrugën nga kisha ardhur, për të kaluar në metamorfozën e çuditshme të ndjenjave të mija, sepse nga një frymëzim dhe nga një rehabilitim shpirtëror, kalova në depresion, me të arritur në Prishtinë, kur dëgjova lajmin e burgosjes së Albin Kurtit, simbolit të rezistencës shqiptare në Kosovë, njeriut të papërkulur para shantazheve dhe presioneve aktuale. Rrugëtimi im ishte i njëjtë, nëpër të njëjtët vende, me të njëjtat ndjenja që i mora, edhe gjatë shkuarjes, sepse u përsërit e njëjta, gjatë **ALLER –RETOURIT** tim. Po përderisa prapë zhgënjehesha me kthimin tim në Kumanovë, në anën tjetër isha i qetë shpirtërisht që pata mundësinë të takoja shtyllën e familjes shëmbëlltyrë të shqiptarëve, që pata rastin të vizitoja vendet si Drenica dhe Prekazi (lexo: që më ngjanë më Shqipëri se Shqipëria e 1912, pra kjo e sotshmja), si dhe të njoftohesha për së afërmi dhe t`a përjetoja ndjenjën e të qenit në të njëjtin vend, ku ka shkelur edhe kryetrimi shqiptar i gjitha kohërave, Adem Jashari. Dhe me të vërtetë u binda se është vështirë të jesh burrë me vepra, sepse me fjalë është shumë lehtë. Ngase mirë thonë në Kurvelesh të Shqipërisë (Kjo krahinë shtrihet midis Lumit të Shushicës dhe ***atij të Borshit në Perëndim të Vjosës në Veri e Verilindje dhe të***

Kardhiqit në Jug). : "Burri një herë ka lerë, një herë do të vdesë". Kjo vlen për të gjithë heronjtë shqiptarë, me në krye kryetrimin e legjendave, Adem Jasharin.

UEJL- PROJEKT I MADH KOMBËTAR I SHQIPTARËVE NË MAQEDONI DHE REZULTAT I POLITIKËS SË MENÇUR TË ARBËR XHAFERIT

I nderuar auditor. Përderisa po i shkruaj këto rreshta, më sillen nëpër mend sfidat me të cilat u ballafaquan shqiptarët e këtij vendi të quajtur Maqedoni, për të finalizuar një projekt të tyrin mbarëkombëtar, që do të përfshinte aspektin e arsimit sipëror, projekt ky i cili falë kokave të mençura të asaj kohe me në krye z. Arbër Xhaferin dhe udhëheqësit e tjerë të PDSH-së, do të bëhej realitet dhe do të rritej dalëngadalë sikur foshnja e bukur e porsalindur, e do të arrinte deri në ditët e sotshme, që të bëhej shëmbëlltyrë e arsimit të lartë shqip në Maqedoni. Ky projekt që në dukje dukej ndërkombëtar, ishte kryekëput kombëtar ngase u hap si një rreze shprese për shqiptarët e Maqedonisë, për të ndjekur dhe vijuar mësimet nëpër fakultetet e tyre përkatëse, për të dëshmuar para botës se jemi popull perëndimor me vlera ta mëdha që dimë të veprojmë si duhet nëse na jepet mundësia. Në fillim të realizimit të këtij projekti gjigant, nuk pushuan gojët e liga me përpjekjet e tyre për t`a përbaltur dhe njollosur këtë Universitet- tempull të diturisë, për të çapitur më pas të njëjtit, të marrin orë dhe të bëhen pjesë e stafit akademik apo administrativ të këtij Universiteti. Kishte edhe akuza e shpifje të pakripura, që gjoja ky Universitet na qenka i kësaj apo i asaj partie (mëtohej në PDSH-në e A. Xhaferit, tani të Menduh Thaçit) e në fakt nuk ishte aspak ashtu, ngase

shumica e profesorëve universitarë që punonin dhe punojnë aty, i takojnë proveniencave të ndryshme politike, e nuk kishin të bënin asgjë me partinë e A. Xhaferit dhe të Thaçit. Ata ishin punësuar aty duke u bazuar vetëm në vlerat e tyre intelektuale që i posedonin, e jo në përkatësinë politike apo partiake. Këtë që e them nuk mund të e demantoj askush, ngase faktet flasin dhe konfirmojnë këtë që e them. Pa mos dashur të futem në kurthet e përmendjes së emrave, do të kursehem për shkak të etikës, UEJL hapi dyert për të gjithë studentët shqiptarë anembanë trojeve shqiptare, si një institucion shëmbëlltyrë, si një institucion me një performancë të shkëlqyer evropiane dhe amerikane, si një institucion me nam e nishan që do të fuste studentin dhe mësimdhënësin shqiptar në shoqërinë e dijes (knowledge society), si një institucion ku do të respektohej mendimi ndryshe, ku do të mundeshin të studionin edhe studentë të komuniteteve tjera, si një institucion ku shqiptari i ditur do të bëhej udhëheqës, si një institucion ku vlerat janë në konkurrencë permanente dhe ku fiton si çdoherë më i miri....

Gojëligët që po paraqiten kohën e fundit, në vazhdën e gojëligëve që shpifnin dhe etiketonin pa nevojë dhe pa fije turpi edhe atëherë kur edhe u hap ky tempull i diturisë, nuk mëtojnë asgjë tjetër përpos që të shprehin mllefin e tyre provincial dhe mendësinë bizantine ndaj kësaj sajese evropiane dhe amerikane (lexo: UEJL-së). Tentativat për të etiketuar këtë Universitet si institucion që gjoja po na promovojka projekte antishqiptare, e proserbe, i takojnë së kaluarës së "I po Tito, Tito", kohë kur hafijet merreshin me kësi lloj

patriotizmi folklorik të dhomave, për të zbuluar atdhetarët e devotshëm dhe të vërtetë dhe për t`i lajmëruar në UDB. Tani na paraqitet një njeri që për shkaqe të mia etike dhe morale, nuk i përmend as emrin, e del dhe thotë që ky institucion qenka proserb. Turp i paparë. Edhe del dhe e thotë këtë, mu para afatit të regjistrimit të studentëve të rinj brucoshë, sepse ashtu i është ngarkuar misioni, nga kush e di se cila qendër e vendosjes antishqiptare dhe antiperëndimore. Të etiketosh UEJL, sot si proserb, donë të thotë të ofendosh edhe miqtë tanë amerikanë dhe evropianë, të cilët na ndihmuan dhe po na ndihmojnë pa reshtur për të konsoliduar vetveten dhe këtë institucion. Pranoj, se gjithçka nuk është perfekt, e kësisoj mund të ketë edhe mangësi, po këto janë sfida që duhet tejkaluar së bashku, e jo duke etiketuar dhe duke u shpalosur si bajraktarë të nacionalizmit shqiptarë dhe si shpëtimtarë të shqiptarizmës. Shqiptarizma nuk mbrohet me etiketime e shpifje, po me punë e me veprime të matura, ajo nuk mbrohet me libra fallco, po me libra që dëshmojnë autenticitet dhe origjinalitet vlerash.

Pa mos dashur të shpallem avokat i Universitetit të Evropës Juglindore, e ndiej obligim dhe krenari, të shkruaj pa dyshim, për këtë Universitet duke tentuar t`a mbroj nga akuzat dashakeqe dhe gojëliga të disa individëve, që gjersa ishin të punësuar në këtë Universitet, për ta ky institucion ishte vend ku rridhte mjaltë, e tani pasise nuk e merituan të jenë edhe më tutje mësimdhënës në këtë Universitet (ngase rikujtojmë konkurrencën e vlerave ku mbijeton ai që është më i miri, e që është

karakteristike për këtë Universitet) shajnë dhe shpifin këtë institucion duke e shpallur si zymti.

Andaj i nderuar lexues, ti që ke qenë pjesë e këtij tempulli, e din se çfarë Universiteti kanë fatin të kenë shqiptarët në mes të Tetovës së bukur që ndërtohet çdo ditë, e din se është privilegj, kënaqësi dhe nder të jesh pjesë e këtij Universiteti, i cili në shikim të parë të bën për vete dhe të bën të dashurohesh në të në shikim të parë, po që dashuria të shtohet edhe më tutje kur të vish e të fillosh studimet në këtë kampus, që fati e deshi që ta kemi në Tetovën tonë shqiptare, ngase sikur mos t`a kishim kokën e mençur të A. Xhaferit dhe të tjerëve përreth tij, duke e përfshirë Rektorin e deritanishëm, akademikun z. Alajdin Abazin, Rektorin e ri z. Zamir Dika, si dhe shumë e shumë njerëz dhe fytyra eminente që punojnë në këtë tempull të diturisë (lexo: ka edhe të tillë që nuk punojnë në këtë Universitet, po megjithatë kane kontribut të çmuar), ky Institucion me siguri do të ndodhej ndokund kah Rumania, ose ndonjë vend tjetër, po ja që edhe ne nuk u ndiem të braktisur nga fati, e na ra hise ta kemi këtë Universitet pjesë e jona e të kënaqemi duke e soditur, qëndruar, studiuar dhe punuar aty.

Prandaj, ju që tentoni të "jepni fakte" që gjoja ky Universitet promovon projekte antishqiptare, mos harroni se - disa fakte "... janë përherë lakuriqe, madje edhe atëherë "kur vishen sipas modës së fundit...", andaj besoj se me këtë do të vetëdijesoheni para se të merrni guximin të (keq)shkruani apo të shkarravitni, si dhe të jepni deklarata të tilla.

A KANË NEVOJË SHQIPTARËT NË MAQEDONI PËR PARTI TË REJA POLITIKE?

Skena politike shqiptare i filloi vitet e pluralizmit dhe të demokracisë, me parti politike, të cilat u shërbenin atyre jo si parti, po si lëvizje. Kësisoj, në Shqipëri u paraqit Partia Demokratike me në krye Sali Berishën, e cila luajti rol të madh për demokratizimin e jetës politike në Shqipëri, megjithë të metat dhe mangësitë, Kosova, pati fatin që si lëvizje politike të ketë LDK-në, me në krye Ibrahim Rugovën, e cila deri në vitin 1997, do të shërbente si udhërrëfyese e shqiptarëve të Kosovës, po e cila do të fillonte tatëpjetën me protestat studentore të tetorit 1997 dhe me rezistencën e armatosur çlirimtare të UÇK-së, ndërsa shqiptarët e Maqedonisë patën fatin të kenë si Lëvizje të tyre politike, Partinë për Prosperitet Demokratik me në krye z. Nevzat Halilin. Ky i fundit do të emocononte shqiptarët, në momentin kur do të kërkonte ngritjen e flamurit shqiptar lirisht, pa brenga në një miting të tijin, kur unë atëbotë isha fare i vogël, po që më zgjonin kureshtjen proceset e ndryshme politike që detyrimisht na imponoheshin edhe neve, fëmijëve. Kësisoj ky kolorit i partive që ishin shndërruar në formë të lëvizjeve, funksiononte mirë. Menjëherë filluan veprimin edhe ca parti të tjera politike shqiptare, po që nuk cenuan aspak kredibilitetin e partive të lartpërmendura.

Në Maqedoni PPD, e cila u bë therë në sy për pushtetin maqedonas, u gjend përballë dy sfidave:

kryesisë së saj fleksibile dhe jo të qëndrueshme që punët i dilnin shumë lehtë nga dora, me ç`rast dëshmuan se nuk kanë prirje për të qenë liderë edhe pse ishin atdhedashës, si dhe ish-komunistëve të cilët brenda natës kishin kaluar në metamorfozë dhe ishin bërë demokratë, e që të linin përshtypjen se ishin më katolikë se edhe vet papa i Romës. Ngjarjet do të rridhnin ashtu siç dihet tanimë, kur njëra pjesë e strukturave të PPD-së, me insistimin edhe nga mëmëdheu Shqipëri, do të kërkonte rishikimin e politikës së kësaj partie dhe udhëheqësisë së saj letargjike, e me ç`rast do të shkaktoheshin edhe të çarat e para brenda kësaj partie. Kjo parti do të ndahej në dysh, me ç`rast do të krijoheshin dy parti me të njëjtin emër, njëra e regjistruar nga shteti tjetra e anatemuar. Kjo e fundit do të shtonte edhe shkronjën SH, që donë të thoshte shqiptare, për t`u dalluar nga ajo e para, do të shërbente si një opozitë e shkëlqyer në drejtim të korrigjimit të politikave shtetërore, e posaçërisht në demaskimin e politikës së fjetur të partisë shqiptare në pushtet të asaj kohe. Ngjarjet do të rridhnin ashtu ku do të ndodhnin shumë ngjarje që do të dëmtonin shqiptarin dhe qenien e tij, me Ladorishtën, Bit Pazarin, aferën e armëve, Reçicën e vogël dhe ngjarjet e Universitetit të Tetovës. E posaçërisht pushteti do të hidhërohej aq shumë me unifikimin e faktorit politik shqiptar, PPDSH dhe PDP nën emrin e vetëm PDSH, si dhe me vendosjen e flamurit shqiptar para godinës së komunës së Tetovës dhe Gostivarit, me ç`rast do të derdhej edhe gjaku në Gostivar, me tre të vrarë dhe qindra të rrahur dhe të plagosur në këto ngjarje të dhembshme. Kjo do të kulmonte edhe me burgosjen e kryetarëve të komunave

të asaj kohe të Tetovës dhe Gostivarit, z. Alajdin Demiri, z. Vebi Bexhetit, z. Rufi Osmani, z. Refik Dauti etj.

Faktori politik shqiptar, i hutuar nga goditja e fortë e pushtetit maqedonas, pa përkrahje nga mëmëdheu Shqipëri, që rënkonte prej klimës së acaruar politike dhe nga afera e skenave piramidale, që do t`a shpinin buzë greminës këtë shtet, i gjendur në pamundësi për ndihmën e duhur të Kosovës, e cila martirizohej çdo ditë nga okupatori serb, lëre që nuk bëri hapin e mençur për të bërë bashkim, po bile përkundrazi, u vazhdua qëndrimi në pushtetin e Cërvenkovskit sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ngjarjet siç do të rridhnin më tej, në dukje do të dukeshin më të qeta, me ardhjen në pushtet të qeverisë VMRO-DPMNE dhe PDSH. Kjo nga shkaku se filluan që të lëvizin gjërat pozitivisht, me hapa breshke, mirëpo edhe kjo nuk mjaftonte. Do të ndodhte lufta e 2001 dhe faktori politik shqiptar i çorientuar do ta priste këtë kryengritje pa ditur se për kënd bëhet fjalë dhe për çka janë ngritur në këmbë luftëtarët e UÇK-së. Të gjendur përballë kësaj dileme, ata fatmirësisht do të bënin Marrëveshjen e Prizrenit, e cila do të ishte hapi i parë i përafrimit të partive politike shqiptare, më 22 maj 2001, por e cila do të ishte shumë jetëshkurtër, ngase në momentin kur duhej që njerëzit që e udhëhoqën luftën të qëndronin larg politizimit, atyre u pëlqeu e kundërta. U veshën me petkun politik partiak të quajtur BDI, e cila do të mblidhte brenda vetes, ish- komunistët e Titos dhe të përkëdhelurit e dikurshëm, marksistë-leninistët e dikurshëm që kishin flijuar duke qëndruar vite e vite larg Maqedonisë duke financuar dhe ndihmuar luftërat çlirimtare të shndë-

rruara çuditërisht në lufta për të drejta, luftëtarët dhe invalidët e luftës.... e shumë e shumë soje njerëzish, që do të përbënin një konglomerat të çuditshëm dhe e tërë kjo do të sillte në fitore të kësaj partie në zgjedhjet e 2002. Qeverisja e muajit të mjaltit LSDM- BDI edhe pse bëri ca hapa pozitiv, prapë dëshmoi se është peng i mentalitetit ballkanas, duke inskenuar veprime që do të provokonin marrëdhëniet ndëretnike, me rastin e Sopotit, Vaksincës (lexo: kjo e fundit do të zgjidhej me ndërhyrjen e deputetit të asaj ane z. Hysni Shaqirit), me rastin e Rakovecit, me rastin e inskenimit të proceseve të montuara politike dhe gjyqësore, me mos implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me vrasjet enigmatike që do të ndodhnin çdo ditë ku edhe sot e kësaj dite nuk dihet se sa veta u vranë pas luftës, pse dhe si, e kjo u konvenonte pushtetarëve maqedonas, me ç`rast solli si epilog zvetënimin e elementit shqiptar në Maqedoni dhe pengimin e ndikimit të këtij të fundit në proceset decizive shtetërore. E ndërsa ndodhte kjo, partitë shqiptare bënin sehir, duke u promovuar kush më patriot, e kush më tradhtar. Në vitin 2006 do të vinte në skenë qeverisja VMRO-PDSH, e cila e mbërthyer nga petku nacionalist i Gruevskit dhe suitave të tij shqiptare, që më vonë do të formonin partinë e DR-së, do të ngadalësonin proceset politike në drejtim të avancimit të çështjes shqiptare. Ngjarja e Brodecit, do të ishte fatale për këtë parti, po edhe për shqiptarët në përgjithësi, ku u nënçmua dhe u anatemua qenia shqiptare në përgjithësi. Megjithë dilemat dhe enigmat e Brodecit, aty u maltretuan të pafajshëm, u vranë të pafajshëm dhe është dashur të kihet parasysh se marrëdhëniet ndëretnike

nuk ndërtohen duke rrënuar raporte, po duke ndërtuar raporte mirëbesimi. Sidoqoftë 2008 do të vinte me zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të gjenin shqiptarët dhe partitë politike shqiptare të acaruara dhe të armiqësuara deri në fyt. Kjo do të mundësonte fitoren e partisë nacionaliste VMRO, në mënyrë plebishitare, me ç`rast kjo parti do të fitonte numrin e nevojshëm për formim të qeverisë edhe pa parti shqiptare bile, ngase nuk është rregulluar formimi i qeverisë në Maqedoni si duhet, që të definojë se fituesi i votës shqiptare dhe i asaj maqedonase kanë të drejtë të formojnë qeverinë, e jo mandatari. Sidoqoftë, në skenë do të vinte koalicioni i çuditshëm VMRO-DPMNE dhe BDI, ku kjo e fundit duke mos lënë përshtypje se ekziston, më shumë u vendos si dekor se sa si bashkëqeverisëse. Gjatë kësaj qeverie, Brodeci dhe të dëmtuarit e Brodecit u harruan, statusi i gjuhës shqipe mbeti i pazgjidhur, çështja e ish-luftëtarëve të UÇK-së mbeti e pazgjidhur bile e anash-kaluar, përdorimi i simboleve mbeti edhe më tutje tabu temë, USHT mbeti pa para për financim, ngase paratë dedikoheshin për ndërtime në zonat maqedonase, investohet në universitetet maqedonase, si dhe u iniciua projekti Shkupi 2014 që Maqedoninë e ktheu në vitin 1914, për sa i përket afërsisë me proceset euroatlantike, u vranë civilë të pafajshëm duke u shpallur si terroristë, pa mos u vërtetuar si duhet (e ndërsa në varrimin e këtyre "terroristëve" të vrarë morën pjesë shqiptarë nga të gjitha trojet etnike, gjë që dëshmon të kundërtën e asaj që thuhet për këta të vrarë që gjoja na paskan qenë terroristë), u cenua dinjiteti shqiptar duke u bastisur fshatrat shqiptare në kërkim të armeve dhe krimineleve,

thuaja se vetëm në zonat shqiptare ka kriminelë dhe armë, e shumë e shumë veprime tjera antishqiptare. Sidoqoftë, kur një budalla e hedh një gurë në pus, një mijë të mençur nuk mund ta nxjerrin dot. Kësisoj shumë gur u hodhën nga shumë budallenj, e numri i të mençurve është i kënaqshëm, po nuk vjen në shprehje, sepse po ata budallenj që hedhin gurë në pus, tentojnë pastaj t`i nxjerrin gurët, duke harruar që janë vet ata që i kanë hidhur gurët. Faktori politik shqiptar edhe më tutje mbetet në letargji, pozita në inekzistencë dhe në delir, opozita në terr informativ dhe në konfuzion. Tani mëtohet formimi i Parlamentit bikameral ose dydhomësh, që është ide shumë e mirë, por që ka kosto të lartë, ngase është nënshkruar një Marrëveshje si e Ohrit, (lexo e varrosur nga partitë politike shqiptare, ndërsa e vrarë nga partitë maqedonase) e nuk është implementuar ende dhe as që do të implementohet ndonjëherë, e lëre më të kërkohet diçka më e madhe prej maqedonasve për t`u bërë. Në anën tjetër kemi zëra për formimin e partive të reja politike, që do të kërkojnë ridefinim të raporteve ndëretnike, duke mos sqaruar aspak se çka nënkuptohej me këtë. Sidoqoftë langonjtë endacakë le të bëhen gati të bredhin prej njërës parti tek kjo tjetra, që të sigurojnë ekzistencën.. Shqiptarët janë ngopur me parti e partiçka, ata duan koncepte të qarta politike, veprime konkrete për zgjidhje përfundimtare të çështjes kombëtare, e jo parti politike, ngase i kemi të mjaftueshme, bile edhe të tepërta gjithë këto që ekzistojnë aktualisht. Ata kanë nevojë për klasë të shëndoshë politike që do të bënte ndryshim radikal të statusit shqiptarë në Maqedoni, por edhe do të luftonte për integrim në struktura

euroatlantike, sepse pa këto procese jemi të prirë të mos ekzistojmë si duhet, fundja nuk do të vdesim, po ama do të jetojmë si fiset afrikane. Andaj, edhe nëse hapet parti e re politike shqiptare, që do të begatonte mozaikun provincial dhe të begatë të skenës politike shqiptare në Maqedoni, kjo nuk do të thotë që automatikisht problemet do të zgjidhen, lypset shumë mund e përpjekje, të gërshetuara me dije dhe inteligjencë, vigjilencë e kurajë për avancim të çështjeve të sipërpërmendura që kanë ngecur.

Shqiptarëve në Maqedoni, u duhet unifikim i faktorit politik shqiptar, bashkim për hir të proceseve të ndjeshme, kooperim dhe veprim koheziv, e jo përçarje e fragmentim, koncepte të qarta politike dhe nisma për t`i implementuar ato, e jo retorikë boshe, kërkesa me vendosmëri për ndryshim të statusit të shqiptarëve në Maqedoni, duke marrë për model Kosovën, ku pakica gëzon gjitha privilegjet, e jo si këtu, ku shumica diskriminohet nga tjetra shumicë. Andaj, nëse nuk bëhen këto, duhet kërkuar federalizëm troç, Parlament dydhomësh dhe institucione federale.

LOTËT E KROKODILIT

Togfjalëshi i lartpërmendur më shoqëron që kur fillova të kuptoj dhe perceptoj botën dhe proceset e ndryshme shoqërore- politike, por që të kuptoj domethënien e vërtetë arrita ta kuptoj pas më shumë se dy dekadave, edhe atë në përvjetorin e gjenocidit apo etnocidit të Srebrenicës. Në këtë kontekst, më kujtohen imazhet televizive të kafshës së quajtur **krokodil**, i cili shumë lehtë zinte gjahun e vet, i cili ishte natyrisht më i dobët, dhe arrinte që ta hante shumë lehtë kundërshtarin. Kësisoj, pas gëlltitjes së gjahut, krokodili qante me psherëtima, duke u dhimbsur për viktimën e tij, por pasise gjallesa e bërë hi gjendej në brendësi të barkut të krokodilit. Kësisoj, ky përshkrim, më ndihmoi që të filloj shtjellimin e veprimit të një njeriu, president të një shteti, duke bërë korrelacion me krokodilin, respektivisht të presidentit të Serbisë, z. Boris Tadiq, i cili në përvjetorin e lartpërmendur të Srebrenicës të mbajtur këtë vit, gjegjësisht para dy-tre ditësh, imitonte shkëlqyeshëm krokodilin, saqë edhe krokodili do t`ia kishte zili dhe lakminë Tadiqit. Të derdhësh lot në Srebrenicë, është akt human dhe njerëzor, njëkohësisht edhe katarsë shpirtërore dhe mentale, për një ngjarje që nuk e kap truri i njeriut. Kjo ngjarje makabër ku ishin vrarë dhe masakruar pa fije turpi, para botës së qytetëruar dhe demokratike 8000 mysliman, meriton një analizë dhe studim serioz nga analistë dhe historianë të pavarur, ku nuk mjafton përkujtimi i thjeshtë, apo derdhja e lotëve të krokodilit, po nevojitet një pranim që është

kryer me vetëdije ky gjenocid, një kërkesë e faljes drejtuar popullatës myslimane të Bosnjës, si dhe një zotim për të mos përsëritur ngjarje të tilla, që nuk i kishte parë bota dhe njerëzimi që pas Luftës së Dytë Botërore.

Kësisoj teksa shihja presidentin Tadiç, më dilte përpara fytyra e kryekriminelit Mlladiç dhe Karaxhiç gjatë viteve 1993, 1994 dhe 1995, teksa buzëqeshnin dhe dhimbseshin për popullatën civile myslimane, por vetëm para kamerave televizive, e në fakt masakruan dhe çmendën një popullatë të tërë. Imazhet e njëjta mund të hasen edhe tek krimet e kryera tek shqiptarët, ku kriminelët gjakftohtë paraqiteshin si "engjëj" të demonizuar që edhe demonin vet e frikësonin. Boris Tadiç duhet të tregojë dhe dëshmojë se:

1. është i gatshëm të kërkojë falje për gjitha krimet e kryera në Ballkan prej 1991 e gjer më sot, por edhe para 1991, sepse është pikërisht Tadiç, prodhim dhe relikt si politikan, i kuadrove që kryen këto krime

2. është i gatshëm të kërkojë dhe të bëjë denacifikimin e Serbisë dhe të serbëve, e jo duke bredhur si qyqarë rrugëve dhe kuluareve diplomatike të tentojë të minojë pavarësinë e pakthyeshme të Kosovës

3. të dërgojë kriminelët serbë para Gjykatës së Hagës të cilët janë të shumtë dhe janë bile edhe të institucionalizuar dhe të rehabilituar nëpër institucione shtetërore

4. të kërkojë dhe të punojë për një qetësim të situatës në Bosnjë, e jo të shfrytëzojë këtë për të vendosur bombë të kurdisur që do të prodhonte domino-efektin me Republikën demone Serbe

5. të punojë në raport të avancimit dhe paqësimit me shtetet fqinje, duke përfshirë këtu edhe Kosovën

6. të punojë për një stabilitet në Ballkan, sepse destabilizimi Ballkanit i vjen nga politika ekspansioniste dhe antiintegruese e Serbisë

7. të frenojë dhe mos të përkrahë direkt apo indirekt qarqet nacionaliste qeveritare apo joqeveritare në Serbi, si dhe në pjesën e administruar serbe të Bosnjës, e cila pjesë fatkeqësisht dhe paradoksalisht u pranua nga faktori ndërkombëtar, duke e ditur se mund të përdoret si bombë në çdo moment, atëherë kur do t`i duhet qarqeve nacionaliste dhe ekstremiste serbe

8. të iniciojë edhe ndërkombëtarisht ridefinimin e raporteve të acaruara shqiptaro-serbe dhe raporteve brenda federatës boshnjake, të avancojë të drejtat e komuniteteve tjera në Serbi, siç janë shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, ...

9. të pranojë krimet e bëra në emër të idesë panserbe për një Serbi të madhe dhe të detyrohet të paguajë reparacione dhe dëme të shkaktuara viktimave kudo qofshin ato (lexo: sikur rasti i Gjermanisë e cila paguan borxhe dhe reparacione të luftërave botërore të shkaktuara nga vet ajo)

Kjo duhet të pranohet edhe nga bashkësia ndërkombëtare, sepse ndryshe nuk bën, ngase dubël standardet nuk janë të nevojshme dhe funskionale. Përndryshe, lotët e krokodilit të presidentit serb Tadiç, nuk do të nevojiteshin për asgjë tjetër, përpos vetëm për të tharë barin e gjelbër në Srebrenicën e damkosur, syrgjynosur dhe të shkatërruar materialisht, fizikisht dhe shpirtërisht nga krimet e bërë nga dora kriminele serbe,

dorë kjo që i takon njerëzve që kanë qenë të brezit të presidentit Tadiç dhe të tjerëve si ai.

MBRESAT NGA VIZITA E BËRË MËMËDHEUT

Është komb interesant kombi shqiptar. Përpos që është shoqëruar për shekuj me radhë me fatkeqësi të ndryshme, i ndarë padrejtësisht në më shumë shtete, i dënuar t`i jetojë, por edhe t`i kundërshtojë padrejtësitë, e Berlinit, Londrës, Versajës dhe Jaltës, ky komb ka arritur që t`i bëjë ballë sfidave të ndryshme të imponuara nga gjeopolitika dhe nga rrethanat e ndryshme. Ky komb ka nxjerr nga gjiri i vet bij e bija të shkëlqyera që kanë qenë dhe janë udhërrëfyes dhe shëmbëlltyrë edhe për kombet tjera përreth, por edhe më gjerë. Kësisoj Pirro i ynë, Leka i Madh, Skënderbeu, e shumë e shumë

të tjerë për të përfunduar tek Nënë Tereza në ditët e sotshme, lëre që tentohen të përvetësohen, por shikohen me admirim dhe glorifikohen edhe nga kombe të tjera, që mëtojnë të ndërtojnë historinë e tyre duke u vetërrënuar.

Për të mos dalë nga tema, ditë e bukur me diell, ditë e nxehtë e korrikut, vendosa t`i bëjë vizitë mëmëdheut tonë, Shqipërisë londineze. Pasi kaluam pa problem kufijtë që në të dy anët banohen me shqiptarë, hymë në territorin e shtetit amë, që frymonte kudo shqip dhe që ndërtohej çdo ditë e më shumë me(pa) leje. Kësisoj më bëhej zemra mal që më në fund edhe Shqipëria ndërtohej dhe ndryshonte, ndërkaq kujtimet e hidhura që më ndjekin mbrapa, me ato imazhet e mjera të viteve 1992-93 atëherë kur për herë të parë vizitova mëmëdheun e gjorë, kishin filluar të harroheshin. Në momentin kur hyra në tokën e shenjtë shqiptare e përjetova edhe udhëtimin tim nëpër kohë, atëherë kur në vitin jo shumë ta largët 1992, vizituam Shqipërinë me familje. Të uritur për të parë Shqipërinë, ngase e kishim të ndaluar më përpara ta kujtonim, e lëre më të vizitonim, më kujtohen imazhet e këqija të asaj kohe, kur u futëm në tokën shqiptare në vendkalimin e Qafë Thanës dhe ku doganieri shqiptar u desh që të pasurohej me ca marka, ngase nuk kishte i gjori, posa kishin dalë nga kolapsi ekonomik komunist, e duhej të mbijetonte disi. Unë si fëmijë çapkën që isha, duke e menduar Shqipërinë time të kujtimeve të mia fëmijërore, sikurse seriali i Beverlli Hillsit, u pata shokuar me imazhet e varfra në hyrje në tokën shqiptare. Varfëri, ngjyrë e verdhë që simbolizonte në vdekje, shtëpi të varfra, pa kulme,

njerëz të zinj prej varfërisë, Poema e Mjerimit më doli para syve të mia, polic me flokë të gjata me pantallona ta pa hekurosura, rrugë të ngushta vetëm për biçikleta edhe atë vetëm për një kah, e lëre më për furgonin Ford që e kishim ne, bunkerë në të gjitha anët që kishin hapur gojët të gatshëm të gëlltitnin fate njerëzish, të ndërtuara në kohën e Enver Hoxhës, në kohën kur Shqipëria ishte e armiqësuar me të gjithë, lypës nga të gjitha anët, mezi arritëm për shumë orë në qytetin turistik të Durrësit. Përpos hotel "Adriatikut" tjetër gjë të ndërtuar si duhet nuk mund të shihja. I hidhëruar tejmase me realitetin e hidhur, e pyetja babin tim se vallë kjo na ishte Shqipëria, e ai i gjori më përgjigjej vazhdimisht se Shqipëria kjo nuk ishte, edhe pak edhe pak dhe do të arrinim në Shqipërinë e vërtetë. Tentonte të më jepte kurajë mua por edhe vetes prindi im, i cili u shokua edhe vet personalisht me pamjet trishtuese. Ngasjet e makinave me shpejtësi të madhe, nuk na pengonin edhe aq. Shqipëria posa kishte filluar të merrte frymë më lirshëm, por ishte në tranzicionin e thellë, në fazën kur ky tranzicion gëlltite fate njerëzish. Të vendosur në një banesë ku shëtitshin lirshëm zvarranikë të ndryshëm, të cilët flinin me ne, mezi u pajtuam me një realitet të tillë. Ditëve të plazhit, ku nuk kishte shumë turistë, nuk shihje asgjë, përpos bërrllogje pa kontejnerë, erë që kundërmonte dhe në vriste veshin muzika turbo folk serbe e Cecës apo e Lepa Brenës. Prindi im i irrituar me ca kosovarë, desh donin të bëheshin copa me ca qytetarë shqiptarë të Durrësit, që dëgjonin këtë muzikë pa mos çarë kokën fare, për sharjet dhe ofendimet e bërë nga prindi dhe kosovarët. Ata arsyetoheshin që

politika nuk ka lidhje me muzikën. Ndërsa, Kosova gjakosej dhe mezi merrte frymë nga thundra serbe e regjimit serb të Millosheviqit. Ne në Maqedoni, ishim poashtu të eksponuar përballë një politike represive të qeverisë maqedonase, ku gati se çdo vit inskenoheshin veprime antishqiptare nga qarqet sllavomaqedonase, me urdhrat serbe dhe vriteshin si asgjë shqiptarët, e këta vëllezërit tanë dëgjonin muzikë serbisht. Na thonin që jemi të marrë, që politika nuk kishte asgjë me kën-gën, që flamuri ishte vetëm një leckë, ndërsa për këtë flamur vriteshim e persekutoheshim ne jashtë atdheut secilën ditë të gdhirë. Po, ç`të bësh, nuk mundeshim asgjë të bënim më shumë. Të eksponuar përballë këtyre realiteteve të hidhura, na e rregullonte paksa qejfin e prishur gjuha e folur aq bukur, saqë ia kishim zili edhe shitëses së fiqve, e cila na "detyronte" me qejf të blinim fiq për shkak të komunikimit të rrjedhshëm të shqipes së bukur. Prindi im, në ndërkohë ende debatonte me njerëz të ndryshëm për Enver Hoxhën, sistemi i të cilit posa ishte bërë pjesë e historisë. Unë arsyetoj qëndrimet e babait tim dhe shokëve kosovarë, që mbronin fanatikisht Enverin edhe në ato momente, si edhe më herët, ngase për ne që gjendeshim jashtë atdheut amë, Shqipërisë, Enveri dhe Shqipëria ishte kibla kombëtare, dhe shpresa për të mos u asimiluar në kombin jugosllav të Titos. Edhe, nuk pushonin së ndaluari refrenet, "Më mirë komunist i Enverit, se i Titos". Për të mos hyrë më thellë se a kishim të drejtë a jo, unë mendoj se kjo na ka mbajtur neve shqiptarëve jashtë trungut amë në kohezion, debatet sa vinin e shtoheshin. Kishte njerëz që

lavdëronin Enverin, disa e shanin, të tjerët as që donin ta përmendnin.

Këto imazhe që mu kthyen për ca momente në memorien time, nuk më penguan që për dallim prej atëherë kur udhëtimi zgjaste me orë të tëra, të arrijë në qytetin e bukur të Durrësit për shumë pak kohë, vetëm për 5 orë, ngase tani mëmëdheu ndërtohej në të gjitha anët, e posaçërisht rrugët, që ia kalonin edhe Maqedonisë sonë bile. Është për tu admiruar kjo, me të vërtetë të bëhej zemra mal kur shihje Shqipërinë që po ndryshonte secilin vit më shumë. Ndërtimet e ndryshme me ose pa leje, kishin zëvendësuar pamjet e trishtueshme të vitit 92, që mu patën ngulitur thellë në mendjen tim. Ato pamje i kalonin së kaluarës. Tani, hoteli orientues Adriatik, ishte hoteli më i vogël, në krahasim me të tjerët rreth tij. Më bëhej zemra mal ku në të gjitha anët shihja restorante dhe kafene shqiptare, si "Prizreni, Tetova, Gostivari, Kumanova, Prishtina....." e që më bënin të përjetoja me vete Shqipërinë Natyrale dhe ta sodisja pa u ndalur. Në të katër anët muzikë shqipe, në vend të Cecës së dikurshme.

Plazhi i bukur i Durrësit me përplot turistë që ngjanin në bleta, i bënte ballë numerozitetit të turistëve, si dhe nxehtësisë së madhe. Tani, unë (A.R.) 26 vjeçar, nuk isha ai fëmiu mistrec, siç më quanin atëherë ca miq të babi tim, po isha rritur dhe kyçesha lehtë në diskutime me turistët shqiptarë nga të gjitha Shqipëritë e tjera. Për këtë gëzohesha tej mase. Po ajo që më shqetësonte dhe më hidhëronte më shumë ishte ndarja e madhe dhe divergjencat ndërshqiptare. Thjesht kishte të tillë, që shprehnin mllefin ndaj kryeministrit Berisha (përkrahës

dhe simpatizues të socialistëve) për gjoja vjedhjen e votave dhe mos hapjen e kufijve, për politikat e gabuara dhe për koketimin e tepruar me kosovarët. Në anën tjetër dilte tjetri, përkrahës i demokratëve që i thoshte këtyre që i kishte oponentë, se ju doni ta rrënoni Shqipërinë, nuk doni bashkim me Kosovën, po doni marrëdhënie shumë më shumë me grekun dhe serbin, apo italianin. E unë, dëgjoja këto debate që më vrisnin veshin dhe që më shqetësonin tej mase. Në anën tjetër fërkimet mes shqiptarëve të Kosovës nuk ndaleshin asnjë moment, ku kishte të tillë që i dëgjoja duke glorifikuar figurën e Hashim Thaçit, Azem Sylës, Xhavit Halitit, Ramushit etj, si dhe të tjerë që glorifikonin figurën e Ibrahim Rugovës, Ahmet Krasniqit, Tahir Zemës..., duke më lodhur edhe më shumë. Po, kur vinte puna për Maqedoni, kishte poashtu edhe në mesin e tyre nga Maqedonia që kapeshin shumë keq për atë se cila parti qeveriste më mirë, disa mbronin PDSH-në, disa BDI-në. Ndërsa vëllezërit tanë nga Shqipëria dhe Kosova, na këshillonin që të ruajmë gjakftohtësinë e të ruhemi për sllavomaqedonasit. Këtu kishin të drejtë, po unë u thosha vazhdimisht që ne merrnim yrnek (shembull) nga ju të Shqipërisë dhe Kosovës, e ata ma kthenin: "Ore, ne kemi shtet e ju nuk keni". Pjesërisht ishte ashtu, po pjesërisht jo, ngase edhe ne shqiptarët nga Maqedonia, që llogariteshim si të tjerë nga ata të Shqipërisë dhe Kosovës, ndiheshim të braktisur së pari nga partitë tona politike, e pastaj edhe nga mëmëdheu Shqipëri dhe atdheu Kosovë. Nuk arrinim ta kuptonim se ishim të njëjtë, shqiptarë të Shqipërisë Natyrale, Etnike, të Madhe..., por të ndarë padrejtësisht.

Debatet vazhdonin çdo ditë, ku disa lavdëronin Enver Hoxhën, disa shanin atë si bashkëpunëtorë të serbëve dhe rusëve, disa e glorifikonin duke thënë se shpëtoi Shqipërinë, siguroi kufijtë qind për qind, arsimoi gjeneratat, hapi shkolla, ndihmoi në edukim dhe arsimi..., e disa e akuzonin për mbyllje të Shqipërisë, tradhti të interesave kombëtare, luftë të klasave... Disa lavdëronin mbretin Ahmet Zogu për diplomacinë siç e quanin ato të shkëlqye, për interaksionet dhe marrëveshjet me fuqitë perëndimore që na ndihmuan tani në Kosovë, e disa e shanin duke nxjerrë në pah marrëdhëniet e tija shumë të mira me Jugosllavinë, shitjen e Shën Naumit, vrasjen a patriotëve shqiptarë: Bajram Curri, Avni Rrustemi, Luigj Gurakuqi..., po këta të tjerët arsyetoheshin që kjo ishte luftë për pushtet. Ec, e bjeru në fije. Në anën tjetër disa thonin që Skënderbeu ishte mit dhe duhej të ç'mitizohej, ngase sikur të lidhej me Turqinë në atë kohë shqiptarë do ët kishte sot më shumë, se gjoja ai ishte figurë krishtere e jo kombëtare, se gjoja mbante aleance me serbët ku motra e tij ishte e martuar me serbomalazezë e çka e çka tjetër, që gjoja kishte lindur në Varosh të Matit, e jo në Dibër siç mëtohej nga Kristo Frashëri dhe suitat e Nexhmije Hoxhës, e të tjerë që thonin që ka lindur në Krujë dhe që e mbronin si figurë kombëtare që ishte. Habia më e madhe më ndodhi, kur dëgjoja gojë të liga që shanin Nënë Terezën, e disa që e mbronin, po momenti kulmor më ngjau kur dëgjova nga një gojë shqiptari se Esat Pashë Toptani na ishte patriot, ngase ai e paska shpëtuar Shkodrën duke vrarë 5000 malazezë dhe duke mbrojtur qytetin, ndërsa Hasan Prishtina, që nuk paska

arritur ta mbajë të çliruar Shkupin, na qenka tradhtar. Ai vazhdonte të më sqarojë që Avni Rrustemi e paska vrarë Esat Toptanin me urdhër të Shërbimit të huaj francez, duke mos u dënuar për këtë asnjëherë, ngase Esati nuk qenka pajtuar me vendimet e Versajës. Ec, e mos u çmend. E në anën tjetër argumentet si breshër kundër këtij njeriu, për figurë e Esat Toptanit, si njeri tradhtar që mori dënimin e merituar nga patrioti shqiptar Avni Rrustemi. Koka më dhembte. Çdo ditë e njëjta gjë, të njëjtat debate. E thash vet me vete, " flasim shqip e nuk merremi vesh dot. A shqiptarë jemi të gjitha, ka sa ditë që debatojmë, e jemi aq larg njëri- tjetrit me qëndrime saqë nuk mund të na bashkojë dhe të na puq asnjë fuqi mbinatyrore". Hidhërimi im dhe i mikut tim nga Shkupi kulmonte kur vëllezërit tanë nga Shqipëria na quanin maqedonca, duke na identifikuar me shtetin-komb Maqedoni, duke mos e kuptuar se edhe ne ishim shqiptarë hiç më pak se ata, ndërsa këta të tjerët nga Kosova mburreshin që flitnin kosovarisht, si dhe që kishin krijuar shtetin-komb kosovar të Migjenit, Halilit dhe Nexhmedinit. Eu, bre ec e mos dil mendsh.

Debatonim e debatonim. Në momentin kur afroheshim njëri me tjetrin, largoheshim sikurse uji dhe vaji. Dhe, duke ardhur fundi i pushimeve, arrija në konkluzionin me të cilin fatmirësisht u pajtuan të gjithë vëllezërit e mi shqiptarë nga të gjitha Shqipëritë, që përderisa ende jemi aq larg me qëndrime, bindje dhe ide, me veprime, të flasë zëri i arsyes, zëri unik koheziv, zëri argumentativ dhe zëri i së vërtetës, atëherë kur të kuptohet se jemi një, megjithë dallimet e imponuara, edhe pse unë dhe shqiptari nga Kosova dinim përmendësh

edhe fshatrat e Shqipërisë, e ky vëllai ynë nga Shqipëria nuk dinte ku është Kumanova, e ai tjetri mendonte se është afër Graçanicës, e kështu me radhë, pra me gjithë këto dallime minore dhe madhore, duhet të kemi parasysh se jemi shqiptarë, si dhe se ideali ynë është Shqipëria Një, apo United States of Albania, duke përfshirë Maqedoninë shqiptare, Kosovën Lindore, Ulqinin, Tivarin dhe Tuzin, Çamërinë, Kosovën dhe Shqipërinë londineze.

NËNTË VITE STAGNIM DHE ZVARRITJE TË MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT

(Përkitazi me nëntë vjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes së vdekur të Ohrit)

Sot, me datë 13 gusht, mbushen plot nëntë vjet, që kur Maqedonia shpëtoi definitivisht nga rrënimi i saj si shtet. Në tentativën për rrënimin e Maqedonisë kontribuuan politikanët maqedonas duke filluar nga plaku i mençur e dinak, ish presidenti Kiro Gligorov, duke vazhduar me Branko Cërvenkovski, Lubço Georgievskin dhe së fundi kontribuon në permanencë Nikolla Gruevski me suitat e tij. Edhe atë është e çuditshme, se si edhe sot e kësaj dite mendojnë këta të lartpërmendurit se janë munduar si dhe mundohen të ndërtojnë Maqedoninë si shtet multietnik, por gjithnjë duke tentuar margjinalizimin e shqiptarëve, përmes veprimeve të ndryshme, saqë (s`)janë fare koshient që nuk kanë qenë kurrë dhe s`janë për ndërtimin e Maqedonisë si shtet, po përkundrazi. Kjo Marrëveshje e cila mbeti vetëm marrëveshje ad-hoc, e shkruar në letër, e harruar skajshmërisht, e përmendur si refren vetëm nga politikanët shqiptarë edhe atë kur janë në pushtet- pozitë, e stigmatizuar vazhdimisht, e vrarë dhe e varrosur përfundimisht nga politika jo e duhur e ço qeverie të këtij shteti. Kjo marrëveshje e cila llogaritet nga maqedonasit si koncesion i madh ndaj komuniteteve tjera, e posaçërisht ndaj komunitetit shqiptar, e kam thënë dhe e theksoj përsëri që është larg të qenit natyrale, pra me plot bindje e pohoj se është e vrarë dhe e varrosur

ndokund nëpër sirtarët shtetërore. Në vrasjen e saj kontribuuan më shumë politikanët shqiptarë, më shumë se ata maqedonas, ngase nuk ishin dhe nuk janë të aftë që t`a mbrojnë atë që duhej implementua praktikisht. Shtrohet pyetja se kur nuk ishin në gjendje të mbronin një Marrëveshje të Ohrit, e garantuar ndërkombëtarisht përmes arbitrazhit ndërkombëtar, ç`kanë që e përmendin vazhdimisht nëpër prononcime të tyre televizive, nëpër intervista, sikurse refreni i këngëve popullore ? Dëgjojmë edhe më tej shprehjet se gjoja kjo Marrëveshje është e realizuar 99 %, ndërsa rezultatet në terren na tregojnë që kjo Marrëveshje është e parealizueshme 99 %. Kjo Marrëveshje e cila ishte kompromis mes dy palëve, asaj shqiptare dhe asaj maqedonase, e garantuar fuqishëm nga faktori ndërkombëtar, është vrarë, ngase pjesët ku duheshin realizuar patjetërsueshmërisht, u anatemuan dhe u humbën krejtësisht. Kësisoj shkojmë me radhë:

1. Moszgjidhja e përdorimit të gjuhës shqipe- edhe sot e kësaj dite shqiptarët nuk munden t`u drejtohen institucioneve të veta në gjuhën amtare, e cila është e garantuar nga po e njëjta Marrëveshje, mirëpo pala maqedonase e anatemon dhe e injoron vazhdimisht këtë, ndërsa partia politike shqiptare në qeveri vetëm bën sehir

2. Mospërdorimi i simboleve kombëtare;- edhe sot e kësaj dite flamuri kombëtar shqiptar nuk mundet të valojë lirshëm për të dëshmuar se në këtë shtet jetojnë edhe shqiptarët. Edhe sot e tutje, flamuri shqiptar është larg përdorimit të tij nëpër institucione komunale dhe shtetërore. Ai përdoret vetëm përpara selive të partive

politike shqiptare dhe nëpër zonat e varfra shqiptare të banuara me qindpërqind shqiptarë, por jo i përdorur dhe i garantuar institucionalisht me ligj, po nga vetdëshira e shqiptarëve.

3. Ndarja e dëmshme territoriale dhe decentralizimi i parealizuar;- edhe sot e kësaj dite pika kyçe e kësaj Marrëveshje nuk është realizuar si duhet. Shqiptarët në vend se të menaxhojnë me komuna të mirëfillta, i`u janë lënë komunat rurale, si për shembull Komuna e Likovës, e cila vetmbahet me borxhe dhe për shumë shpejt pak kohë rrezikohet mos të qenësojë si duhet. Është edhe më tej habitëse se si për shembull qytetarët e Likovës, ende paguajnë tatime për Kumanovën, ndërsa kur të vijë koha për të absorbuar ndonjë projekt nga qeveria refuzohen me arsyetimin se i takojnë komunës së Likovës, për të cilën nuk paguajnë tatime edhe më tej, edhe pse kjo e fundit figuron si komunë, ku kryetarët e saj më shumë i ngjajnë kryetarëve të bashkësive lokale. Edhe më tej refuzohet bashkimi i komunave shqiptare përreth me komunën e Kërçovës.

4. Mosarritja e shkallës së përfaqësimit deri në 25 për qind;- edhe pse shqiptarët estimohet që janë diku rreth 25 %, e në fakt kjo shifër është manipuluese ngase janë më shumë, shkalla e përfaqësimit në institucionet shtetërore është ende e vogël. Dhe kjo është e bërë me plan dhe vetëdije të plotë. Administratorët shqiptarë rrinë shtëpive dhe ëmbëltoreve, ngase ende nuk « janë krijuar » kushtet për t`ja filluar punës, e me këtë ata izolohen qëllimisht, për të mos i kuptuar detyrat dhe punët e institucioneve shtetërore, ndërsa maqedonasit lëre që janë shefa e kryeshefa të shqiptarëve, po edhe ankohen se gjoja shqiptarët të cilët janë nëpër

institucione kinse qenkan pa afinitete, ngase nuk po e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe nuk po i dinë ligjet dhe punët si duhet. Si ti dijnë këta të gjorët, kur administrata është e partizuar me kuadro që i kanë marrë diplomat shkel e shko, pa kurrfarë kriteresh, ndërsa kuadrot e afta që dinë gjuhë të huaja, ose kanë ikur jashtë shtetit, ose punojnë privatisht, e kurrsesi nuk ftohen nga politikanët shqiptarë.

5. Diskriminimi rreth dhënies së shtetësive për shumë shqiptarë- çudia më e madhe është me nënshtetësitë, ngase me dhjetëra mijëra shqiptarë ende nuk kanë nënshtetësi, edhe pse janë të lindur në këtë shtet dhe paguajnë tatime për këtë shtet, i cili i privon nga e drejta ligjore për të marrë nënshtetësi. Edhe sot Maqedonia është shteti i vetëm evropian, që procedurën për marrje të nënshtetësive nga ana e shqiptarëve e ka më të vështirën, bile më diskriminuesen në Evropë.

6. Përfaqësimi zero në shumë institucione dhe hierarkinë e lartë vendimmarrëse shtetërore;- as që bëhet fjalë që shqiptari të udhëheqë me resorë që përfaqësojnë hierarkinë shtetërore. Nuk mund të imagjinohet ministri i punëve të jashtme, mbrojtjes apo punëve të brendshme të jetë shqiptar. As mos të flasim për Kryeministër apo Kryetar shteti. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme, qasja e shqiptarëve është aq e vogël, saqë më lehtë shqiptarët do të mundeshin të hynin e të dilnin tek lumi Armagedon, se sa në këtë Ministri.

7. Anashkalimi i zonave shqiptare për investime;- edhe më tej zonat shqiptare i ngjajnë Kalkutës, shteteve si Togo e Çadi, ku zonat shqiptare të vrasin syrin me pamjet e mjeruara pa asfalt, pa kanalizime, pa parqe dhe lojëra për fëmijë, pa trotuare, pa parkingje, me telat

e rrymës që thuajse janë të gatshme të gëlltisin fate njerëzish, e pa kurrfarë investimesh, ndërsa zonat maqedonase ngjasojnë me zonat më moderne evropiane me të gjitha kushtet dhe standardet e duhura. Edhe më tej politikanët shqiptarë shkojnë në zonat maqedonase për të pirë kafen si dhe për tu joshur nga kamerieret bukuroshe maqedonase, prej të cilëve politikanët shqiptarë përjetojnë orgazëm e nuk fitojnë asgjë, po vetëm i lajnë paratë aty dhe i zgurdullojnë sytë si qyqarë, ndërsa zonat shqiptare të vrasin syrin me çajtoret dhe pamjet e zymta të shek. XVII- XVIII.

8. Anashkalimi dhe mos përfaqësimi në organet e larta të sigurisë, shërbimet sekrete dhe njësitet speciale ushtarake, ku nuk ka gati asnjë shqiptarë;- është rreptësisht e ndaluar qasja nëpër këto vende që dëshmojnë pjesëmarrjen e vërtetë në shtet, ngase edhe më tutje shqiptarët llogariten si të huaj dhe të padëshiruar për shtetin,megjithëse kanë politikanët e tyre, që vetëm për fushata elektorale përkujdesen për votuesit e vet.

9. Moszgjidhja e statusit të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së;- edhe më tej statusi i atyre që flijuan gjithçka për kombin shqiptar është i pazgjidhur me aspak gjasa për t`u zgjidhur. Edhe më tutje qeveritarët maqedonase konsiderojnë UÇK-në terroriste, ndërsa forcat maqedonase i konsiderojnë si shpëtimtarë dhe mbrojtës të Maqedonisë, e nuk ka qeveritar dhe politikan shqiptarë që t`u tregojë se ushtarët çlirimtarë që luftuan për avancim të të drejtave të tyre dhe të bashkëkombësve të tyre nuk janë terroristë, po janë luftëtarët më të dalluar dhe më të disiplinuar në rajon, nuk kanë bërë asnjë krim,asnjë terror, përkundrazi shumë civilë të pafajshëm shqiptarë u vranë nga

forcat policore dhe ushtarake maqedonase. Asnjë Kishë apo Manastir nuk është djegur nga shqiptarët, e asnjë xhami nuk mbeti pa u djeg dhe u shkatërruar nga sulmet me helikopterë të branitelave në Komunën e Likovës për shembull, e gjetiu.

10. Kaosi i shkaktuar në arsimin shqip; - shkollat shqipe edhe më tej mbeten të stërmbushura me nxënës, pa kurrfarë laboratorësh, pa kurrfarë sallash sportive, pa kurrfarë librash e materialesh (lexo: atyre u servohen libra me mijëra gabime dhe me toponomi sllave), ku profesori shqiptar i eksponohet vazhdimisht rrezikut dhe nuk është i sigurt, ndërsa ai maqedonas çdo vit me nxënësit e tij viziton shtete dhe qytete evropiane me paratë shtetërore dhe komunale. Ndërsa shqiptarët secilin vit mbarten prej një vendi në vendin tjetër, sikurse nomadë, prej një objekti shkollor të adaptuar në kazerma ushtarake të adaptuara. Për çfarë shkolla e arsimi perëndimor mund të flasim?

Kujdes, lista nuk mbaron këtu. Ka edhe shumë për të thënë. Po nuk dua që lexuesi të zhytet në shqetësim dhe morozitet.

Përfundoj me konstatimin se nuk mund të ketë stabilitet në këtë shtet, pa avancim dhe trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve në këtë shtet, e sidomos të shqiptarëve. Nëse dëshiron të ekzistojë si shtet Maqedonia duhet ti trajtojë të gjithë qytetarët njësoj sepse ky shtet do të mund të ekzistojë për aq sa të duan shqiptarët, sepse edhe ashtu ka probleme për emrin me fqiun jugor Greqinë, edhe më tej ka problem me identitetin, sepse kontestohet nga fqiu lindor-Bullgaria, ende ka problem me kishat dhe njëkohësisht edhe me

identitetin, sepse i kontestohen të dyja nga Serbia. Andaj është e udhës që të mos hap edhe më tej fronte të tjera, e sidomos me shqiptarët, sepse ata janë mjaft relevant në rajon. Locimi i divergjencave me shqiptarët, do të thotë regres dhe stagnacion për këtë shtet. Kësisoj epilogu do të ishte margjinalizues dhe katastrofal, jo vetëm për këtë shtet, por edhe për tërë rajonin.

Duke e parë krejt këtë situatë, fare në fund mund të themi se Marrëveshja e Ohrit është dashur të implementohet praktikisht gjer në vitin 2004, pa kurrfarë margjinalizimesh. Tani është vonë, ngase kanë filluar të rishikohen formula të tjera të marrëveshjeve të reja dhe të modeleve të tjera, edhe pse kori diplomatik kërkon me ngulm realizimin dhe implementimin praktik të kësaj të parës, që më shumë shërben si leksion shtesë për klasën politike maqedonase të shfrytëzojnë vagonët e fundit për kyçje në strukturat euro atlantike, ose vaj halli nuk dihet se ku do përfundojë ky shtet i vogël me sherre të mëdha!

BRENDA KALASË SË PAMPOSHTUR TË KRUJËS- MBUROJËS SË KRYETRIMIT KOMBËTAR SKËNDERBE

Kombi shqiptar historikisht, prej qenësimit të tij, ka ditur t`i jap historisë kombëtare, rajonale dhe botërore burra dhe trima të shquar, me të cilët jemi dhe duhet të jemi patjetër krenar. Kësisoj, ky komb i vogël ndoshta në numër për dallim prej kombeve të tjera më të mëdha, ka dhënë nëpër epoka të ndryshme historike burra të shquar, të cilët kanë lëshuar gjëmën gjer në kryeqendrat botërore më të mëdha. Pa dyshim, në historinë më të re, kjo figurë e shquar është Adem Jashari dhe të gjithë trimat e Ushtrive çlirimtare, por ai që është në krye të këtij mozaiku është kryetrimi kombëtar dhe evropian Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Gjergj Kastrioti, i

lindur në Krujë (lexo : disa estimojnë se është i lindur në Dibër, e disa në Varosh të Matit), në vitin 1405. I marrë peng nga ana e turqve osmanë, ai u rrit pranë oborrit të sulltanëve, u shkollua dhe u pjek atje, po nuk harroi mëmëdheun. Për shkak të dallueshmërisë si vigan, ai me të drejtë do të quhej nga Sulltani dhe oborri i tij, Iskander Bey, që d.m.th. Lordi Aleksandër. Në moshën fare të re, ai shpallet gjeneral nga Sulltan Murati II, e më pas edhe Vali dhe sundimtar të disa krahinave të Shqipërisë Qendrore. Edhe pse gëzonte këto privilegje, atij nuk i`u hoq nga mendja dashuri për mëmëdheun, për Shqipërinë. E priti me padurim momentin për t`iu hakmarrë Sulltanit dhe Perandorisë dhe pikërisht në ekspeditën kundër Janosh Huniadit, ai do të braktiste ushtrinë osmane dhe do të nisej drejt Krujës, vendlindjes së tij. Me të arritur aty, ai ngriti edhe flamurin kombëtar të të atit të tij, flamurin me shqiponjën e zezë me dy krena duke mbajtur fjalimin e tij monumental « Lirinë nuk ua solla unë, atë e gjeta në mesin tuaj ». Hapi tjetër i madh i tij do të jetë bashkimi i princave shqiptarë në Kuvendin e Lezhës, në vitin 1444, me ç`rast krijoi edhe shtetin e parë shqiptar. Për 25 vite me radhë ai do të luftonte kundër Perandorisë Osmane, me 20 mijë trupat e tij. Sulltanët turq, duke filluar nga Sulltan Murati, Sulltan Mehmeti, etj, duke tentuar 24 herë të pushtojnë Krujën,por do të pësonin fatalisht. Me fitoret e tij ai do të bëhej mit për së gjalli, ku do të tërhiqte vëmendjen e Papatit në Romë dhe të Mbretërisë së Napolit. Për të mos vazhduar më tej, ngase nuk do të mjaftonin shumë libra, ai do të bëhej protektor i Evropës dhe civilizimit perëndimor. Duke qenë i bindur se

pa një Aleancë të Shenjtë Adriatiko Ballkanike dhe pa interesa strategjike të përbashkëta nuk mund të balancohej fuqia ushtarake e Perandorisë Osmane, Skënderbeu do të paraqitet si pararendës i kardinalit të famshëm francez Rishelje, në teorinë e tij për balancimin e forcave. Ai do të bashkëpunonte ngushtë me diplomatin e tij Pal Engjëllin, humanist, shkrimtar dhe diplomat i shquar. Mirëpo nga shtetet ballkanike, përpjekja e Skënderbeut për Aleancë , do të kuptohej me vonesë, pas vdekjes së tij. Skënderbeu do të vdiste në Lezhë më 1468, tek vendi ku krijoi shtetin shqiptar. Pas vdekjes së tij shqiptarët do të rezistonin për 12 vite me radhë kundër osmanëve,por më në fund do të thyheshin, ngase kryetrimi ishte në botën e amshuar. Kruja përfundimisht do të bie më 1480. Pa vdekjes së tij, e gjer më sot, për të do të thuren elozhe, vjersha, poezi, poema e vepra.... Volteri i madh, shkrimtar francez do të theksonte se sikur Perandoria Bizantine të kishte një udhëheqës të kalibrit të Skënderbeut, ajo do të mbijetonte edhe më tej. Volteri do të theksojë edhe arsyet e fitores së Skënderbeut, duke theksuar se shqiptarët janë popull luftarak si dhe që Shqipëria është vend malor. Albanologia bullgare Zheljazkova do të glorifikonte figurën e kryetrimit në pafundësi. Për kryetrimin tonë janë shkruar diku rreth 190 vepra historike, filozofike, teologjike e artistike. Për të do të shkruanin poeti francez Ronsard, ai amerikan Longfellou, ndërsa kompozitori italian Antonio Vivaldi do t`i kushtojë edhe një operë me emrin "Skëndërbeg". Për kryetrimin shqiptar janë dedikuar më shumë se 1000 tituj në shumë gjuhë të huaja. Kryetrimit do t`i ndërtoheshin shumë monumente,

sikurse ajo në Tiranë e punuar nga Odhise Paskali, skulptor i shquar shqiptar. Monumenti i tij gjendet në Prishtinë, Shkup, Paris, Vjenë e gjetiu me ç`rast na bën që të mburremi si shqiptarë dhe na bën krenar. Kot tentojnë dashakeqët që janë në gishta, që gjoja Skënderbeu paska luftuar kundër Islamit. Kjo është shpifje e kulluar, ngase nuk përkon me realitetin. Edhe sot, Kruja legjendare, është "kibël" kombëtare për shqiptarët e mbarë botës. Ne kemi edhe "kiblën" tjetër, atë të Prekazit legjendar ku gjendet varri i Adem Jasharit të madh, kemi muzeun e Lidhjes Kombëtare të Prizrenit e shumë e shumë vende të tjera dhe duhet të jemi krenar për këtë.

Kalaja e Krujës, e vendosur mbi një shkëmb të thepisur në vendin ku kryqëzohen Petrela, Preza, Rodoni dhe Lezha, është kryelartë për historinë e saj. Ajo zë një pozicion të shkëlqyer në historinë kombëtare shqiptare, si kryeqendër e Arbërisë, e me kthimin e Skënderbeut u shndërrua në kryeqendër të epopesë shqiptare. Kalaja e Krujës zanafillën e ka në shekujt V-VI, histori kjo e lidhur me braktisjen e qytetit ilir Albanopolis. Emri Krujë, paraqitet së pari herë në një dokument kishtar të vitit 879, kohë kjo kur Kruja ishte qendër peshkopale. Sistemi i fortifikimit të kësaj kalaje është përmirësuar disa herë pas sulmit të osmanëve, e posaçërisht me tërmetin e viti 1617 dhe me sulmet e egra osmane të vitit 1832. Kjo kala ka një sipërfaqe prej 2.25 hektarësh. Muri rrethues ka një perimetër prej 804 m. Muret e trasha prej 1.5 m janë të përforcuara me 9 kulla të rrumbullakëta dhe katërkëndore. Kullat gjeneralisht kanë qenë të larta me diametër prej rreth 15 m.

Në pjesën më të lartë të kodrës së fortifikuar në shek. XII-XIV gjendet selia e feudalit. Kalaja është e banuar, edhe atë që nga viti 1286, kur perandori bizantin Androniku II Paleologu u njeh të drejtën banorëve të kalasë për privilegje dhe të drejtën për të gëzuar gjithçka si brenda, ashtu edhe jashtë kështjellës.

Eh, pra nuk mund të ndihesh shqiptar, i nderuar auditor, nëse nuk merr rrugën për të shkuar dhe vizituar tempullin kombëtar, Krujën e lavdishme, si dhe njëkohësisht pas kësaj vizite, të marrësh drejtimin e Rrugës së Kombit, e të nisesh për Kosovë, e mandej drejt e për Prizren dhe të ndalesh më në fund në Prekaz, për të pushuar në tempullin tjetër kombëtar, i cili na dëshmon, se ky komb shqiptar, është vital, stoik dhe i fortë, i gatshëm që të mbrojë sa herë që sulmohet nga armiq të jashtëm. Leksionin e kanë marrë turqit në Krujë, po edhe bishat serbe Prekaz. Andaj, a ka më krenari se të jesh shqiptar dhe të jesh krenar për këto vende që reflektojnë shqiptarizëm? Unë besoj se nuk ka krenari më të madhe, po ju?

SHQIPTARËT NUK E KANË ENDE TË ZGJIDHUR PROBLEMIN KOMBËTAR, PO TI MOS VETËKRIJO PROBLEM FETAR

(Përkitazi me një shkrim të paloanalistit nga Shqipëria, Kastriot My(k)ftarajt)

Kohëve të fundit kemi shumë paraqitje të analistëve dhe pseudoanalistëve, të publicistëve dhe të pseudopublicistëve të ndryshëm, që mëtojnë mes rreshtash të thuan se shqiptarët si komb, nuk kanë problem, po atyre u pengon ajo që i takojnë shumica e atij kombi, përkatësisë fetare Islame. Kësisoj na paraqiten individë sikurse Kastriot Myftaraj, të cilin me të drejtë Abdi Baleta e quan, Kasriot M..., i cili me thirrjet dhe kushtrimin që bën, kërkon që shqiptarët me çdo kusht t`i shpallin luftë Islamit si fe, apo religjion dhe të djegin minaret. E si mos të reagosh ndaj këtyre thirrjeve, për një ***Shën Bartolome*** mes shqiptarëve. Si mos ti quash këta njerëz të pavyeshëm për kombin shqiptar. Ata në vend se të ofrojnë alternativa se si të zgjidhet çështja kombëtare shqiptare në Ballkan, duke mos cenuar aspak diversitetin fetar mes shqiptarëve, ftojnë në konflikte të panevojshme ndërvëllazërore, duke pasur për bazë çdoherë pretekstin fetar, si dhe atë, që nëse shqiptarët e flakin tutje Islamin, atëherë atyre do t`u zgjidhet atyre problemi kombëtar sa çil e mshil sytë. Po jo i nderuar, Myftaraj, Vello, Lubonja dhe ju të tjerë abdallë, analistë e publicistë, problemi kombëtar shqiptar nuk zgjidhet asisoj, siç doni ta "zgjidhni" ju. Ai

zgjidhet atëherë, kur shqiptarët duke respektuar edhe kryqin edhe gjysmëhënën, si pjesë të pasurisë së tyre kombëtare, do të hapërojnë së bashku në zgjidhje të problemeve të tyre kombëtare, atëherë kur do të sensibilizohet dhe vetëdijesohet klasa politike shqiptare e cilës do qoftë provenience politike, elitat intelektuale, e kështu me radhë, se nuk kanë shqiptarët problem fetar absolutisht, po kanë problemin e tyre kombëtar të pazgjidhur, i cili kërkon zgjidhje imediate. Shkojmë me radhë, **e para,** në Shqipëri, në shtetin i cili deri më tani ka qenë simbol i respektimit të alteritetit ndërfetar dhe diversitetit fetar, elitat politike dhe partitë politike, duhet të vetëdijesohen se me politikën bizantine, ***më mirë i pari në katund, se sa i treti në qytet***, nuk zgjidhen problemet, ngase për çdo ditë që humbim në drejtim të liberalizimit të vizave dhe fillimit të negociatave për anëtarësim në UE, i gëzojmë "miqtë "tanë serb dhe grek, ngase jemi jashtë portave të qendrave decizive. Shqipëria kohëve të fundit donë të bëjë regjistrimin fetar dhe etnik, gjë që është e panevojshme, ngase dihet se ky regjistrim përkrahet edhe nga Serbia, (lexo: kjo e fundit mëton se ekziston pakica e saj në Shkodër, andaj duhet t`u jepen të drejtat atyre, e në fakt ata janë shqiptarë ortodoks të cilët për shkaqe të varfërisë apo të manipulimit pranojnë të bien pre e këtyre politikave dashakeqe që do të kenë kosto të lartë për ne si komb, në të ardhmen). Ky regjistrim përkrahet poashtu edhe nga Greqia, sepse ajo vite e vite me radhë tenton që në komunën e Himarës, si dhe në pjesën e ashtuquajtur Vorioepir, të sensibilizojë ***"çështjen e pazgjidhur greke"***, duke tentuar që të anatemojë problemin e pazgjidhur

çam, e të ***"shpalos"*** problemin e pazgjidhur grek. Shqipëria ka shumë probleme të pazgjidhura, po që nuk kanë të bëjnë me besimet fetare. Ata janë pasuri e mozaikut tonë kombëtar, e jo pengesë apo barrierë për integrime. Fundja, e kemi dëshmuar, si askund tjetër se jemi kombi më proevropian dhe më proamerikan në botë. Askund tjetër në botë nuk priten presidentët amerikanë më mirë se sa në Shqipëri e Kosovë, asnjë komb tjetër si ne nuk ka nxjerrë një Nënë të famshme si Nënë Tereza jonë, që duan të na i marrin të gjithë, asnjë komb tjetër nuk ka nxjerrë nobelistë si Ferid Murati, e shumë e shumë shkencëtarë tjerë, asnjë komb nuk ka nxjerrë heronj si Skënderbeu që mbrojtën Shqipërinë nga hordhitë barbare, asnjë komb nuk nxjerr heronj si Adem Jashari i Madh, i cili për komb e flamur, luftoi deri në frymën e fundit, si shqiptarë, e assesi si diçka tjetër. Mandej, Shqipëria ka probleme me kastat politike, të cilat janë egërsuar tej mase dhe e kanë hutuar edhe popullatën e shkretë, në luftën e tyre për karrige dhe pushtet, prestigj e lavd.

E dyta, në shtetin tjetër shqiptar, atë të Kosovës, kemi probleme të shumta. Kosova na paraqitet si ***kondominium***, ngase përnjëherë ushtrojnë sovranitet në territorin e këtij shteti shumë subjekte, shqiptarët, Serbia përmes serbëve, ndërkombëtarët e UNMIK-ut të skaduar që moti dhe EULEX-i. Alternativat duhet të ofrohen në drejtim të zgjidhjes së problemit të sigurimit dhe ushtrimit të sovranitetit, në tërë Kosovën, ngase pa sovranitet nuk ka shtet, e as pushtet. Kosova ka problemin tjetër, atë të mos pranimit nga shtete të ndryshme. Elitat intelektuale dhe politike duhet të sensibilizohen

në drejtim të avancimit të numrit të shteteve që do të njohin Kosovën. Kosova ka problem me kufijtë e saj, ngase në kufi me Serbinë, nuk ka kufi shtetëror, bile as administrativ, ajo është si një lloj ure, e mbi urë secili dihet se kalon, andaj Kosova duhet të pengojë hyrjedaljet e kriminelëve serb, që ende pa kërkuar falje dhe pa bërë katarsën e tyre, nga gjenocidi dhe etnocidi ndaj shqiptarëve, ende mëtojnë se Kosova na qenka e tyre si dhe djep i serbizimit. Kosova, ka problem me individë të ndryshëm, që të manipuluar nga shërbime të ndryshme, lëshojnë mjekrat dhe shkurtojnë pantallonat, saqë lehtë mund të krijosh përshtypjen se mos vallë vijnë nga Pakistani apo Bangladeshi, kur t`i shohësh këta njerëz të mjerë. Kosova ka probleme poashtu edhe me ata të cilët ftojnë në konvertime masive në fenë e "të parëve" duke mëtuar në katolicizëm, apo protestantizëm, sepse vetëm kthimi ynë në krishterizëm, po na i zgjidhka problemet që i vetshpikim dhe që na i sajojnë të tjerët. Pra, problemit kombëtar shqiptar i mëveshët velloja fetare. Kosova ka problemin e saj të pazgjidhur territorial, ka probleme me mospasjen e ushtrisë, ka probleme me korrupsion, po aspak nuk ka problem fetar. Kosova, më në fund ka problem me pseudoanalistë që thërrasin si qyqet e natës dhe kërkojnë që Shqipëria të rishikojë preambulën e saj kushtetuese, ku ceket bashkimi kombëtar, ngase kështu, ajo po shfaqka pretendime territoriale ndaj Kosovës. Ej, çfarë idiotësie dhe poshtërsie. Protagonistët e kombit hibrid kosovar, duke promovuar ide të këtilla, me qëllim të bien në sy, shfaqin mendime që edhe Millosheviçi nuk i ka cekur, e as Çubrilloviçi, Vukotiçi, Moleviçi, e ndonjë tjetër, ngase këtë e bëjnë ***par excellence*** dhe

shumë më mirë viçat shqipfolës kosovarë, protagonistët e Mbretërisë Gege..

E treta, shqiptarët në Maqedoni kanë shumë probleme me qeverinë aktuale, ngase ajo i margjinalizon, i anatemon, i bënë të pahetueshëm fare, duke i ndihmuar kësaj edhe partitë politike shqiptare, që mendojnë për këtë pjesë të kombit vetëm një natë para heshtjes parazgjedhore. Shqiptarët e këtij shteti, me emrin më të gjatë në botë, ende kanë problem me servilizmin dhe poltronizimin e partive të tyre politike, të cilat janë të kujdesshme ndaj tyre, vetëm atëherë kur janë në opozitë. Këta shqiptarë, kanë shumë probleme tjera arsimore, ekonomike, politike, sociale..., besa kanë probleme edhe me individë që ftojnë në patriotizëm lokal dhe bajraktarizëm, nga njerëz që vuajnë nga krahinorizmi ose nga të qenit bajraktar në mëhallat e tyre. Kjo pjesë e shqiptarëve ka probleme me moszgjidhjen e çështjes së flamurit, gjuhës... e shumë e shumë gjërave tjera, po assesi nuk i pengon prezenca e xhamive, teqesë, apo ndonjë tempulli tjetër fetar. Kësaj pjese të kombit i pengon, ajo që qeveritë maqedonase me paratë dhe tatimet e po këtyre shqiptarëve, e promovojnë Maqedoninë, si shtetin e Krishtit, shtetin më ortodoks në botë si dhe në shpëtimtar të krishterizimit nga shqiptarët mysliman. E ndërkaq harrojnë që figurat e shquara kombëtare shqiptare i kanë takuar si konfesionit mysliman, po ashtu edhe atij katolik, ortodoks, e kështu me radhë, edhe ateist bile, sepse siç do të thoshte Millovan Gjilasi, *ateizmi është fe e kthyer me kokë teposhtë.*

E katërta, shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë me miliona probleme të pazgjidhura kombëtare,

përballë pushtetit represiv serb, të cilat po të numërohen nuk do të dilnin faqet e një libri të tërë, ku veç për shembull në Cepotin, Serbia për shqiptarët ndërton bazën më të madhe ushtarake në Ballkan, e dihet kjo se përse. E kjo z. Kastriot M... nuk ju shqetëson fare ju, që të merreni me këtë problematikë, apo jo?

E pesta, shqiptarët e Malit të Zi, si dhe çamët, ku të parët ndihmuan pavarësinë e Malit të Zi (lexo: po mos të ishin këta të parët, Mali i Zi edhe më tej do të ishte Union Serbi- Mal i Zi), ndërsa për të dytët lëre që nuk bëhet asgjë, po edhe janë harruar krejtësisht nga elitat politike dhe intelektuale, (të sojit tuaj). E ju z. Kastriot, që emrin e keni shumë të mirë, po që përpos emrit asgjë tjetër pozitive nuk mundet njeriu të ju gjej, në vend se të merreni me problematikat e lartpërmendura e të papërmendura, juve ju shqetëson Islami ndër shqiptarët dhe lëshoni kushtrimin për kthim në fenë e të parëve, duke e ditur se po të kthehemi në fenë e të parëve tanë Pellazgo- Ilirë, duhet të besojmë në religjionin druid apo pagan, gjë që mua personalisht nuk më pengon (lexo: që të parët tanë kanë qenë të tillë). Çfarë turpi!

I (ç)nderuar, po të ishte pengesë Islami për shqiptarët, Shqipëria (me rreth 75 % mysliman) nuk do të pavarësohej më 1912 (nuk do të pranohej nga Amerika), si dhe Kosova nuk do të ndihmohej nga Amerika dhe NATO-ja (Mos harro, bile NATO-ja, intervenoi për të parën herë duke e shkelur parimin e mosintervenimit jashtë vendeve anëtare, në një vend ku shkelej çdo e drejtë dhe ku kishte gjenocid dhe etnocid, duke i ndihmuar popullatës e cila përbën rreth 95%

myslimanë) . I nderuar, në vend se të merreni me "fatkeqësitë e Islamit" për kombin shqiptar, merruni me martesat e motrave tona shqiptare nga Shqipëria "jote" dhe e imja, me serbët, me sllavomaqedonasit dhe me shkijet e Shumadisë. Mos e anatemo problemin kombëtar duke ia veshur aspektin fetar, sepse ky komb e ruan me krenari multikonfesionalitetin, e respekton edhe gjysmëhënën edhe kryqin, po merru me problemet e tjera kombëtare. Winston Çurçill në një rast pat cekur se nëse ndokush donë që një problem të mos e zgjedh asnjëherë, ai atij problemi le t`i vesh çështjen fetare, e ai problem kurrë nuk do të zgjidhet. E unë e dijë, po edhe shumica e shqiptarëve e dinë, që ti dhe soji i yt, nuk lëshoni kushtrim të tillë për zgjidhje të çështjes kombëtare shqiptare, sepse jeni larg patriotizmit, nuk e keni dëshmuar dhe nuk po dëshmoni që e doni kombin tuaj (lexo: po e dëmtoni), po ju këtë komb doni ta përçani (lexo: duke i servuar Shën Bartolomeun), ngase jeni pjellë e agjenturave greko-sllave.

MISIONARI NACIONALIST ME KOKARDËN E FSHEHTË TË "CËRNA RUKËS", NË MISIONIN E TIJ ANTIKOMBËTAR

Përgjigje "vrasësit me pagesë në publicistikën shqiptare" Kastriot My(k)ftaraj dhe nacional-shovinizmit të tij pansllav dhe pangrek

Është më se e vërtetë se bota siç thotë Gandi i famshëm, po mos të ishte e ndryshme nuk do ta njihnim njëri tjetrin më mirë. Respektimi i mendimit tjetër, i asaj që quhet alteritet, është një vlerë dhe virtyt njëkohësisht. Por, respektimi i tjetrit bëhet vetëm atëherë kur ajo që flitet apo shkruhet nga tjetri ka peshë argumentative, si dhe nuk ka paragjykime dhe blasfemi. Kësisoj mëtimi i "vrasësit me pagesë" në publicistikën shqiptare, Kastriot M..., që emrin e ka shumë të bukur ngase përkon me mbiemrin e kryetrimit kombëtar Gjergj Kastrioti- Skënderbeu, për të polemizuar me mua, (lexo: me një frankofon islamik), e jo me një vëlla të tij shqiptar, i ngjan herë ulërimave të ujqve e herë pëllitjeve të gomarit.

I (ç)nderuar Kastriot Mykftaraj. Misioni i yt prej mikrobit, i paguar nga agjenturat serbe dhe kryesisht ato greke nuk po pinë ujë. Polemikat e tua me shpifje, etiketime, me asgjë shkencore përbrenda, të filluara me kolegun tim në UEJL, Salajdin Salihun i kam ndjekur me vëmendje dhe sado që ai ta dha përgjigjen e merituar ti nuk u mbushe me mend. Leksionin më të mirë ta

dha edhe kolegu tjetër Veton Latifi, i cili të injoroi duke mos polemizuar, ngase je me të vërtetë një pikë ujë në oqean që nuk çon kurrfarë peshe. Por, unë nuk po të kursej edhe ketë radhë. Misioni i yt i "vrasësit me pagesë në publicistikën shqiptare" për të shpifur ndaj profesorëve të Universitetit të Evropës Juglindore, qendrën e ka në Athinë dhe në Beograd. Kot mundohesh të më paraqesësh mua si njeri që marr instruksione nga të huajt. Mos u mundo, ngase më njohin vëllezërit e mi shqiptarë si dhe miqtë e mi ndërkombëtarë që kam. Kontaktet e shkëlqyera që i kam pasur dhe i kam me personalitete franceze dhe me ndërkombëtare të tjerë nuk dëshmojnë se unë jam pjesë e agjenturave franceze, ngase francezët janë miqtë tanë, sikurse ata amerikanë, anglezë, gjermanë etj. Në fakt ti, që vuan patologjikisht nga ndonjë sëmundje e padiagnostifikuar, i ke shpallë luftë të gjithëve. Lufta e njërit kundër të gjithëve. Përgjigjen e merituar do e marrësh dalëngadalë me radhë.

Për hir të respektit dhe informimit të saktë të auditorit shqiptar, ju njoftoj se Kastriot M... është i akuzuar dhe i paraburgosur për fyerje kundër Islamit si fe, ndërsa pas lirimit të tij ai lëshon vazhdimisht kushtrim kundër Islamit si religjion. Teza e tij e mbrapshtë se shqiptarë janë vetëm ata që i takojnë besimit katolik, apo se myslimani shqiptar për t`u bërë shqiptar duhet të ndërrojë fenë është lajthitje dhe veprim antikombëtar. Unë në këtë reagim timin nuk do të merrem me mbrojtjen e Islamit në Arabi apo ndokund tjetër. Unë do i marr në mbrojtje vëllezërit e mi shqiptarë të përkatësisë islame nga fyerjet dhe sharjet e të mallkuarit Kastrot M...

Të gjithëve na kujtohen proceset e konvertimeve masive të shqiptarëve myslimanë dhe katolikë në ortodoksë, të kryera me dhunë nga ana e serbëve dhe pjesëtarëve të organizatës "Cërna Ruka: (Dora e zezë). Shqiptarët e Kosovës kanë dëgjuar për Sava Llazareviqin, i njohur me emrin Savë Batarja, i cili shqiptarëve që nuk e ndërronin fenë e tyre në ortodoksë, i vriste dhe i masakronte. Këtë e bën edhe Kastriot M..., por vetëm për dallim prej Savës, flet shqip të paktën. Ai kërkon që shumicën myslimane shqiptare të konvertojë në fe tjetër, dreqi dhe ai e din se në çka, duke tentuar të sulmojë dhe përçajë kombin shqiptar në baza fetare. Pikërisht, mozaiku ynë i pasur kombëtar është edhe pasuria fetare si dhe respekti ndaj feve tjera. Nuk mund të gjesh popull në botë si shqiptarët që janë tolerant ndaj feve. Po, përjashtim këtu bën vetëm "shqiptari" shqipfolës Kastriot M..., i cili kërkon ta thyejë këtë mozaik, ngase ashtu i janë dhënë urdhrat agjenturore dhe i është ngarkuar misioni serbo- grek. Unë, i nderuar Kastriot, është e vërtetë se jam frankofon, se jam shqiptarë mbi të gjitha, po njëkohësisht krenohem që jam me përkatësi fetare islame. Mos harro, se edhe Faik Konica i madh e përmend faktin se "Islami shpëtoi kombin shqiptar nga asimilimi prej grekëve dhe sllavëve". Ti e di shumë mirë, o bastard i laboratorëve të nomenklaturës antishqiptare, që misioni i yt prej Janullatosi, në mëtimin për rrënimin e xhamive dhe ndërrimin e fesë islame ndër shqiptarët, që është me shumicë ndër shqiptarët është i pamundur. Atë e kanë provuar shekuj me radhë vëllezërit e tu sllavë dhe grekë. Atë e kanë provuar edhe popët serbë kur i zinin shqiptarët e gjorë, i spërkasnin

me ujin e bekuar dhe u shqiptonin emrat e rinj sllavë. Kësisoj, kur gjendej ndonjë shqiptar me emrin Muhamed e pagëzonin atë me Millan, Aliun e pagëzonin Ilija, Liridonin e bënin Sllobodan, e kështu me radhë. Po si do ti pagëzosh more i shkretë pasi të ua ndërrosh fenë, shqiptarëve myslimanë? Mos harro duhesh ta ndërrosh edhe mbiemrin tënd, po edhe timin. A këtë nuk mund ta bësh dot. Tëndit mund t`ia vendosësh prapashtesën - viç apo –thios, por tek unë nuk ke as pikën më të vogël të mundësisë ta ndërrosh. Kësisoj, unë sikurse e kam bërë njëherë, do të dëshmoj se mburrem me emrin tim ARDIAN, që ka të bëjë me fiset e paraardhësve tanë ilirë, ardianët, po mburrem edhe me mbiemrin tim RAMADANI, që ka të bëjë emrin e babait të gjyshit tim, që është plagosur nga serbët, pikërisht, sepse nuk ka pranuar të ndërrojë emrin. E kështu do të bëjnë ë gjithë shqiptarët, të cilës do qoftë fe, vetëm soji yt jo. Ky soj i yti renegat, zombi dhe kameleon do të bëjë ndërrime të fesë dhe emrave, sikurse prostituta e natës që i ndërron klientët. Një gjë ta dish, se nuk ke mundësinë sikurse klerikët sllavë që së bashku me formacionet çetnike i`u prisnin duart shqiptarëve mysliman, në mënyrë që mos të mund të faleshin më, ndërsa shqiptarëve katolik i`u prisnin dy gishtërinjtë që të mos mund të bënin kryq me pesë gishtërinj, por me tre, si sllavizma. Kjo mundësi ka vdekur njëherë e përgjithmonë, ngase shqiptarët me ndihmën e miqve perëndimorë, me ndihmën e luftërave çlirimtare e pamundësuan shfarosjen nga ana sllave.

Unë nuk habitem, që ti je pjesë e agjenturave sllave dhe greke, ngase si anishqiptar i tërbuar, i veshur me petkun e antiislamizmit, ti nuk bën asgjë tjetër,

përpos që vazhdon me planin e Kishës Serbe, planin 610 +2000, me të cilin plan synohej spastrimi i plotë i Kosovës më 28 qershor 1999 në festimin e 610 vjetorit të Betejës së Kosovës. Ky plan i kishës serbe, që përkrahet nga ana jote me (pa)vetëdije, besohej dhe besohet se do të ketë miratimin e Evropës dhe Amerikës, por lajthiteni keq. Dhe kjo nga fakti se pikërisht Evropa dhe Amerika janë bastion i demokracive model, ku soji yt nuk bën pjesë aty dhe nuk duhet lejuar të bëjë pjesë ndonjëherë, ngase je i mbrapshtë. Shtetet e lartpërmendura janë vende që respektojnë diversitetin fetar dhe kombëtar. E din që pikërisht xhamia më e madhe në Francë do të ndërtohet në Marsej. Shteti laik francez, me shumicë krishtere, lejon ndërtim të xhamive, e ti kërkon rrënimin e tyre. Në anën tjetër në vendin e kullave binjake në Amerikë, në New York, Presidenti i SHBA-ve Barak Obama të premten që kaloi, miratoi planet për ndërtimin e xhamisë dy blloqe pranë vendit të ish-Kullave Binjake në qytetin e Nju Jorkut, duke deklaruar se "myslimanët kanë të drejtë për të praktikuar fenë e tyre si çdokush tjetër në vend", e ti kërkon djegien e xhamive.

I (ç)nderuar K... Mykftaraj. Në luftën e Kosovës dhe në luftën e Maqedonisë, pushteti sllav gjuante me granata xhamitë dhe minaret, djegke xhamitë dhe teqetë, po nuk mundi të bëjë asgjë. Vetëm në luftën e vitit 2001 në komunën time të Likovës, në bastionin e shqiptarizmit janë djegur dhe shkatërruar me granata të gjitha xhamitë nga forcat maqedonase, së bashku me shkollat. Po ata u ndërtuan edhe më të bukura, saqë vafshi në djall ju që nuk doni t`i shihni, sepse ju duken si "kokat bërthamore të Iranit". Ti o Kastriot M..., që

tenton të praktikosh terapinë e shokut për shkatërrim të trashëgimisë fetare në trojet shqiptare, ti që mëton konvertimin e shumicës shqiptare myslimane në fe tjetër, i ndërron qëndrimet si ujku qimen, ngase pikërisht në vitin 2000, kur ke sulmuar studiuesin gjerman Peter Bartl për veprën e tij studimore "Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1878-1912", ke kundërshtuar idenë e tij se shqiptarët e myslimanizuar gjoja qenkan bërë turq, por që në fakt Bartli nuk bën asgjë tjetër përpos që thekson se "vetëm tek shqiptarët vetëdija e prejardhjes (origjinës) së përbashkët dhe gjuhës së përbashkët ishte më e fortë se përkatësia fetare". Ti je mësuar të kritikosh pa mend në kokë, sikurse ata sorrat që bëjnë vazhdimisht krra-krra-krra.

O, Kastriot M..., paloreagimin tënd që e kë bërë në "Gazeta sot", dëshmon që përpos mungesës së informacioneve, patetizmit tënd, shërbëtorit të qarqeve sllavo- greke dhe njeriut misionar për të etiketuar profesorët në UEJL, nuk ke asgjë tjetër. Paloreagimin tënd e fillon me atë se gjoja unë paskam shkruar më 25 qershor 2010 tek gazeta "Lajm", që nuk është e vërtetë, ngase unë kam shkruar në gazetën "24 orë". Pra, qysh në start je gabim. Mandej, se si gjurmues dhe hulumtues i facebookut, e ke bërë namin kur ke zbuluar që paskam botuar një libër, (e ke gabim deri më tani kam botuar dy libra dhe nuk do të ndalem me kaq), vazhdon të citosh Kisinxherin që shkruan për Risheljenë, duke ndarë fenë nga interesat shtetërore. Pikërisht këtu vihesh në dyshim për shkak të dilemave tua në lidhje me informacionet, ngase harron se Risheljeja ishte princ katolik, por interesat shtetërore dhe kombëtare i shikonte në

prizmin krejtësisht laik. Ai nuk kërkonte konvertime masive, po mbronte interesin kombëtar francez. E edhe unë, që më bën nder duke më quajtur Rishelje, përkrah mendimin se problemi kombëtar duhet të shtrohet pa ngjyra fetare, sepse është antikombëtare prekje e feve ndër shqiptarët. Edhe unë sikurse Risheljeja francez katolik, jam shqiptar, por mysliman. Por, nuk ngatërrojë kurrë fenë me shtetin.

Unë nuk bëj debate fetare, atë i`a lë prijësve fetarë që i kemi të bollshëm. Unë kërkoj përgjigjen se përse ti, kërkon zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur kombëtare shqiptare duke kërkuar djegien e xhamive. A e din se ti nuk ke kaçik të dhezësh një cigare e jo më një xhami. Po, eja e provo në trojet shqiptare në Kosovë, Maqedoni po edhe në Shqipëri e gjetiu, provo të kallësh një xhami. Eja të ftoj në fshatin Sllupçan, e provo të djegësh një xhami, e do e shohësh se ku do vesh. E provuan sllavomaqedonasit, e morën leksionin në vitin 2001. Fundja, ndoshta të kursejmë ngase flet shqip.

O paloshkencëtar, ofro alternativa për bashkim kombëtar, e mos ofro përçarje. Unë do të gëzohesha shumë, sikurse të shihja edhe studiues dhe shkencëtarë tjerë si Koço Danaj, Kristo Frashëri, Abdi Baleta, Paskan Milo etj, që Shqipëria i ka me emër, të i kemi në mënyrë permanente prezent në Kosovë, Shqipëri etj. Po, kurrë nuk do të doja të të shihja ty o Kastriot M.., në këto treva, ngase prezenca jote këtu është vetëm sherr. Shqiptarët dhe lidershipi shqiptar gjetiu, është fakt se duhet të ndjekin parimin e Raison de nation, duke bërë njësimin e abetareve, planprogrameve mësimore, teksteve mësimore, heqjen e barrierave të ndryshme

ndërkufitare, këmbimin e kuadrove të ndryshëm, organizimin e debateve, servimin e produkteve shqip, afrimin e shqiptarëve përmes ndërtimit të rrugëve të tjera të kombit, e nuk duhet të ndalen deri ke bashkimi kombëtar. Bashkimin kombëtar e sjellin debatet dhe veprime konkrete duke u bazuar në patriotizëm, fr.patrie- atdhe, ose në atdhedashuri e jo në stimulim të përçarjeve ndërfetare mes shqiptarëve. Shqiptarëve u duhet një Rishelje, që nuk do të përziente interesat kombëtare me fetë, po jo një Ferdinand Habsburg, sikurse je ti, o Kastriot M..., që për çështje higjienike nuk dua të ta përmend as emrin e as mbiemrin, po po jam i detyruar për hir të dashamirëve që më lexojnë vazhdimisht, t`i përgjigjem paloreagimit tënd. Pse kërkon vetëm Islamin dhe krerët e bashkësive fetare islame të mendojnë si Rishelje. Kërkoi edhe klerikëve të tjerë fetarë të njëjtën gjë. Fundja, nëse mendon se krerët e bashkësive fetare islame nëpër trevat shqiptare po e penguakan bashkimin kombëtar, kush po na e stimuluaka të njëjtin. Janullatosi grek? Ti? Pajë, kurrë për besë.

Thirrjet e tua për djegie të xhamive, janë përsëris edhe njëherë, e këtë mund ta them kur të duash dhe ku të duash, qoftë në Shqipëri në ndonjë emision debativ, qoftë në Kosovë e ku të duash ti, janë thirrje për Shën Bartolome, sepse e din mirë, se shqiptarëve të kësaj ane, të Kosovës dhe të Shqipërisë, nuk mund t`ua djegësh xhamitë dhe t`ua ndërrosh fenë. Nuk e di se çka nënkupton truri yt, me shprehjen mysliman praktikantë minorancë e çka jo praktikantë mazhorancë?! Shqiptarët me shumicë i takojnë përkatësisë fetare islame dhe pikë. Këtë nuk mundesh ta ndërrosh as ti, as askush. Nuk e

di, se përse të duket prezenca e xhamive në trevat shqiptare si profil arab, kur nuk të pengon kryqi i madh gjigant në Vodno të Shkupit, sikurse kryq bizantin? Mua nuk më pengon as kryqi, e as xhamia, as manastiri, e as teqeja, mua më pengojnë individët si ti që duan që gjoja duke bërë përpjekje për bashkim të kombit shqiptar, e ndani edhe më tutje në baza fetare. A nuk është kjo tentativë për Shën Bartolome, o qyqarë? Shqiptarët nuk kanë nevojë për kurrfarë zgjidhje të problemit religjioz. Atë e kanë të zgjidhur, duke shkuar shumica në xhami duke i kryer lutjet, një pjesë në kishë, ca në manastire, ca në teqe.... ca ku e di unë se ku. A nuk është kjo pasuri? E ti kërkon ta minosh tërë këtë mozaik.

Shteti shqiptar, i bashkuar, nën emrin Shqipëri Natyrale, Etnike, Reale... nuk vlen as sa një meshë e Parisit, e as më pak. Ajo vlen më shumë se gjithçka në botë. Mandej vazhdon të theksosh se gjoja ke arritur në konkluzionin e mbrapshtë se Islami është origjina e gjitha të këqijave për shqiptarët dhe se maqedonasit nuk do të guxonin të silleshin kështu sikurse të mos ishim ne shqiptarët e Maqedonisë myslimanë. Çfarë mbrapshtësie. Shqiptarët edhe kur nuk kanë qenë myslimanë para islamizimit të tyre, kanë qenë të pushtuar nga pushtues. E nuk arritën të asimilohen. E ruajtën gjuhën, kulturën, traditat. Po, as në 2001. As tani. As kurrë. Maqedonasit e kanë marrë leksionin në vitin 2001. Ne të njëjtit jemi, sikurse ata të vitit 2001,1999, 1998 e vite mbrapa, nuk kemi ndërruar.

Në lidhje me konstatimin tënd se ndërkombëtarët po e ndrykan Kosovën dhe shqiptarët, jeni prapë në lajthitje, ngase po këta ndërkombëtarë janë ata që na

ndihmuan të çlirohemi nga Serbia dhe po na ndihmojnë vazhdimisht në konsolidimin e institucioneve të Kosovës, në avancimin e të drejtave të shqiptarëve, e nuk po i pengon aspak përkatësia fetare islame. Ajo po të pengon vetëm ti, ngase ti je i mpirë, nga ideja e Ferdinandit Habsburg për homogjenizim universal fetar të shqiptarëve, sikurse serbët dhe grekët, pasise je pjellë e tyre.

Në lidhje me martesat e bëra me serbët, unë prapë konstatoj se ka vajza shqiptare me përkatësi ortodokse, që martohen me serbë, malazezë apo maqedonas. Ata nuk janë rome, siç i quan ti. Mos u mundo ta anatemosh dhe ta fshehësh këtë. E dinë gjithë këtë. Po le të thyejnë qafen e të martohen ku të duan, ngase nuk më pengon kjo. Mua më pengojnë idetë e mbrapshta të tuat, ide pansllave dhe pangreke. Më tej thekson se unë paskam marrëdhënie me maqedonasit si përkthyes gjyqësor. Po te sqaroj edhe pse nuk jam i obliguar, se gjuhë zyrtare fatkeqësisht ende tek ne është maqedonishtja, e dokumentet janë maqedonisht, e unë përkthej prej maqedonishtes në shqip dhe anasjelltas, nga frëngjishtja në maqedonisht dhe anasjelltas dhe shqipfrëngjisht dhe anasjelltas, ngase e kam punë këtë, e kam fituar të drejtën për përkthyes në sajë të njohurive të mija. Mandej përkthimet (për këtë mund të interesohesh personalisht si agjent që je) i bëj në bashkëpunim me firma shqiptare, por po ta përsëris se dokumentet shumica janë në gjuhë maqedonase. Ka edhe në shqip. E tani, mos u mundo të tregohesh patriot, gjoja se duke më sulmuar për të drejtën time si përkthyes gjyqësor që e kam dhe për përkthimet në maqedonisht. Më tutje vazhdon duke e vënë në pah rastin e një këngëtareje

A.T? Po, lëre këngëtaren, mos i stereotipizo sendet. Ajo ka të drejtën e mendimit të saj dhe nuk ke çka i përzihesh ti edhe asaj, si agjent që je. Fundja, a të pengon ti të marrësh për grua një shqiptare myslimane? Përgjigju.

Më tutje Kastriot M... më kritikon për gjoja qëndrimin tim në njërin prej shkrimeve të mia për Nacionalizmin shqiptar, duke arritur në konkluzionin e tij të çuditshëm se unë qenkam për patriotizmin etatik maqedonas dhe kundër bashkimit kombëtar. Po, është e vërtetë se unë jam kundër bashkimit kombëtar të cilin e servon ti o K. Mykftaraj, me djegie të xhamive, apo të ndokujt tjetër me rrënime të manastireve ose tempujve fetar. Unë jam për bashkim kombëtar nën një kombshtet shqiptar më shumë se ti dhe soji yt. Për këtë janë mundur të parët e mi, familja ime e ngushtë dhe e gjerë, por edhe unë aq sa mundem dhe di.. Të përkujtoj se për këtë ideal është djegur në vitin 2001 i tërë katundi im dhe komuna ime. Të përkujtoj se në vitin 1988, për këtë është vrarë daja im nga UDB-ja. Për këtë janë burgosur xhaxhallarët e mi, prindi im, është përzënë një pjesë e familjes sime për në Turqi. Për këtë, unë në Francë në vitin 2002, kërkova ndryshimin e fjalimit të kryetarit të qytetit të Rennes-Francë, në shqip e jo në maqedonisht. Mandej, idetë e mia lexoi zotrote më mirë, kur të lexosh shkrimet e tjera, e jo duke shpifur pa më njohur mua dhe pa më lexuar. Po nuk kam nevojën të të shpalosem ty, sepse je një asgjë të më vlerësosh mua. Më kanë vlerësuar mua profesorët e mi në shkollë fillore në sajë të angazhimit tim, profesorët në shkollë të mesme, në fakultet dhe në studime pasdiplomike, duke u shpallur dy herë nxënës i dalluar i komunës, student i dalluar

gjatë studimeve superiore dhe magjistrant i dalluar me notën më të lartë mesatare në grup. Ti, nuk je askush të më vlerësosh. Ka kritere se kush vlerëson, si vlerëson dhe ku.

Më tutje vazhdon me citatin e Sharl de Golit. De Goli ishte dhe do të mbetet çdoherë nacionalist pozitiv dhe patriot, unë për këtë e admiroj. Të gjithë burrështetasit francez pikën e orientimit e kanë tek nacionalizmi dhe patriotizmi i Risheljesë, pra tek dashuria ndaj atdheut. Por, De Goli, duke qenë koshient për epokën e supranacionales që po vinte, arriti që të kamuflojë nacionalizmin e tij, duke performuar me patriotizmin francez. Këtë e thekson edhe në takimin me presidentin amerikan Ajzenauer, kur i thotë" Unë jam vetëm një profrancez, dëshira ime është të kontestoj, nëse nuk kontestoj unë nuk jam aleat, por protektorat". Këtu mund fare lehtë të kuptohet nacionalizmi patriotik i De Golit, që për bazë e ka doktrinën e Risheljesë, që d.m.th. eksponimi i Francës në marrëdhëniet ndërkombëtare përmes gjuhës dhe kulturës? E ti o Kastriot M..., me çka do të eksponohesh dhe ekspozohesh në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare? Me djegien e xhamive, me konvertime masive, me rekonkuista, me shovinizëm pansllav dhe pangrek? Jo i nderuar, nuk do ta lejojmë këtë kurrë as ty e as sojit tënd. Atdhedashuria nuk përkon me shek. XVIII, po daton më herët, zotrote. Më tutje i nderuar, mos harro se bazat serbe në Cepotin dhe afër kufirit me Kosovën janë gati për të sulmuar shqiptarët çdoherë, me pretekstin jo që janë myslimanë, por që janë shqiptarë. Atyre i pengon shqiptari, i cilës do qoftë përkatësie fetare. Po mos u friko aq shumë, se

shqiptaria ka djem e vajza që do të mbrojnë dhe dinë të mbrojnë trojet e tyre. Kanë miq të përhershëm SHBA-të, Evropën që nuk e lejuan dhe nuk do ta lejojnë këtë. E sa për ty dhe për sojin tënd, moti ishim bërë sallata.

Mandej o grindavec i ndytë, thua që shqiptarët e Maqedonisë thyejnë kokën tek Guri i Zi. Ata nuk bëjnë lutjet në Gurin e Zi, por ata ritualet e tyre i bëjnë rreth e përqark Mekës, njashtu siç bëhen lutjet nëpër manastire, kisha, sinagoga dhe kjo mua nuk më pengon. Ty, të pengon xhamia dhe një pjesë përbërëse e Mekës (lexo: Guri i zi i Mekës). Mua nuk më pengojnë aspak, po as kishat, as manastiret, e as sinagogat. Ajo që mua më pengon është politika antishqiptare që gatuhen brenda disa objekteve fetare, siç ishte rasti në manastirin e Deçanit dhe shfrytëzimi i objekteve fetare për qëllime tjera. Pikë

Ndërsa lexo shkrimin tim, "Kombi shqiptar përballë sfidave të jashtme dhe të brendshme" sid he shkrimet e tjera, dhe do e kuptosh se çka më pengon mua. A mos, harro unë ty të lexoj vazhdimisht. Më pengon ideja monstrume e jotja, po edhe e disave si ti që shajnë fe (lexo: fetë), që shajnë figura historike dhe kombëtare, që problemin kombëtar shqiptar e kanalizojnë në problem religjioz. Osmanët ndoshta kanë pasur qëllim shtimin e dimensionit religjioz problemit të çlirimit të shqiptarëve, jo aq sa edhe ti, ngase ti mëton zgjidhje të problemit kombëtar shqiptar me bazë urrejtjen fetare. Mandej më etiketon si patriot maqedonas. Unë jam shqiptar i nderuar, dash beso e në mos dash mos beso. Jetoj në Maqedoni, i ndarë padrejtësisht, por me ambicien që të afrohemi më shumë me shqiptarët matanë kufirit, në

mëmëdhe, në Kosovë e gjetiu. Po, jo me ty, ngase ti fton në luftë vëllavrasëse.

Mandej në fund futesh në biografinë time. E di i tërë auditori se si jam shkolluar me mund e me djersë, si kam arritur rezultatet e larta me përkushtim dhe me punë të pandërprerë, si jam shkolluar me një rrogë të ulët prej ndihmës së babait tim dhe bursave që i kam merituar për shkak të notës së lartë mesatare, si jam punësuar në UEJL, në bazë të kriterit meritor, përmes notës mesatare dhe intervistës së suksesshme, përmes prezantimit tim të suksesshëm në Belgjikë si deputet i ri i Parlamentit frankofon të të rinjve, si kuadër i ri që kam filluar në moshën 20 vjeçare të punoj si profesor në gjimnaz të Kumanovës, ku nxënësi shqiptar kishte mësimdhënës maqedonas, e me ardhjen time filluan mësimin e frëngjishtes me shpjegime në shqip, e në saj të biografisë sime (lexo: CV time që ti e paske lexuar) si aktor në trupën teatrale frankofone duke u shpërblyer aktori më i mirë dhe duke i fituar vendet e para dhe të dyta së bashku me 2 kolegët e tjerë të mijë shqiptarë dhe 3 kolegët e tjerë maqedonas. Po ty të pengon kuadri i ri, të pengon se kam filluar në moshën 23 vjeçare të punoj si lektor i frëngjishtes, të pengon edhe suksesi im në moshë të re, magjistratura ime, librat e mi, suksesi i profesorëve të rinj, të pengojnë ndërkombëtarët, feja Islame, miqtë tanë dhe gjithçka, ngase ke probleme në kokë. Tani zotrote pasi kam magjistruar në një doktrinë puro franceze tipike, të pengon se jam bërë magjistër apo çka? Unë nuk kam magjistruar nëpër laboratorët greke dhe sllave, e as të agjenturave të huaja, siç mëton të më paraqesësh ti, po magjistratura ime është publike,

ka pasur komision recensues për këtë në përbërje me profesorë të shquar dhe përkatës të lëmisë, si dhe dy librat e mi janë publik dhe mund t`i marrësh në shqyrtim edhe ti. Mos harro, se tema për Risheljenë, ndoshta është e studiuar mjaft në Francë dhe Evropë, ndërsa tek shqiptarët është shumë pak. Është e trajtuar në librat e miqve të mi, profesorë të shquar, nga Shqipëria, z. Lisen Bashkurti (recensent i librit tim të dytë) dhe z. Gjon Boriçi, po për herë të parë shkoqitet si duhet në temën dhe hulumtimin tim.

Në anën tjetër nuk kam lidhje aspak me shërbimet inteligjente, ato t`i kam lënë ty, po mos mendo se nuk kam miq të shumtë shqiptarë, të huaj, ndërkombëtarë me të cilët bisedoj lirshëm dhe shtruar për tema të ndryshme. Nathali Clayerin e kam lexuar. Ai libër i saj është personal i saji, nuk është mendim i politikës zyrtare shtetërore franceze. Dihet qëndrimi zyrtar francez për Shqipërinë, Kosovën, shqiptarët në Maqedoni, e nuk kam nevojë të ti zbërthejë. Ata janë miqtë tanë që na ndihmuan dhe na ndihmojnë vazhdimisht, edhe atë deri në momentin derisa mos të kemi mendime të mbrapshta si ti dhe soji yt dhe do të shkojnë se kanë punë të tjera për të bërë. Më mirë që i kemi prezent francezët, amerikanët, evropianët, se sa rusët, sllavët e grekët. Fundja edhe me këta të fundit mund të shtrimë dorën e pajtimit, nëse ata pranojnë krimet e bëra ndaj shqiptarëve, nëse pranojnë të bëjnë katarzën e nevojshme dhe të domosdoshme, sikurse Gjermania pas LDB-së.

Unë si shqiptar frankofon, nuk punoj në vijën e Nathalie Clayerit, sepse nuk kam nevojë. E kam punën time të pastër tani, si udhëheqës i departamentit të

gjuhëve në UEJL, si kolumnist i rregullt, si lektor në Akademinë Diplomatike Shqiptare. Punën e agjentit ja u lë juve, ngase ju jeni misionar i fshehtë i "Cërna Rukës" dhe ja u lë juve punën të shpifni ndaj kuadrove të reja shqiptare, që kanë miq të shumtë ndërkombëtarë. Ju xhelozoni për këtë, ngase në vendin tuaj, jeni vetëm pjesë proceseve të ndryshme gjyqësore, si një njeri që shkruani dhe shpalosni palomendime bizantine, që mbillni farën e urrejtjes dhe përçarjes. Unë nuk e kam për detyrë të mbroj Islamin nga ti, unë mbroj me qëndrimet e mija vëllezërit e mi shqiptarë që i takojnë përkatësisë fetare islame, të cilëve do t`ua djegësh xhamitë ti, mbroj vëllezërit e mi shqiptarë të konfesioneve tjera që do t`i fusësh ti në luftë vëllavrasëse dhe në Shën Bartolomej. Kjo është detyra ime.

Detyra ime e radhës, do të jetë takimi im me ty, dhe njoftimi për së afërmi. Në Shqipëri vij shpesh që të vizitojë miqtë e mi, profesorët e mi, kolegët e mi. Pse mos të vij të të shoh surratin edhe ty?! Fundja do të bindë se e ke gabim fund e kryje, dhe se me tezat e tua shqiptarët nuk bashkohen po ndahen më shumë.

Kërkoj të mos e pastroni të kaluarën me mua, sepse e turbulloni të tashmen dhe të ardhmen. Një porosi për ty **"Mos shkruaj sipas porosisë së ditës. Ngase shkenca jote është krejtësisht pa ndërgjegje, e shkenca pa ndërgjegje ta shkatërron shpirtin"**. Këtë e ka thënë shkrimtari i madh francez Rable. Ti ende nuk je koshient se sa i paditur që je, ngase mendon se e ke kokën të mbushur. Koka e mbushur nuk të duhet fare, neve na duhen koka të formuara si duhet.

Në fund, o Kastriot M.... e përmbyll reagimin tim, ndaj paloreagimit tënd me thënien e Pablo Nerudës

"Dija e vogël i bën njerëzit kryeneçë (sikurse ti). Dija e madhe i bën njerëzit kryeulët. Andaj kalliri i zbrazët e ka kokën lart, e ai i mbushuri lakohet për tokë."

KASTRIOT MYFTARAJ, KRYEPLAKU I ÇMENDUR I MËHALLËS SË TË ÇMENDURVE, ALIAS SHPIKËSI ANTISHQIPTAR I "RACIZMIT BRENDASHQIPTAR"

Reagimi i radhës ndaj paloreagimeve tendencioze të "vrasësit me pagesë në publicistikën shqiptare", (K.M), Kastriot Mykftarajt, bashkëmendimtarit të Dragan Pavlloviç- Llatasit

Nuk është e lehtë të merresh me fëmijë të rritur, që shkronjat e alfabetit i marrin për lodra, mbase mendojnë se me ato shkronja të bukura mund të luajnë si t'u teket. Kështu, ndërmjet këtyre vështirësive e shoh veten kur polemizojë me njerëz që kanë identitet të dyshimtë e skajshmërish të paqartë. Aq më e ndërlikuar bëhet çështja kur, këta fëmijë të rritur e njerëz me identitet të pështjelluar, merret vesh se kanë dukshëm problem edhe me njerëzinë. Charles Darwin gaboi rëndë atëherë kur tha se, njeriu është kafshë inteligjente, ngase sot, për sojin e disa të ashtuquajturve njerëz, lirshëm mund të aludojmë se, kafsha qenka njeri primitiv. Po, po, vetëm kështu mund ta deshifrojmë dhe t'i japim një identitet të përshtatshëm Kastriot Myftarajt. Kështu të paktën mund t'i jap të drejtë vetës të polemizojë me një krijesë e cila ka pësuar evolucion. Sidoqoftë, nuk do të merrem me gjenezën e kësaj krijese, ngase tutje nuk kam vullnet për të humbur kohë, mbase humbja e kohës bëhet në mungesë të vullnetit.

Derisa lexoja paloreagimin e Kastriotit, t'ju them të drejtën më kishte marrë malli për përrallëza, por jo për përrallëza që fund e krye janë të mbështetura në trillime dhe iluzione djallëzore. Kështu, Kastriot Myftaraj e komentoi në katër vazhdime palopolemikën e tij. Komentimi i këtij agjenti grek nuk mund të karakterizohet ndryshe, pos dhunim i letrës së bardhë dhe përdhunim i shkronjave. Në pjesën e parë, dukshëm e kishte gënjyer **ciceroni spiun**, duke dalë kështu një komedi, që as djajtë nuk do t'i duartrokisnin, ndaj me pjesën e parë nuk do të merrem, si dhe e kisha lutur ciceronin spiun të këtij agjenti, le të bëhet burrë e të më pyesë për përditshmërinë time, se unë do t'ia tregojë vetëm të vërtetën, e pastaj urdhërdhënësi i tij nuk do të këtë mundësi të hartojë skenarë të djajve.

Siç e potencova më lartë, i lexova paloreagimet e Kastriot M..., me kujdes dhe me maturi. Edhe pse ia dhashë përgjigjet e merituara në dy reagimet e para, ai prapë se prapë vazhdon me avazin e vjetër të sharjeve, shpifjeve dhe etiketimeve, që sikur të gjendeshim në ndonjë vend apo rajon demokratik, që moti ky njeri do t`iu bashkëngjitej ose spitalit të të çmendurve, ose kopshtit zoologjik ose ndonjë burgu.

Megjithë sugjerimet e miqve të mijë të shumtë që mos të merrem më me këtë njeri shpifës, nga shkaku, se është mjeshtër i shpifjeve dhe i llomotitjeve, që mos të bie në nivelin e tij, ndërgjegjja ime e pastër dhe respekti për auditorin që më njeh dhe lexon, si dhe për ata që nuk më njohin, më detyroi që t`i përgjigjem poshtërsive të Kastriot M...., të cilin e them për të satën herë, që më vjen të vjell kur i përmend emrin dhe mbiemrin, jo për

shkak të emrit mjaft të bukur që e ka, po për shkak të karakterit të tij të ndytë, për shkak që i humb vlerën emrit Kastriot, po e nderon mbiemrin e tij, si kryeplak i çmendur i mëhallës së të çmendurve, që ai drejton.

E nuk është thënë kot: "Një budalla e hedh një gurë në pus, dyzet të mençur nuk mund ta nxjerrin atë nga pusi". Kësisoj ky budalla, që më ra hise që të merrem me të, sikurse shumë e shumë të tjerëve para meje, me të vërtetë e meriton më shumë se këtë reagim timin, më shumë se burgun, për shkak të mendimeve të tij të errëta ndaj shqiptarëve të besimit mysliman dhe të Islamit si fe në përgjithësi. Edhe pse në fillim konstatova se të merresh me Kastriot Mykftarajn, është humbje kohe me një të humbur, prapë se prapë, duke i lexuar komentet e disa përkrahësve të tij, më erdhi keq për ata, të cilët në mungesë të informatave vjellin helm dhe vrer ndaj meje, ndaj shkrimeve dhe qëndrimeve të mija, dhe ndaj shqiptarëve të besimit islam, që janë më numeroz, në krahasim me vëllezërit e tyre shqiptarë të besimeve të tjera.

Për të satën herë me radhë duhet t`i dëshmoj kësaj koke si Kastriot Mykftaraj, të cilin kur e pash në foto, u binda që, shpesh karakteri i njerëzve përshtatet me pamjen fizike, e kjo ka të bëjë pikërisht me të humburin e mëhallës së të çmendurve, që tezat e tij të mbrapshta që servohen fatkeqësisht edhe nëpër forume dhe gazeta të ndryshme janë të rrezikshme, sa edhe tezat e Llatasit, palogazetarit serb nga Maqedonia, goja e të cilit masturbon vetëm të këqija ndaj shqiptarëve. Kësisoj edhe Katriot M..., me gojën e tij nuk bën asgjë, përpos që masturbon dhe që dëshmon që ai është një

shqiptarofob dhe një islamofob. Nuk e kam qëllimin ta njësoj kombin shqiptar vetëm me fenë islame, ama K.M (lexo: prej tash e tutje këtë njeri për çështje higjienike do ta potencoj vetëm me iniciale) "harron" se shumica shqiptare në gjithë trevat shqiptare është myslimane dhe pikë. Këtë nuk mund ta ndryshojë as ai, e as askush tjetër. Kjo është realitet që ndoshta dhemb, po është realitet dhe nuk kemi se çka ta diskutojmë.

Meqenëse jam i prirë që të mos merrem me etiketime, e as me jetën private të individëve, po me qëndrimet që i llogaris si të mbrapshta të tyre dhe me idetë e zymta, unë do të kursehem nga shpifjet ndaj K.M. Por, ai nuk e bën këtë. Paloreagimin e tij ai e fillon me lloj-lloj shpifjesh që më bënin të qeshja me "aftësitë" e këtij njeriu që të thur tregime dhe përralla, si dhe më vjen që të qajë me atë se ku e kam sjellë veten unë, si dhe shumë veta të tjerë, që të polemizojmë me krijesa me pamje njeriu, si dhe më dhimbset kombi shqiptar që përbrenda vetes ka njerëz fanatik fetar, sikurse Ferdinandi i Monarkisë Habsburge, të cilët janë të mpirë nga ëndrra miope dhe zelli fetar, për universalizim dhe homogjenizim të një kombi të tërë, me një fe të vetme, duke e cenuar pasurinë kombëtare shqiptare, mozaikun e pasur me tre fetë, duke sharë një fe e cila është e pranishme tek 85 % e të gjithë shqiptarëve, si dhe tek 1.5 miliardë e njerëzve në botë. Po, ja që dikush, nuk ka ndërgjegje, nuk ka etikë, nuk ka mend dhe nuk është i prirë që të respektojë diversitetin, të respektojë tjetrin dhe nuk i ka parasysh Konventat e shumta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku përfshihet edhe respekti ndaj njerëzve që kanë racë, fe, gjini dhe moshë të ndryshme.

Këtë, K. M. nuk e ka, fatkeqësisht, ngase laboratorët, prej ku del ai, janë të mbushura me urrejtje dhe frymëzohen në frymën e Dragan Pavlloviç- Llatasit dhe kuzhinave serbo- greke. Përgjigjet K. M . do t`i ja jap me radhë duke filluar nga e para.

Si pikë e parë K.M. potencon që unë e paskam shkruar reagimin tim ndaj tij ne gazetën e ashtuquajtur islamike "Mesazhi", e në fakt ajo nuk është gazetë, po web-portal edukativo-arsimor, shkencor, apo për ta pasur K.M më të qartë ajo nuk është islamike, po është islame. Të njëjtin reagim e kam botuar nëpër shumë web faqe të tjera me karakter kryesisht kombëtar.

Sa për shpifjet dhe njollosjet që i bën ndaj meje duke më atribuuar gjithë ta arriturat e mija, falë Veton Latifit, unë krijesës monstruoze K.M, i sqarova njëherë, e do i sqaroj përsëri se personin në fjalë nuk e kam asgjë. Me shpifjet e tija, K.M nuk e di se kënd e nderon, mua apo Veton Latifin, ngase me këtë ai arriti që të na bashkojë mua me Vetonin, edhe pse rrugët tona me Vetonin janë shumë të ndara dhe nuk puqen pothuajse askund. Ai i takon një filozofie krejtësisht tjetër, ndërsa unë një tjetrës. E respektoj si kolegë dhe asgjë më shumë. Nuk e kam familjarë, andaj atij Ciceronit spiun i them që të përmirësohet në gënjeshtra, fundja le të gënjejë për toke. Veton Latifin e kam njohur shumë vonë, pikërisht këto dy vitet e fundit, andaj nuk ka pasur kurrfarë mundësie që t`a kem atë si mentor. Mentor i im është rruga e vërtetë e besimit në një Zot dhe kaq sa i përket Vetonit dhe shpifjeve ndaj tij dhe meje.

Mandej e dinë e gjithë Kumanova se as nuk njihem dhe as nuk flas me Bajrush Sejdiun, e as që dua

ta njoh. Unë e kam pasur dajë Nexhmedin Hyseni-Neçkon, i vrarë nga UDB-ja serbe në vitin 1988, aty ku shërben tash K.M.

E sa i përket Dorëz zë Zezë, ta them oj krijesë me emrin K.M se Dorë e Zezë je ti dhe bashkëpunëtorët e tu, si dhe ca web portale që promovojnë Shën Bartolomeun, duke kërkuar ndërrim të fesë tek shumica myslimane, duke promovuar urrejtje ndaj Islamit dhe ndaj shumicës shqiptare. Ndërsa, sa i përket Dorës së ashtuquajtur të Gjelbër, unë jam i bindur se kjo është tezë e Llatasit, shërbimeve serbe dhe greke, të cilët të mpirë nga realiteti që jemi miq me SHBA-të dhe Evropën, dëshirojnë të na paraqesin si gjoja fundamentalistë dhe ekstremistë fetarë, gjë që nuk pinë ujë. Pra, kjo është tezë e sajuar kryesisht nga sllavët, grekët dhe soji i K.M. Unë jam kundër Dorëz së Zezë serbe, dorës së ndytë dhe të fëlliqur të K.M dhe web portaleve ku ai shfaq mendime dhe opinione të errëta, e që fatmirësisht nuk janë të shumta po janë në raritet.

Nga terminologjia tejet laike dhe injorante e K.M, fare lehtë mund të konkludohet varfëria e tij intelektuale, ngase ai nuk e kupton nocionin mysliman, një nocion shumë elementar. Mysliman është ai person që deklaron maksimën e njohur (shehadetin), ndërsa pastaj varet prej tij se sa do të praktikojë kushtet e tjera të Islamit. Varësisht prej asaj se sa ai praktikon kushte tjera, ai nëse e thotë çelësin e Islamit (shehadetin) është mysliman. Në përgjithësi, duhet të kihet parasysh se nuk ka rregulla strikte që një popull i caktuar duhet të ketë një fe të caktuar dhe pikë. Feja është zgjedhje e lirë, vullnetare

pa imponime. Ajo nuk dhurohet me zor, ajo pranohet me bindje dhe dëshirë, po jo me bindje të sojit alla K.M.

Më tutje, K.M në paloreagimin e tij, merret me sqarime në lidhje me Perandorinë Osmane dhe rolin e saj, dhe vihet në rolin e historianit, por unë habitem se si qe e mundur që pas pesë shekujve sundim osman, populli shqiptar edhe më tutje flet shqip, po edhe ne që po polemizojmë jemi duke e bërë këtë në shqip. Në asnjë shkrim dhe reagim timin unë nuk mbroj Perandorinë Osmane, po mbroj shqiptarët nga dokrrat dhe derrat e llojit K.M. Po këtë bëhet se nuk e kupton K.M. me "aftësitë" e tij sajuese të tipit të Llatasit serb. K.M. trumbeton se shqiptarët paskan Islam arabo- turk, e në fakt Islam të tillë nuk ka. Islami është Islam gjithkund, ashtu sikur edhe Krishterimi, Protestantizmi, ... dhe asgjëizmi i K.M. E sa për sqarim, Islami dallon në esencë prej Krishterimit, Judaizmit, Budizmit, ngase Krishterimi buron nga emri i Krishtit, Judaizmi prej Judës, e Budizmi prej Budës, ndërsa Islami nuk ka protagonist njeri, që do të identifikohej me të, por ka prejardhje të pastër qiellore, si dhe Islami ndër shqiptarët nuk identifikohet me arabët, turqit apo me ndonjë popull tjetër.

Më tutje K.M, shpif duke aluduar në ndërtimin e xhamive, se gjoja ndërtimin e tyre po e financuakan Vehabitë. Po si more po ua atribuon këtë të mirë atyre, kur dihet mirëfilli se xhamitë janë të ndërtuat nga dora shqiptare, nga djersët e mërgimtarëve tanë, e shqiptarët nuk kanë kurrfarë lidhje me Vehabitë, ata janë miq tu dhe të agjenturave të tua serbo greke, miq të Llatasit, që çdo herë që i duhen ai, pra Llatasi, i merr nëpër gojë, ashtu siç masturbon edhe ti dhe soji yt, duke tentuar që

nëpërmjet kësaj të përbaltni shumicën shqiptare. Më tej, sa i përket thirrjeve pesë herë në ditë (lexo: ezanit), kjo fillimisht është një edukatë, disiplinë dhe rregull, ku njerëzve të këtij besimi i lëshohet kushtrimi për lutje ndaj Zotit, ashtu siç bien kambanat për të krishterët, që zhurmat e tyre nuk janë në gjuhën shqipe, po ja që mua dhe shumicës shqiptare nuk i pengon, ngase ne i llogarisim si pasuri të gjitha, po soji yt fanatik ferdinandesk jo. Ezani, o K.M. është në gjuhën burimore, ashtu siç i themi kompjuterit në gjuhën burimore, ashtu siç janë barërat në gjuhën burimore latine... Edhe ezani është në gjuhën burimore, ngase po të thirrej në të gjitha gjuhët, e në botë janë diku rreth 2496 gjuhë ortoepike dhe 350 gjuhë ortografike, feja do të humbiste kuptimin e saj të vërtetë. Kushtrimi i K.M në rrënim të "fortesave arabe" nuk bën asgjë tjetër, përpos që nënçmon shqiptarët shumicë, cenon diversitetin fetar, promovon Shën Bartolomeun dhe asgjë më shumë, e kjo do të kishte efektin domino, me ç`rast shqiptarët do të bëheshin sikurse francezët në vitin e hershëm 1572. Kjo është bazamenti i idesë shënbartolomeiste të K.M. Rrënim të tempujve fetarë nuk do të ketë, o K. M. Këtë ta dish mirë, po është shumë e sigurt, se ti dhe soji yt do të rrënoheni dhe do të shkruheni vetëm në letrat e toaleteve.

Nuk e kuptoj se për çfarë arsye kërkohet deislamizimi i shqiptarëve, si kusht për tu larguar Janullatosi, kur dihet se po ky Islam ndër shqiptarët, mbrojti janullatosizimin e shqiptarëve, sinonim i myftarizimit alla K.M.

Më tej, o K. M emri im është Ardian, unë mund të jem Gardian i kombit tim dhe dinjitetit tim, ndaj

ofendimeve dhe pëllitjeve të tua dhe të sojit tënd, jam Gardian edhe i fesë sime dhe nuk do të lejojë që ti ta njollosësh, edhe pse një gjë të tillë, ti nuk e ke të mundur ta bësh, ngase kundër qelizave të tua spiunore do të ngrihej e tërë shqiptaria me besim islam, po edhe vëllezërit tanë të përkatësive të tjera fetare, që janë të ndershëm dhe jetojnë së bashku duke e dashur këtë mozaik me diversitet fetar. Ndërsa, në lidhje me mbiemrin tim Ramadani, ai ka kuptimin e muajit të shenjtë të agjërimit, për të cilin ti mëton se është kanibalizëm, respektivisht muaji që profeti Muhamed, e paska bërë për të ndalur kanibalizmin. Për këtë e ke përgjigjen e duhur në reagimin e z. Iljasa Salihut, me titull " ***Myftaraj, ky kanibal barngrënës".***

Në mënyrë shumë amatoreske K. M . në po të njëjtin paloreagim, fillimisht shpreh optimizëm për deislamizimin e shqiptarëve, kurse pak më poshtë i frikohet vitit 2078. Falë Zotit që nuk na ndodhi plani 600 + 2000, e nuk do ta lejojmë as planin tënd djallëzor, të Savë Batares dhe të Dragan Llatasit.

K. M pretendon përmes Ligjit të bëjë deislamizimin e shqiptarëve, e më pas po patë nevojë ai do t`i përdorë të gjitha mjetet dhe mekanizmat tjera, por ky injorant harron se bie ndesh me Ligjin, ngase me Ligj dhe Konventa mbrohen të gjitha besimet fetare. Ndërsa, i vobekti në mendje, K. M. harron se Meka dhe Medina, që janë qytete në kuadër të Arabisë Saudite, janë vende të shenjta pelegrinazhi, ku kushti kryesor që të vizitojë ndokush ato vende është të jetë mysliman, ndërsa K.M. pretendon të ndërtohet atje kishë. Çfarë idiotësie, po kështu flasin ata që kanë mungesën e trurit të vogël, e të madhin me teleskop nuk mund të ua gjesh!!! Sa i përket

tolerancës në objekte fetare, e ke rastin e Stambollit, ku në mes të një qyteti me shumicë myslimane, gjendet Patriarkana e Stambollit, Kisha Ortodokse e gjithë besimtarëve ortodoksë. Më tutje, e ke rastin në Prishtinë, ku në mes të një qyteti me shumicë myslimane, është e ndërtuar katedralja katolike, ndoshta di ta bësh dallimin mes katedrales dhe kishës, nëse jo mësoje. E sa i përket asaj se shqiptarët myslimanë a janë të dhunshëm ose jo, argumenti i mësipërm flet për këtë, poashtu edhe respektimi i objekteve të tjera fetare gjetiu, po edhe tolerimi ndaj llomotitjeve të tua. Sikur shqiptarët myslimanë të ishin fanatikë dhe të mos ishin tolerantë, emri yt që moti do të gjendje në historinë e turpit, i gurosur në ndonjë varr të humbur.

Më tutje K.M. duke e potencuar se shqiptarët e pranuan Islamin me dhunë, ai I vendos shqiptarët në pozitë inferiore pezhorative si frikacakë dhe të ndrojtur, që lehtë pranojnë ndërrim të fesë dhe asimilohen lehtë, e dihet se shqiptarët e pranuan Islamin pa kurrfarë rezervash, sepse në të panë vlera. Ata nuk u asimiluan, po përkundrazi e ruajtën indin kombëtar, duke e luftuar pa mëshirë Perandorinë Osmane, më shumë se gjithë popujt tjerë ballkanik. K. M përmes tezës së tij dëshiron të paraqesë shqiptarët frikacakë dhe lepurushë, ndërsa popujt tjerë ballkanik që nuk e ndërruan fenë, po i paraqet si trima. Ja se sa shqiptarë është K. M!!! K. M. nuk mund të bëjë dallim mes ideologjisë (stalinizmit) dhe fesë (Islamit), e para ka përfunduar në analet e historisë së turpit, e kjo e dyta gjallëron dhe qenëson edhe më tej, e do të qenësojë pa pushim.

Më tej, K. M tenton të "vejë në dyshim" aftësitë dhe njohuritë e mija me mbiemrin Kisinxher, që unë e lexoj Kisinxher në shqipen time. Me këtë ai do të tregohet si superiorë dhe si sfidues. Nuk ndalon këtu, ai vazhdon edhe më tej të merret me Risheljenë, e nuk e din që Rishelje, nuk kërkonte konvertime fetare, përkundrazi ai detyrat fetare i kryente me zell, po interesin kombëtar e kishte primar. Andaj, për Risheljenë, K. M. nuk ka se çfarë të më dëftojë, ngase e kam stërstudiuar. Ai mbetet udhëheqësi model briliant, që nuk hoqi kurrë dorë nga besimi i tij katolik, po nuk kërkoi kurrë konvertimet fetare, po përkundrazi forcoi kohezionin kombëtar. Historinë e krijimit të kombit francez e kam shumë të njohur, e për të edhe kam shkruar në dylibrat e mijë, po jo duke ndenjur në përkthimet e letrave të Bajrush Sejdiut, sepse personalisht as emrin nuk dua të ja përmend, por duke lexuar, studiuar dhe hulumtuar në Francë, Belgjikë e kështu me radhë. Dele nuk kam ruajtur në Likovë, ngase unë jetojë në Opajë, do të isha krenar të ruaja, kam ruajtur kafshë të tjera, po beso se të paktën ata kafshë janë shumë më të ndershme dhe më profitabile se ti, ti nuk mund të krahasohesh as me plehun e tyre ngase e kontaminon edhe tokën pjellore. Kafshë kam pasur, kafshë shtëpiake, ngase me mund dhe me djersë i kemi kultivuar për tu shkolluar, ngase nuk merrej as gjyshi, as babai im, as familja ime, as unë me vepra agjenturore që të paguhej, siç paguhej dhe paguhet K. M. Po një gjë ta dijë K. M. Ne nuk kemi shitur nënë, grua e motër për disa dhjetëra euro, në sajë të lopëve dhe deleve që kemi pasur, e ju që nuk i keni pasur këto i keni shitur pa më të voglin dyshim, vetëm

e vetëm që të dilnit "nga kopshti me lule i Xha Enverit" dhe të shijonit botën reale. Më tutje përmend figurat e shquara franceze, që besoj se i ke dëgjuar ndonjëherë. Figura të njëjta iluministe kemi edhe ne shqiptarët, edhe pse shqiptarët e "paskan" humbur ekuivalentin e betejës së Poatjesë, ndërsa sot falë përpjekjeve të shumta të atyre figurave kemi arritur të mbijetojmë kombëtarisht, gjë që se gjen shembullin te asnjë komb tjetër, që pa marrë parasysh sulmet permanente arriti të mbijetojë, po jo duke bërë luftëra fetare, po kombëtare.

Ndërsa në lidhje me shkrimin "Mbresat e një vizite të paharruar" të ftoj ta rilexosh o K. M, ngase kibël kombëtare është Prekazi për ne shqiptarët, sikurse Kruja, ashtu mu sikurse Qabja për myslimanët, në kuptimin që Prekazi duhet të konsiderohet i shenjtë kombëtarisht.

K.M i dëshiron shqiptarëve të mbarë trevave shqiptarë të thyejnë kryet në Mekë, njësoj sikurse Llatasi, me ç'rast dëshmon aktivitetin e tij agjenturor. Kryet nuk do ta thyejmë ne atje, kryet i kemi lënë mjaft nëpër luftëra të ndryshme, mjaft kemi vdekur në luftërat e fundit, bile Sllupçani, që kërkoj nga K.M që mos t`ia përmend emrin, i ka ngrënë 36 000 granata nga miqtë e K. M që mendojnë si ai, bile familja e nderuar Zymberi i vra si familje shqiptare dhe myslimane, xhamitë u rrënuan se ishin xhami të shqiptarëve ku faleshin të njëjtit, po duke luftuar stoikisht dëshmuan se janë të pathyeshëm, andaj atyre nuk iu thehet koka aq lehtë, po atyre që tentojnë të ua thyejnë kryet, ju thyhen edhe këmbët. A betohem se djegia e një xhamie nga ana e K. M apo njerëzve si ai, nuk do të ndodhë kurrë, ngase njerëzit

sikurse K. M me bythë të ulur në karrige me dy këmbë, para kompjuterit, nuk kanë forcë dhe guxim të mbysin miza, e lëre më të djegin xhami ose objekte fetare. Më tej K.M shkruan "Ju në faqen tuaj në facebook, si "figurë publike" keni pëlqyer faqen "Kundër publicistikës së Kastriot Myftarajt", ku paraqiten komunikatat kundër meje të një organizate paramilitare islamike me emrin Shërbimi Informativ Mysliman", a një gjë le ta dijë K. M dhe të tjerët si ai, se për të luftuar njerëzit e tillë do të duhet bashkëpunuar edhe me Djallin, vetëm e vetëm lebetia dhe tentativat për përçarje ndër shqiptarët të shuhen përgjithmonë.

E sa i përket Natës së Shën Bartolomeut, kjo natë është turpi i Francës, turp me të cilën skuqen dhe turpërohen francezët e jo sikurse mëton K.M "Çka është Nata e Shën Bartolemeut? Ajo është mitra e përgjakur nga ku lindi Franca moderne." Një gjë e tillë është fund e krye gabim me (pa)qëllim..

Në lidhje me martesat e vajzave ortodokse shqiptare me serbë, e kisha këshilluar K. M që prej frigës nga ezani pesë herë në ditë, të martohet me një serbe të Beogradit ose greke nga Athina, e besoj se atëherë do ti dëgjojë kambanat që "bien" atje në gjuhën shqipe. Më tutje, K. M vjen duke u shpalosur se me kënd bashkëpunon, kënd e ka mentor, po s`ke çfarë të presësh, ai ngrenë në piedestal njerëz që bëjnë fallco libra, keqpërdorin emra në parathënie të librave, e mandej duke u thirrur në patriotizmin folklorik, "shpalosin" projektet sllave në UEJL. Po këta të njëjtit, për vite me radhë i kanë shfrytëzuar të mirat e këtij Universiteti, po kur veprimtaria e tyre fallco doli në shesh, ata

e ngrenë kryet në emër të patriotizmit të rrejshëm të luftojnë UEJL. A, sa për mua UEJL mbetet projekti më i madh kombëtar i shqiptarëve në Maqedoni, i ideuar nga Arbër Xhaferi, ngase për së pari herë studenti maqedonas aty e ka të obligueshme mësimin e gjuhës shqipe. Njeri i Serbisë nuk jam unë, po je ti o K.M.

Ndërsa për K.M në lidhje më pyetjen e tij:" Për Zotin se nuk po di ku me e gjet një shqiptare myslimane " unë nuk do të mundohesha as bushtër t`i gjeja këtij personi single, e lëre më ndonjë shqiptare. Atij i kisha propozuar martesë me ndonjë vajzë nga Shumadija.

Më tutje tek konceptet e Patriotizmit nacionalist të Risheljesë, unë mendoj se dashuria ndaj atdheut do të thotë patriotizëm, ndërsa nacionalizëm dashuria ndaj kombit. Fati i keq e deshi që unë të jem nacionalist i arsyeshëm shqiptar i ndarë padrejtësisht në 5 shtete, por të dua vendin tim ku kam lindur, dhe të jetojë me dëshirën për të qenë i bashkuar me vëllezërit e mi shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe trojet tjera shqiptare, e kësisoj të arsyetojë lindjen dhe ta meritojë vdekjen në këtë truall shqiptar, ndërsa soji yt o K.M. nuk meriton as vdekjen, ngase ju jeni të vdekur po që ecni mbi tokë, të xhindosur. Ndërsa termi Maqedoni, është term që vjen nga shqipja, dhe nuk guxojmë assesi që ta mohojmë këtë. Ajo e ka kuptimin, emathia, e madhja, për shkak të shtrirjes së madhe gjeografike që kishte. Po, Titoja në Jajce, e keqpërdori këtë term në favor të sllavëve, duke na ndarë edhe më shumë ne shqiptarëve, e mandej kjo mollë sherri, përveç shqiptarëve, preokupon edhe shtetin grek, aty ku ka qendrën e vendosjes, soji i K.M.

Më tej në pyetjen e K.M : "Ja, le të përgjigjet Ardian Ramadani, çfarë të reje ka sjellë ai në studimin e vet për raison d' etat dhe Richelieu? ", përgjigjet mund ti gjejë tek recensentët e mi, Prof. Dr. Etem Aziri, Prof. Dr. Ali Pajaziti dhe Prof. Dr. Fejzullah Shabani. Ata i kam pasur mentorues dhe këshillues për punën time. Po do ja jap përgjigjet e konkluzioneve të punimit jo K.M, por auditorit që lexon. Ja konkluzionet e punimit tim:

KONKLUZIONE

Përmes këtij hulumtimi dhe studimi (lexo: hulumtimit tim), unë kam arritur në konkluzionet e mëposhtme.

1. Vijueshmëria e doktrinës së Risheljesë, ekspozim përmes gjuhës dhe kulturës, i mundësoi Francës që të jetë çdoherë prezente në marrëdhëniet ndërkombëtare, të jetë pjesë e zgjidhjeve të problemeve të mëdha, të promovojë institucione të cilat do i shërbenin kombit, shtetit francez, si dhe kombeve të tjera dhe shteteve të tjera, sepse një udhëheqës si Rishelje dinte qëllimin e tij se deri ku duhet të shkojë, kishte qëllim të justifikuar, por edhe limite.

2. Doktrina e imponimit përmes kulturës dhe gjuhës, si brend kulturor i krijoi hapësirë shtetarëve francez që të shikojnë më larg se të tjerët, sepse rrinin në shpatullat e doktrinës së një njeriu të madh si Rishelje, ndërsa të tjerët nuk shikonin aq larg. Rishelje dëshmon se suksesi nuk qëndron te pritja prej të tjerëve që të bëhesh i fortë, por sensibilizimi për t`u forcuar buron nga brenda si dhe nga bërja e aleancave për arritje të synimeve dhe qëllimeve të dëshiruara.

3. Doktrina e Risheljesë mundësoi që gjuha frënge, kultura frënge si dhe civilizimi francez të reflektojë çdoherë. Diplomacia moderne evropiane lindi pikërisht përmes doktrinës së tij.

4. Kjo doktrinë ofroi projekte në trajtë institucionesh siç ishte dhe është Organizata Ndërkombëtare e

Frankofonisë, hapi rrugën e krijimit të Unionit të sotëm Evropian dhe mbi të gjitha, solli çelësin e suksesit në marrëdhëniet ndërkombëtare, *" Konvertimin e gjuhës kombëtare franceze në gjuhë ndërkombëtare"*, për shekuj me radhë.

5. Gjuha si çështje serioze nuk guxon t`i lihet vetëm gjuhëtarëve, por edhe shtetarëve. Sepse Rishelje na bind se gjuha, njeriu dhe kombi që e flet, janë pothuajse një gjë e vetme. Ndërsa na bind çdoherë e më shumë se politika s`është asgjë tjetër por mjeshtëri e shfrytëzuar në çastin e duhur. Udhëheqësit si kardinali Rishelje na mësojnë se njeriu ynë para se të merret me politikë, duhet të emancipohet, kurse për të qenë patriot dhe nacionalist duhet të njohë vetveten.

6. Udhëheqësit si Rishelje na mësojnë se udhëheqësit duhet të kenë parasysh fshehtësinë e udhëheqjes të bazuar në durim.

7. Rishelje na mëson se udhëheqësi duhet të jetë mbi të gjitha njeri, e jo luan apo dhelpër.

8. Rishelje përfaqëson njeriun më të suksesshëm francez të të gjitha kohërave dhe falë tij, Franca e ka edhe sot reputacionin e saj specifik. Njëkohësisht është edhe faktor relevant për shumë çështje. Doktrina e tij dhe ai vet janë prototip i politikës moderne dhe koncepteve të rendit botëror. Franca u bë "zot" i Evropës vetëm përmes tij. Kjo rrugë e suksesshme e trasuar nga ai, ishte dhe duhet të jetë vijimësi për gjithë politikanët, shtetarët dhe udhëheqësit francez, duke filluar nga Francien I, Bonaparta, De Talerani, Klemonzoja, De Goli, Dësteni, Pompiduja, Miterrani, Shiraku. Ndërsa gjuha frënge e shndërruar në institucion të llojit të

Frankofonisë, si dhe në gjuhë të punimeve të UE-së dhe OKB-së, mund të themi se është gjuha e vetme e cila arriti që të gëzojë reputacionin më të madh gjatë shekujve të kaluar dhe shekullit tonë.

9. Rendi i ri botëror dhe konstruksioni evropian s`mund të funksionojë pa doktrinën risheljane dhe pa praninë dhe pozitën e duhur të shtetit francez, shtet ky me fizionomi evropiane dhe me vlera të jashtëzakonshme demokratike, institucionale, evropiane dhe ndërkombëtare të cilat kanë reflektuar në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe reflektojnë ende, pa të cilat bota e sotshme do të ishte e varfër.

10. Megjithë rolin gjithnjë e më të madh dhe të pakontestueshëm të gjuhës angleze dhe të tjerave, gjuha frënge përmes multilinguizmit dhe plurilinguizmit gjendet shkëlqyeshëm e pozicionuar në mozaikun e gjuhëve ndërkombëtare.

11. Franca për të mbajtur gjallë krenarinë franceze dhe gjuhën frënge ka krijuar poashtu edhe mekanizmin post-risheljan që ta mbajë gjuhën gjallë dhe permanente në komunikim, Organizata Ndërkombëtare Frankofone, organizatë kjo e cila bashkon shtetet që flasin frëngjisht dhe ndajnë vlerat franceze dhe frankofone. Përdorimi i gjuhës si element bashkues e mban Francën prezente në marrëdhëniet ndërkombëtare, mban të lidhur fort frëngjishtfolësit, francezët dhe komunitetin frankofon në Belgjikë, Zvicër dhe Kebek, si dhe në shtetet ish-koloni franceze.

12. Megjithë globalizimin si proces dhe proceset integruese, modeli i shtetit-komb është modeli aktual

dhe i pacenueshëm, por i sfiduar nga koncepti i të drejtave të njeriut, ndërsa *Raison d`Etat* është doktrina e pavdekshme, sepse nuk mund të paramendohet rendi botëror çfarëdo që të jetë ai, pa shtetin si dhe pa kombin. Ky model nuk mund të zëvendësohet me diçka tërësisht tjetër.

13. Mendimi se shteti është mbi të gjitha, nuk duhet të nënkuptohet verbërisht dhe fanatikisht. *Raison d`Etat* duhet t`i përshtatet rrethanave aktuale. Ajo duhet të ketë parasysh lirinë dhe të drejtat e individit, të drejtat e njeriut, sepse njerëzit përbëjnë shoqërinë, e ajo shtetin.

14. *Raison d`Etat* shënon se sado që të privilegjohet individi, të drejtat dhe liritë e tij, prapë se prapë shteti duhet të jetë parësori dhe interesat shtetërore duhet mbrojtur me çdo kusht, së bashku me ato kombëtare. Por, mbrojtja e tyre nuk duhet të bëhet në dëm të kombeve apo njerëzve të tjerë. *Raison d`Etat* na shprehet përmes rreshtave në vijim "Ta duam atdheun, jo se është i madh, por pse është i yni". Thënia e Kenedit që mos pyet se çfarë bëri atdheu për ty, por çfarë bëre ti për atdheun tënd, mund shumë lehtë të arsyetojë *Raison d`Etat* të Risheljesë. Liderët dhe shtetarët duhet të jenë koshient në thënien "Jetoni e lini që edhe të tjerët të jetojnë".

15. Modeli i shtetit-komb për Ballkanin nuk mund të jetë funksional, sepse ky rajon është heterogjen e nuk mund të homogjenizohet. Ai duhet ta ruajë diversitetin e tij, gjuhësor, kulturor dhe etnik. Si dhe të respektojë modelin e shteteve multietnike, multifetare. Tentativa për t`u bërë shtet-komb nga secili shtet

ballkanik mund të sjellë pasoja të paparashikuara dhe probleme permanente. Përjashtim këtu bën vetëm kombi shqiptar, i cili është i përçarë padrejtësisht, dhe duhet punuar në drejtim të unifikimit të tij dhe jo në drejtim të fragmentarizimit (gjë që K.M. nuk e bën).

16. Ndjekja e doktrinës franceze risheljane përmes modelit të shtetit- komb dhe Arsyes së shtetit nga shqiptarët është në favor të zgjidhjes përfundimtare të çështjes shqiptare në Ballkan. Shqiptarët si komb duhet të kenë të qartë se koha punon për ta, andaj duhet të shfrytëzojnë në maksimum kohën. Për shqiptarët dhe Ballkanin në përgjithësi proceset euro integruese janë domosdoshmëri dhe nevojë e imperativ kohor. Dhe duhet të punohet në këtë drejtim, duke e ruajtur njëkohësisht indin kombëtar.

17. Shqiptarët duhet të kenë model udhëheqësit e tipit të Risheljesë i cili nuk do t`i ngatërrojë interesat shtetërore me ato fetare.

18. Politika, feja dhe nacionalizmi kur drejtohen keq e ngadalësojnë ecjen përpara, ndërsa kur drejtohen mirë e shpejtojnë ecjen përpara.

19. Shtetarët shqiptarë, politikanët, qeveritarët dhe udhëheqësit duhet të dinë që nuk ka demokraci pa u zgjidhur çështja nacionale, e çështja nacionale nuk zgjidhet pa demokraci.

20. Ndjekja e kësaj formule nga shqiptarët duhet të bëhet fillimisht për përforcim të indit kombëtar dhe për bashkim në aspekt gjuhësor, mësimor si dhe për integrim të ndërsjellë. Shqiptarët duhet të njësojnë

abetaret e tyre, kurikulat mësimore dhe programet e ndryshme, të bashkëpunojnë në aspektin ekonomik si dhe të integrohen në UE.

21. Përqafimi i nacionalizmit pozitiv dhe identitetit nacional, përqafimi i kohezionit kombëtar, sepse jemi ende të ndarë në shumë shtete dhe nevojitemi të bëhemi unik përmes gjuhës dhe vlerave tjera, e jo përmes fragmentarizmit gjuhësor apo hapjes së debateve mbi identitetin tonë. Kjo mundëson shmangien e regjionalizmave dhe fragmentarizmit të identitetit unik shqiptar.

22. Shqiptarët duhet të shfrytëzojnë gjuhën për bashkim.

Konkluzionet e këtij punimi i përmbyll me thënien e Kenedit se *"njerëzit vdesin, kombet rriten dhe bien, por idetë janë të pavdekshme. Ato jetojnë çdoherë"*. Le të japim ide të vlefshme, konstruktive dhe prohumane, që i ndihmojnë kombit dhe njerëzimit.

Besoj që K.M. i ka përgjigjet dhe nuk do të kërkojë më tej përgjigje si lypsarë që është. Në lidhje me moskuptimin e termit: "nacionalizëm patriotik" nuk kam çfarë ti bëj K.M. që nuk e kupton, se kemi nacionalizëm pozitiv (nacionalizmi shqiptar), nacionalizëm negativ (shovinizmi sllav me Naçertanijen dhe ai grek (lexo: ku punon K.M.) me "Megalidhenë), ndërsa me nacionalizmin patriotik unë nënkuptoj këtë që K.M nuk e kupton: "Dashurinë ndaj kombit tim shqiptar të ndarë padrejtësisht, dashuri ndaj mëmëdheut Shqipëri, ndaj shtetit më të ri Kosovës, me shpresën që një ditë do të jemi nën tutelën e Shqipërisë Natyrale, Etnike apo Reale". De Gol, e kishte devizën e tij të "Honneur et

patrie, voici la France" – Nder dhe atdhe, ja Franca. A nuk është mirë edhe ne të themi, ***nder dhe atdhe kjo është Shqipëria.*** Andaj, unë për atë arsye promovoj patriotizmin, dashurinë ndaj atdheut Shqipëri Natyrale, po jo atdheut të ndarë padrejtësisht në më shumë shtete, e as atdheut të ndarë sipas modelit të K.M, në baza fetare.

Në lidhje me Francë, si shtet unitar, K.M pretendon se ajo nuk njeh minoritete, gjë që është ashtu, sepse ekziston natyralizimi për ata që duan të bëhen francez, mirëpo nuk e di se çka i nevojitej K.M. ky shpjegim, kur atë e din secili. Me këtë vallë mos do K.M të hapë çështjen e minoriteteve të paqena në Shqipëri, që janë shqiptarë të lindur po me religjion ortodoks. Me këtë mos do K.M të sensibilizojë çështjen e "pakicës" greke, që i ka sivëllezër? Nuk e di, ia la ndërgjegjes së tij të zombies.

A më tutje nuk kam se çfarë të shtoj për shkollimin tim dhe të arriturat modeste të mijat, ngase nuk e kam ndërmend të e mbiçmoj veten time, po nuk dua as të lejoj që një shkërdhatë si K.M të më nënçmojë, duke shpifur ndaj meje dhe duke më quajtur si servil të Veton Latifit, kur unë me këtë të fundit nuk kam asgjë absolutisht as në ide, as në lidhje familjare, e as në pikëpamje. Po e kuptoj që K.M do që përmes meje të kapet me të, unë do ia "jap" këtë privilegj, ai le të merret me Vetonin, e me kend të dojë, po jo duke u marrë me mua të shpikë dhe të trillojë gjithçka që i bie në ato pak mend që i ka..

Në lidhje me studiuesen franceze Nathalie Clayerin, e njoh përmes librave, i njoh mendimet e saja

që janë personale dhe që nuk janë zyrtare të shtetit francez, dihet mendimi i shtetarëve francez dhe politika franceze, e cila me ardhjen e Sarkozit është e orientuar drejt Amerikës fuqishëm dhe në favor të drejtësisë, kjo i bie, në favor të çështjes shqiptare, andaj nuk do të më çudiste nëse, K.M do e shihja duke "polemizuar" edhe me shtetarët francez dhe me presidentin Sarkozi.

Në lidhje me Pablo Nerudën, K.M për të treguar që është "erudit" na e shpalos CV e Pabllo Nerudës, ku errëson figurën e Nerudës për poezitë e tij ndaj Stalinit. Edhe Sartri kishte simpati ndaj Bashkimit Sovjetik, po ai mbetet shkrimtar i madh dhe me të mburret Franca. Kur kanë dashur ta dënojnë Sartrin, është çuar në këmbë një pushtetar i asaj kohe dhe ka thënë: A dënohet Volteri i dytë? Duke aluduar në Sartrin. Kemi rastin e Lame Kodrës, (Sefulla Malëshovës), i cili edhe pse ka shkruar poezi për Stalinin, gjë që unë nuk e mohoj dhe nuk e arsyetoj, ai ka poezi mjaft të bukura edhe për Kosovën edhe për Çamërinë. Kemi edhe shumë raste të tjera, por ja që K. M tenton të ndërlidhë gjithçka, për të arritur te qëllimi i tij i mbrapshtë, përçarje brendashqiptare dhe futjen e mollës së sherrit ndër shqiptarët në baza fetare. Në lidhje me atë se sa ti, o K.M je i përkushtuar ndaj kombit (lexo te paloreagimi i K.M. nacionit shqiptar), e shoh dhe ajo mund të vërehet shumë lehtë, mos na bën të qeshim, se e shohim urrejtjen tënde mesjetare të egër dhe barbare, ndaj një pjese shumicë të kombit tënd që është myslimane. K.M ndërlidh figurën kombëtare të Skënderbeut, si figurë shqiptare dhe do t`a ndërlidhë atë si figurë krishtere, ku ai nuk luftoi për fe po luftoi për Shqipëri, dhe potencon se ai, pra,

Skëndërbeu abandonoi (ja se sa shqiptarë është K.M. ku përdor barbarizma në vend të fjalës shqipe, braktisi) fenë e dhunshme të Sulltanit dhe u kthye në fenë e të atit. E tash çka do të më (na) propozojë ky farë K..... M. me nam, dreqi e kupton. Kthim të shqiptarëve myslimanë në fe krishtere?! Thuaja se ne shqiptarët i kemi kryer gjitha punët e tash duhet të merremi me fekthime, me konvertime e ku e di unë. Ne e kam potencuar edhe njëherë, kemi probleme të tjera me të cilat duhet të merremi, nuk kemi punë me çështjet hyjnore, me konvertime e me luftëra fetare, sepse ajo do të ishte edhe fundi për ne si shqiptarë. Andaj, pala serbe dhe greke ka tentuar që problemin kombëtar shqiptar, ta paraqesë si problem fetar. Këtë mendim e ndan edhe K.M. A sa për shkencën timeqë K.M e vlerëson se qenka shkencë e Muhamedit a.s., unë nuk kam çfarë të i them këtij njeriu më tepër se unë vetëm mbroj parime që duhen mbrojtur dhe dua që të mbroj kombin shqiptar nga përçarjet fetare, nga grupet fundamentaliste fetare që nxisin urrejtje dhe provokime, e në këtë grup bën pjesë edhe soji i K.M dhe atyre sorrave, laraskave, bylbylave, qyqeve që promovojnë nëpër web portale të ndryshme urrejtje fetare. Fundja Islami është fe hyjnore, duke mos përjashtuar edhe fetë dhe besimet e tjera. Mos të harrojmë, se secili njeri ka të drejtë të zgjedh këtë apo atë besim. Soji i K.M dhe i të tjerëve si ai, që pretendojnë se janë katolikë të devotshëm, harrojnë se edhe katolicizmi po edhe secila fe, nuk merret me njollosje ndaj Islamit apo ndaj ndonjë feje tjetër. Andaj as K.M e as askush tjetër nuk mund të thirret as në katolicizëm, e lëre ma në shqiptarizëm.

Për krejt në fund të paloreagimit të tij. K.M më

fton që të vizitoj Tiranën në kohën kur vjen Nathalie Clayer, unë i them atij që do të vijë dhe e kam parasysh këtë ofertë, po do të vijë edhe atëherë kur Janullatosi do të bekojë K.M dhe sojin e tij me dekorata dhe medalje për misionin e tyre të "suksesshëm" në provokime dhe nxitje të urrejtjeve ndërfetare me shqiptarëve, si dhe kur Dragan Pavlloviç- Llatasi me shërbëtorët e tij shqipfolës, do të vizitojë Tiranën dhe K.M, dhe ta falënderoj po të njëjtin K.M, për "nxirjen" e shqiptarëve dhe paraqitjen e tyre si ekstremistë dhe terroristë, (lexo: tezë sllave e Made in Llatas). Mbase ***Mission Impossible*** i K. M. do të "ketë" sukses.

Në disa momente kam parë njerëz që kur zhgënjehen prej ndonjë personi që flet shqip dhe llogarit veten se është shqiptar dhe ka bërë punë të ndytë, këta të zhgënjyerit kërkojnë që mos të jenë më shqiptarë. Po unë e kisha përmirësuar këtë kërkesë. Kërkoj që e mbarë shqiptaria të mblidhet dhe ti jap **Kartonin e kuq** dhe ta përjashtojë K.M nga "shqiptaria e tij", proserbe dhe progreke. E ajo ditë nuk do të vonojë. A sa për litarin që më propozon K.M në fund, (më këtë tregon (a)kulturën e tij prej një bishe si rinoqeri në pyll), unë edhe pse kërkova në mënyrë transparente debat, e K.M preferon debatin ta bëjë me shpifje dhe etiketime, a unë kërkova të debatojmë si të dojë, kur të dojë dhe të zgjedhë mënyrën, ai më është përgjigjur me litarë. Ngase ashtu flet ai në mënyrën e vet "shqip", po me performim sllav dhe grek. Ngase vetëm armiqtë e shqiptarëve i kanë dhënë litarin shqiptarëve për të var vetveten, ose i kanë varur thjesht vet ata. Unë nuk kam se çfarë të i them K.M përpos që ta falënderoj për ofertën e tij të litarit, po i`a la

atij litarin që ti var b...t e tija, edhe pse nuk mund të ketë, ngase vetëm burrat kanë, e sorrat, qyqarët dhe zombiet si K.M nuk kanë. Po të kishin, do të ishin sjellë si të tillë dhe nuk do të merreshin me punë agjenturore dhe spiunazhe, nxitje të urrejtjeve fetare dhe përçarje mes shqiptarëve. K.M i propozoj që para se të linde Dielli të pendohet për shpifjet, etiketimet, çmenduritë dhe punët e tij agjenturore, ngase në të kundërtën do ta mallkojë historia e turpit. Të mos promovojë dhe nxisë urrejtje fetare dhe të mos përçajë kombin shqiptar.

Kur e pyetën Gjergj Fishtën diplomatët evropianë, e më konkretisht kryeministri Francez Georges Clemenceau, rreth fesë ndër shqiptarët, ai tha: *"Jemi popull me dy fe, por s'jemi popull me Shën Bartolome"*, që do të thotë se të krishterë e myslimanë, ata, vëllezër janë…

Shqiptarët, pra, edhe pse kanë dy fe, nuk janë popull, komb, me Shën Bartolome, falë tolerancës së Fesë Islame, që i përkasin shumica e shqiptarëve. Të mos e njohësh këtë tolerancë, të mos e njohësh Fenë Islame, kjo është turp. Andaj, o K.M e keni pasur mundësinë të mësoni se Konica tha: "Të mos ishte Feja Islame, populli shqiptar do të ishte shumë më tepër në numër, por jo shqiptar".

Kur e pyetën diplomatët e huaj në Washington Faik Konicën, që ishte ambasador i Mbretërisë Shqiptare (1926-1939) se cila është feja e shqiptarëve, ai tha: "Dielën shkojnë në kishë, të premten në xhami…".Këtë mendim e ndan edhe Eduard Hosh dhe Antonina Zheljazkova.

Duke mos e mohuar kontributin e shqiptarëve patriot, flakadan të çështjes kombëtare, të cilës do qoftë

feje apo besimi, unë shtoj listën e shqiptarëve myslimanë si Ymer Prizreni, Haxhi Zeka, (të dy Myderrizë) që ishin fetarë dhe atdhetarë të devotshëm dhe udhëheqës të Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) dhe Lidhjes së Pejës "Besa –Besë" (1899), Myderriz Vehbi Dibra, nënkryetar i Qeverisë së Vlorës, (1912), Hoxha Kadri Prishtina, Ministri i Drejtësisë, të Kongresit të Lushnjës, (1920), atëherë kur iu vuan themelet Shqipërisë, si edhe qindra e mijëra shqiptarëve myslimanë fetarë dhe atdhetarë të tjerë, deri te viti 1998-1999, kur Shaban Jashari me familjen e tij, si edhe mbi 40 hoxhallarë, dervishë e shehlerë u flijuan gjatë luftës së fundit për Kosovë, për Shqipëri dhe për Shqiptari.

Me kaq besoj se K.M do të "jetë" i kënaqur me polemikën time, që për hir të respektit ndaj auditorit isha i detyruar ta bëja, ndërsa i kërkoj ndjesë miqve të mijë të shumtë që kërkuan të mos merrem me të, edhe pse unë e fillova polemikën, që i kam lodhur me këtë polemikë me personin me pamje njeriu dhe dituri djalli, agjent dhe përkrahës i Megalidhesë greke dhe i Naçertanies serbe, pra me K.M.

Besoj se me këtë polemika ime do të merr fund, ngase kam punë të tjera më të mençura për të bërë, sesa të merrem me njerëz të kotë, me fobi dhe të dëmshëm për çështjen kombëtare, njerëz që tentojnë të dalin nga lëvozhga e anonimitetit dhe karakterit prej kameleoni, që ndryshojnë qëndrime ashtu si fryn era dhe që mendojnë se bëhen relevantë "duke kritikuar" gjithçka dhe gjithsecilin. Për këta lloj njerëzish vlen thënia "Mos u merrni me të tjerët, po merruni me veten". Unë do të shtoja "shërohuni mirë njëherë, e pastaj flasim".

KËNGËT E BIN LADENIT DHE VEHABIZMI, THIRRJET E DOM ANTON KÇIRËS DHE THIRRJET SHËN BARTOLOMEISTE, RREZIKU I RI PËR KOMBIN SHQIPTAR

Kur e shkrova titullin e këtij shkrimi, më shkoi mendja tek shkrimtari i famshëm shqiptar Pashko Vasa, me fjalët e tij "Feja e shqiptarit është shqiptaria". Kjo thirrje e tij, që ia vlen të debatohet edhe sot e kësaj dite me të vërtetë shërben si udhërrëfyes dhe si kandil ndriçues, saherë që dalin në skenë skema të urrejtjeve ndërfetare, fanatizma primitiv, qofshin ato të njërës apo të palës tjetër. Rreziqet me të cilat përballet kombi shqiptar përpos që janë të natyrës së jashtme, kanë të bëjnë edhe me rreziqe të natyrës së brendshme, por të sjella nga jashtë. Kësisoj sharja, denigrimi apo poshtërimi i figurave kombëtare shqiptare vetëm se i takojnë atij apo këtij religjioni, nuk është asgjë tjetër përpos prelud dhe alibi për të nxitur urrejtje të tipit Shën Bartolomej edhe ndër këtë komb, tek i cili nuk ka pasur kurrë urrejtje fetare, i cili ka ditur të ruajë shumë mirë mozaikun e pasur fetar, duke e vënë në pah si çdoherë aspektin kombëtar, si më të rëndësishmin, si më primordialin dhe më të nevojshmin. Ndjenja e krenarisë kombëtare ndër shqiptarët ka qenë dhe duhet të mbetet çdoherë e para, e mandej është çështje tjetër se kush dhe cili përcaktohet për njërin apo tjetrin besim fetar. Por, thirrjet e fundit, respektivisht, zërat e fundit të njerëzve që duan

të i qesin vellon fetare problemit kombëtar shqiptar që është i pazgjidhur, nuk është asgjë tjetër përpos veprim agjenturor dhe tradhti kombëtare. Kësisoj, në kësi rastesh vlen thënia e Pashko Vasës, i cili kishte të drejtë me këtë thirrje, ngase ai nuk e cenoi asnjëherë besimin apo besimet fetare ndër shqiptarët, por i irrituar që individë të paguar dhe mercenarë të ndryshëm donin të loconin problemin kombëtar shqiptar në problem fetar, u nxit që të thotë këtë shprehje që ka lënë dhe do të lërë gjurmë çdoherë. Kësisoj, kohëve të fundit më rastisi të dëgjoja vargje dhe këngë kushtuar Osama Bin Ladenit, personit misterioz dhe kontrovers, armikut kryesor të SHBA-ve dhe botës demokratike, e kësisoj edhe armikut të shqiptarëve. Ky kryeterrorist, që ndokush që nuk është asgjë tjetër përpos zombie njerëzore i kushton edhe këngë, akuzohet për organizimin e sulmeve terroriste kundër Kullave Binjake në shtator të vitit 2001 dhe për një sërë sulmesh të tjera. Por, ti thurësh këngë këtij terroristi, nuk është asgjë tjetër, përpos që është ngjashmëri me thurje të këngëve armiqve të përbetuar të shqiptarëve. Në momentin kur SHBA-të, iu janë gjetur shqiptarëve në momente më kritike përkrah, duke na shpëtuar nga xhelati serbosllav, ca shqipfolës vehabistë, që Zoti e di se çfarë janë, nxitojnë të i thurin këngë kryeterroristit Bin Laden. Turp i madh.

Theksimin e elementit vehabist në trevat tona (lexo: edhe pse është ende prezent në numër shumë të vogël), elementi sllav dhe grek e shfrytëzon për interesa të veta. Kësisoj, kujtojmë rastin e takimit të kryeministrit maqedonas, Nikolla Gruevskit me Ministrin e jashtëm izraelit, Avigdor Liberman, ku u potencua rreziku

nga rreziku vehabist, e me këtë Gruevski aludonte menjëherë tek shqiptarët. E të njëjtës vijë ishte edhe deklarata e Ivica Daciçit për gjoja rrezikun vehabist në Ballkan, (lexo: ndërsa nuk është fare çudi se pikërisht këto grupe përkrahen dhe ndihmohen nga Serbia dhe qarqe të tjera anti-perëndimore dhe anti-shqiptare).

Në anën tjetër jam më shumë se dakord me autorin e shkrimit "Këndoni Adem Jasharit, e jo Bin Ladenit". Po, ja që këta zombie ç`njerëzore harrojnë Adem Jasharin dhe heronjtë tjerë që i kemi të shumtë dhe nxitojnë të i thurin vargje kryeterroristëve, me të cilët nuk na lidhë asgjë. Fill pas dëgjimit të kësaj kënge për Bin Ladenin, të kompozuar nga mercenarë agjenturorë, misionarë të paguar për të dëmtuar çështjen kombëtare shqiptare, nëpër media patëm rastin të shohim dhe dëgjojmë incidente nëpër xhami, dhunë, presione, shantazhe dhe u shokuam. Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni akuzoi vehabistët që kanë filluar të shpërndahen si sëmundja e kolerës në shoqëritë ballkanike, por se kush dhe cili i përkrahë këto grupe nuk dihet ende. Por ajo që mund të thuhet troç është se shqiptarëve nuk i duhen kësi lloj poshtërsirash ngase edhe pse jemi shumicë myslimane nuk guxojmë të bimë pre e provokimeve të këtyre grupeve armiqësore të dëmshme për kombin shqiptar dhe për demokracinë në përgjithësi. Kësisoj, do të i shkonte për shtati gazetarit serb Llatasit, si dhe shumë e shumë bashkëmendimtarëve të tij teza se ja shqiptarët nuk luftojnë për çështje kombëtare, po për fe. Gjë që nuk do i besojë askush, po thjesht nuk do ta linim të masturbonte me gojën e tij aq lehtë. Mandej, nuk e kuptoj se në bazë të cilave parametra

bazohen këta njerëz që i këndojnë Bin Ladenit, kur dihet se organizatat terroriste janë terroriste, jo vetëm për një shtet dhe për një komb po për gjithë globin në përgjithësi, e kësisoj edhe për ne. Por, kur këta grupe terroriste janë kundër SHBA-ve, miqve të përhershëm të shqiptarëve nuk do më shumë koment. Ajo që mund të thuhet lirisht është se këto grupe që i thurin këngë Bin Ladenit ose sojit të tij, duhet luftuar pa mëshirë dhe duhet flakur tutje nga kanë ardhur. Grupet vehabiste që janë të dëmshme për shqiptarët, po edhe për Islamin si fe që thërret për paqe, janë grupe antikombëtare dhe që duhen të luftohen pa mëshirshëm nga ne vet.

Në të njëjtën vijë, duke dëgjuar thirrjet e Dom Anton Kçirës, i cili para ca kohësh shprehte admirim për shfarosjen e shqiptarëve nga Millosheviçi, janë me të njëjtën vijë sikurse thirrjet e Arkanit, i cili dikur lëshonte kushtrime për luftë "Za sveta zemlja protiv siptari". Duhet kuptuar që thirrjet e tilla, po edhe thirrjet e fundit që mund të lexohen nëpër ueb portale që pretendojnë se janë shqiptare, ku bëhen thirrje për konvertime fetare në njërën apo tjetrën fe, ku shahen figurat kombëtare shqiptare, që nuk kanë luftuar për fe po për komb, ku shahet figura mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare e Gonxhe Bojaxhiut- Nënë Terezës, ku kërkohet në njërën anë djegia e xhamive dhe ndalimi i ezanit, e në tjetrën anë rreziku për greqizmin e Himarës sa vjen e shtohet, nuk janë asgjë tjetër përpos veprime misionare antikombëtare. Ngase kombi shqiptar nuk ka nevojë për gjëra të tilla. Gjuha që flet kombi shqiptar, gjuha shqipe është njëra prej gjuhëve bazë të kontinentit evropian. Llogaritet si njëra prej 5 apo 6 gjuhëve bazë të

këtij kontinenti, ndërsa si njëra prej 10 apo 12 gjuhëve të botës. Nacionalizmi i këtij kombi nuk është vrastar, nuk ka shfaqur kurrë pretendime territoriale apo shovinizëm, për dallim prej nacionalizmit serb apo atij grek që institucionalisht dhe historikisht ka qenë vrastar. Nacionalizmi serb i konvertuar në shovinizëm kërcënoi për vdekje qenien shqiptare. Fatmirësisht një gjë e tillë nuk ndodhi, falë vigjilencës sonë dhe botës demokratike. Por, nuk duhet të lejojmë që edhe Shqipëria e Jugut, Himara e gjitha me radhë të na kërcënohen nga elementë mbeturinash, që duke shfrytëzuar vdekjen aksidentale të një njeriu, të abuzojnë me këtë rast. Himara, ka qenë dhe do të mbetet shqiptare. Për këtë duhet të reagojnë fuqishëm institucionet shqiptare gjetiu, organizatat e ndryshme joqeveritare dhe intelektualët.

Kombi shqiptar, përballë sfidave të jashtme dhe të brendshme të llojeve të ndryshme duhet të dijë se si të manovrojë me sukses. Përballë sfidave të jashtme ai ka përballë nacionalizmin serb, i cili ende është i padenacifikuar, kërcënon edhe më tutje Ballkanin dhe shtetin e ri të Kosovës, e kësisoj shqiptarët në tërësi. Diplomacia serbe e përkushtuar me çdo kusht në lobim kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, përmes përkrahjes së strukturave paralele serbe në Kosovë, përmes margjinalizimit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, përmes oscilacioneve të ndryshme është sfidë për kombin shqiptar. Përballë këtij kombi gjendet e ashtuquajtura çështja çame e cila rri pezull, dhe nuk faktorizohet, edhe pse shteti i cili pretendon të jetë demokratik Greqia, mban pa të drejtë popullsinë çame në mëshirën e fatit, pa mos i njohur të

drejtat elementare. Kombi shqiptar përballë duhet të ketë edhe sfidën tjetër, atë të ndihmesës dhe mbështetjes së shqiptarëve në Turqi, për mos t`u asimiluar shqiptarët atje. Këtë të drejtë duhet kërkuar nga e drejta e krijimit të njëfarë Albafonie, organizatë kjo e cila do të rigruponte shtetet që kanë popullsi që flet gjuhën shqipe dhe që janë shqiptarë. Kjo lloj organizate duhet të funksionojë sipas modelit të Frankofonisë. Kombi shqiptar përballë ka edhe sfidën e shtetit me këmbë të qelqta FYROM, ku shqiptarët atje duhet meodomos të kërkojnë me egzigjencë të drejtat e tyre natyrore, përndryshe duhet të kërkohen alternativa të tjera si federalizimi apo ndonjë formë tjetër e rregullimit kushtetues. Kombi shqiptar duhet ë ballafaqohet dhe t`i jepet goditje e rëndë grupeve ekstremiste fetare që duan të kryejnë misionet e tyre në dëm të kauzës kombëtare. Ky komb përballë ka edhe sfidat eurointegruese dhe euroatlantike, shkëputjen nga e kaluara komuniste si dhe hyrjen në familjen e kombeve të lira. Kombi shqiptar përballë tij si sfidë të brendshme ka unifikimin ndërshqiptar, në aspekt politik, ekonomik, gjuhësor, arsimor. Ky komb duhet të synojë unifikimin e strategjive dhe qëllimeve të përbashkëta, vijimin e një politike kohezive. Kombi shqiptar përballë ka konceptin monstër të disa pseudoanalistëve si "kombi apo gjuhë kosovare", por edhe të disa analistëve dhe gazetarëve që ftojnë në konvertime fetare, në luftëra ndërfetare dhe në Shën Bartolomej mes shqiptarëve. Kombi shqiptar duhet ti luftojë këto sajesa të rrezikshme dhe armiqësore, sepse sjellin përçarjen dhe ndarjen e mëtutjeshme ndërshqiptare. Kombi shqiptar përballë ka heqjen e

barrierave ndërshqiptare në çfarë do qoftë fushe qofshin ata, forcimin e ekonomisë, krijimin e mundësive për një lëvizshmëri dhe fleksibilitet më të madh ndërshqiptar, dhe këmbimet e ndryshme akademike, studentore ndërshqiptare. Kombi shqiptar përballë ka edhe një sfidë tjetër, iniciativat haxhiqamiliste që vijnë përbrenda tij, të ndihmuara nga qarqet e ndryshme sllave, greke apo qarqe tjera armiqësore antishqiptare. Tendenca e disa individëve haxhiqamilistë të cilët dalin dhe deklarojnë publikisht se " Shqiptarëve nuk i duhet Evropa dhe Amerika" sa janë djallëzore, po aq janë edhe armiqësore. Shqiptarëve i duhet Evropa dhe Amerika më shumë se kurrë sot. Përndryshe qenësimi i ynë si shqiptarë është në pikëpyetje. Prirjet haxhiqamiliste të disa shqipfolësve, të cilët deri dje kanë qenë ose bashkëpunëtorë të sigurimeve shtetërore të UDB-së, apo janë aksidentalisht fëmijë të bashkëpunëtorëve, që sot e kanë veshur petkun ekstremist fetar, këta faqezinj dalin dhe pa fije turpi deklarojnë se Evropa dhe Amerika janë kundër nesh, ndërsa marrin edhe guximin të deklarojnë se figurat historike kombëtare si Skënderbeu, Nënë Tereza, janë figura antikombëtare, sepse na qenkan krishtere. Çfarë gojëligësie e turpshme. Këta shqipfolës, duke u nisur gjoja se nga aspektet fetare, që aspak nuk i kontestoj, por që janë aspekte të marra qëllimisht me gabim, nuk pushojnë së deklaruari se shqiptarët nuk kanë nevojë për këta personalitete, që na bënë të njihemi ndërkombëtarisht. Kombi shqiptar duhet detyrimisht t`i luftojë këta forca të errëta, që tentojnë të fusin përçarjen ndërshqiptare në bazë të feve. Kombi shqiptar duhet të luftojë me çdo kusht iniciuesit e një Shën

Bartolomeu ndërshqiptar, iniciuesit e një sllavizimi të figurave tona historike kombëtare. Kombi shqiptar duhet të promovojë diversitetin ndërfetar, duke mos cenuar aspak të drejtat fetare ndërshqiptare ose të drejtat fetare të kombeve tjera. Shqiptarët sot edhe pse me shumicë myslimane, nuk duhet të shikojnë me sy armiqësor shqiptarin katolik ose ortodoks. Kjo sfidë duhet patjetër të sfidohet nga kombi shqiptar. Ndërsa tentativa haxhiqamiliste ndër shqiptarët duhet të luftohet me mish e me shpirt, prirjet otomane të disa shqipfolësve që synojnë ndarjen e kombit shqiptar në Vilajete duhet të hidhen së bashku me to në koshin e plehrave dhe fundërrinave të fekaleve. Përndryshe do na mallkojë Zoti, të parët tanë dhe pasardhësit tanë. Kombi shqiptar gjendet përballë sfidës poashtu të disa heretikëve dhe qarqeve ortodokse progreke e proserbe, që u pengojnë xhamitë e që duan të i djegin ngase po "jepkan profil arab ndër shqiptarët", e nuk ju pengojnë kryqet gjigante përballë shumicës myslimane, që duan të homogjenizojnë kombin shqiptar me një fe të vetme si Ferdinand Habsburgu i Perandorisë së Kombit të Shenjtë Gjerman,

Pra, kombi shqiptar duhet t`i japë përparësi prezencës së multikonfesionalitetit, të respektojë kultet e besimit, të ndërtojë xhami, por në anën tjetër nuk duhet të rrënojë kisha, ose duke ndërtuar kisha të rrënojë xhami, sepse në kompozicionin e tij ka edhe pjesëtarë myslimanë edhe të krishterë. Kombi shqiptar duke i dhënë përparësi ndjenjës së pastër kombëtare, kohezionit ndërshqiptarë, respektimit të diversitetit fetar, librave të shenjtë fetarë dhe të tempujve të shenjtë feta-

rë, mbrojtjen e këtij diversiteti, mbrojtjes së pastërtisë gjuhësore dhe etnike, ngritjes dhe mbrojtjes së personaliteteve të famshme historike shqiptare, pa marrë parasysh se a janë myslimanë (Naim Frashëri, Hoxhë Tahsini, Ymer Prizreni, Adem Jashari, etj), katolikë (Skënderbeu, Gjergj Fishta, Nënë Tereza, etj) apo ortodoksë (Papa Kristo Negovani, Fan Noli, etj), do të jetë detyrimisht i suksesshëm dhe me relevancë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Tjetër alternativë nuk ka. Shën Bartolomeu nuk na nevojitet aspak, Bin Ladeni dhe vehabizmi duhet luftuar me çdo kusht, thirrjet e Dom Anton Kçirës duhet të dënohen patjetër, po edhe thirrjet e njerëzve që duan ta prishin kompozicionin e kombit shqiptar. Në momentet që jam duke e përfunduar këtë shkrim, i dëgjoj vargjet e këngës më të re të këngëtares së famshme shqiptare nga Kosova, Shkurte Fejza**, "Amerikë, Amerikë, për shqiptarët diell dhe dritë"**. Le të këndohet kjo këngë përgjithnjë.

Daljen në dritë të këtij libri e ndihmuan dhe e sponsorizuan këta sponzorë për të cilët shpreh falënderime të posaçme:

1. **Jetulla Qerimi- fshati Opajë**
2. **Isuf Qerimi- fshati Opajë**
3. **Elham Qerimi- fshati Opajë**
4. **N.T.P.”Adriatiku”- Kumanovë, z. Ardian Sejdiu**
5. **NTP “Hulusi Komerc”- Kumanovë, z. Ismail Osmani dhe z. Valmir Imeri**
6. **Ëmbëltorja “Lulevjollca”- Kumanovë, z. Atila Imeri**
7. **Barnatorja “Donita”-Kumanovë, z. Besart Zulfiji**

Ardian Ramadani është lindur më 1983 në Kumanovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu me sukses të shkëlqyer në Kumanovë.

Studimet deridiplomike i ka mbaruar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku ka mbaruar Fakultetin e Trajnimit Pedagogjik e Metodologjik, Dega e gjuhës dhe letërsisë frënge, duke u zgjedhur Student i dalluar.

Ka mbaruar studimet postdiplomike me sukses të shkëlqyer, në kuadër të Fakultetit të Administrimit Publik dhe Shkencave Politike në UEJL, Drejtimi i studimeve të diplomacisë, ku ka magjistruar me temën *"Franca dhe diplomacia franceze në periudhën e Risheljesë, shteti-komb dhe doktrina Raison d`État"*, me ç`rast mori edhe titullin magjistër i Studimeve të Diplomacisë në kuadër të Fakultetit të Administratës Publike dhe Shkencave Politike.

Ka qenë deputet i Maqedonisë në Parlamentin Frankofon të të Rinjve në Bruksel.

Ka punuar për tre vite me radhë profesor i gjuhës frënge në gjimnazin e Kumanovës si dhe për tre vite të tjera profesor i gjuhës frënge në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Ka qenë ligjërues edhe në Akademinë Diplomatike Shqiptare.

Aktualisht punon si sekretar i Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Ardian Ramadani është recensent i dy librave gjer më tani, mandej autor i rregullt i shumë shkrimeve, artikujve dhe analizave nëpër web portale të ndryshme, revista dhe gazeta të përditshme shqiptare në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë.

Deri më tani ka botuar librat "*Franca dhe diplomacia franceze në periudhën e Risheljesë, doktrina Raison d`État dhe Shteti-Komb*", si dhe librin publicistik "*Labirinth i shpalosur- Studime, Artikuj dhe Analiza*". Ky është libri i tij i tretë.

Ardian Ramadani jeton në Opajë të Kumanovës.